


Qershor 2014
Numri: 75
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



ZEKATI

OSMAN NURI TOPBASH



E THJESHTA
EDISON ÇERAJ




FINANCA-ISLAME
IDLIR BEKTESHI



ALTIN TORBA
PRAKTIKUM NË LEXIMIN
E ATYPËRATYSHËM



JO ÇDO GJË
QË SHKËLQEN ËSHTË FLORI
NUREDIN NAZARKO



HASAN K. JËLLMAZ
QËLLIMI I FESË ËSHTË
SHPËTIMI I NJERIUT



FARKËTIMI I EGOS





KOPSHTI Aromë Trëndafili

**U HAP KOPSHTI
“Aromë Trëndafili”!**

**Regjistrimet vazhdojnë...
Ju mund të paraqiteni
çdo ditë tek godina pranë xhamisë Perash.**

**Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe i kontrolluar,
staf i kualifikuar, çmime të arsyeshme,
transporti është i garantuar.**

Na kontaktoni në numrin 0676078223.

Ju mirëpresim!

(Me mbështetjen e Shoqatës “Istanbul”)



Egoja e njeriut është një botë ku jeton dëshira, pasioni, dashuria, refuzimi dhe të gjitha cilësitë e njeriut. Të gjitha cilësitë që përfshin kjo botë janë të prirura të anojnë midis hyjnore dhe djallëzore.

Uni nuk është i keq në mënyrë absolute siç mendohet, nuk është diçka që duhet mallkuar, përkundrazi, ai mund të bëhet mjet për të përjetuar miraxhin, nëse edukohet me edukatën hyjnore.

Ai është i paprekshëm dhe i padukshëm, por e ndjejmë ekzistencën e tij sa herë që përjetojmë një dëshirë, një frikë, një urrejtje dhe një dashuri.

Egoja nuk duhet vrarë, sepse një gjë e tillë nënkupton eliminimin e dinamizmit të brendshëm të njeriut.

Nefsi në asnjë mënyrë nuk duhet të humbasë entuziazmin për t'u ngjitur në miraxh. Për të marrë rrugën drejt hyjnore, është i nevojshëm entuziazmi i nefsit

Shehadeti duhet shprehur me dashuri, emocion dhe entuziazëm.

Artikulimi me gojë i shehadetit duhet të shoqërohet si një kor nga çdo qelizë e organizmit të njeriut.

Zemra jonë duhet të dridhet kur të dëgjojë fjalën "Allah".

Uni ynë duhet të pushtohet nga entuziazmi kur shikohen, dëgjohen apo lexohen shenjat e Krijuesit në veten tonë, në univers dhe në fjalën e Tij të shkruar.

Së pari duhen thyer të gjithë idhujt e jashtëm, pastaj duhen fshirë ata që gjenden brenda nesh.

Pra, për të shpëtuar nefsën, duhet të bëhemi si Ibrahim (a.s.).

Si duhet edukuar që të bëhemi si Ibrahim?

Edukimi është një proces që i ngjan procesit të farkëtimit, prej të cilit përpunohet një metal, pastrohet dhe i jepet forma e caktuar duke e nxehur në farkë, duke e rrahur me çekiç etj.

Edukimi i ngjason procesit të rafinimit, në të cilin pastrohet një lëndë nga pjesët e huaja, duke u përpunuar në mënyrë të posaçme, duke i hequr përzierjet e tjera dhe duke e bërë të kulluar e të pastër.

Duhet të jemi vigilentë dhe të forcojmë imunitetin e nefsit kundrejt sëmundjeve, si mendjemadhësia, mburrja, vetëpëlqimi, zilia, koprracia etj.

Zemra duhet selitur me dhikër, sepse vetëm përmes dhikrit mund të mbajmë një kanal të hapur jashtë ndikimit të shejtanit midis nefsit dhe zemrës.

Në kohën në të cilën jetojmë, i duhet dhënë një rëndësi e madhe pastrimit shpirtëror. Duhet të krijojmë të gjitha mekanizmat mbrojtës për të ruajtur nefsën nga sulmet e shejtanit.

Përmbajtja




7

Basimtarët dhe bleta
Ali Riza Temel



Zekati
Osman Nuri Topbash

34



44



28

"Ku janë bijtë e mbretërve
nga këto kënaqësi?"
Imam Muhamed Sytari

- 5 Farkëtimi i Egos
Ahmet Tashgetiren
- 10 Lutje mëshiruese
për pastrimin e shpirtit
Dr. Adem Ergyl
- 12 Çfarë qenieje është djalli
dhe si e mashtron njeriun
Abdurrahim Somunxhu
- 14 Realiteti i vdekjes në Kuran
Dr. Kerim Bulladë
- 16 Nuk ka udhëzim pa Pejgamberë!
Prof. dr. Sulejman Derin
- 21 Mendja e shëndoshë dhe drejtësia
M. Sami Ramazanogllu
- 22 Emrat më të bukur të Allahut
Xhafer Durmush
- 24 Përpjekja e myslimanit është lutje
Idris Arpat



41

Thelbi i Islamit 26
Sezai Engin
Një Ajet - Një Hadith 32

Urtësitë dhe dobietë e adhurimeve në Islam 41
Arjan Ymeraj
E thjeshta 44
Edison Çeraj
Financa Islame 46
Idlir Bekteshi
Jo çdo gjë që shkëlqen është flori 48
Nuredin Nazarko
Praktikum në leximin e atypëratyshëm 53
Altin Torba
Kuptimet dhe llojet e nefsit 56
Nexhat Spahiu
Sadakaja nuk e pakëson pasurinë 58
Naim Drijaj



30

**Zemërimi i Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**
Salih Zeki Meriç

Qëllimi i fesë është shpëtimi i njeriut
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

50

Farkëtimi i Egos

Ahmet Tashgetiren

Egoja në fakt është uni, personaliteti, karakteri dhe vetëdija e njeriut. Egoja është vendi ku ruhen përvojat personale në lidhje me veten dhe të tjerët. Një anë e saj është e lidhur me zemrën, një anë tjetër me engjëjt, kurse një anë tjetër është nën sulmin e vazhdueshëm të djallit dhe ushtarëve të tij. Uni i njeriut është ai për të cilin shejtani bën çdo përpjekje dhe përdor çdo dredhi për ta shtënë në dorë dhe për ta përdorur më pas sipas interesave të tij. Uni i njeriut bën ecejake midis së mirës dhe së keqes. Ai është i pajisur me të gjitha aftësitë për të qenë baza drejtuese e së keqes dhe e së mirës. Ai është që e ul njeriun më poshtë se kafsha, por në të njëjtën kohë e lartëson atë më lart se engjëjt.

Ai është i aftë të përvetësojë edukatën hyjnore, por edhe edukatën djallëzore.

Egoja e njeriut është një botë ku jeton dëshira, pasioni, dashuria, refuzimi dhe të gjitha cilësitë e njeriut. Të gjitha cilësitë që përfshin kjo botë janë të prirura të anojnë midis hyjnore dhe djallëzore.

Uni nuk është i keq në mënyrë absolute siç mendohet, nuk është diçka që duhet mallkuar, përkundrazi, ai mund të bëhet mjet për të përjetuar miraxhin, nëse edukohet me edukatën hyjnore.

Ai është i paprekshëm dhe i padukshëm, por e ndjejmë ekzistencën e tij sa herë që përjetojmë një dëshirë, një frikë, një urrejtje dhe një dashuri.

Njeriu nuk mund të bëhet mik me shejtanin, sepse ai është krijuar si armik i njeriut dhe i është dhënë mundësia për t'u vendosur në brendësi të njeriut.

Shejtani luan në brendësi dhe me brendësinë e njeriut.

Dikë e frikëson me varfëri, dikë e bën të harrojë mirësitë e Allahut, dikë e shndërron në vrasës të fëmijëve të vet, dikë e nxit për të bërë mëkat, duke ia zbukuruar dhe bërë joshës atë.

Vazhdimisht e bombardon njeriun duke i thënë: “Je i pasur, je i varfër, je i bukur, je i keq, je profesor, je i madh, je i fortë, je i famshëm. Ai përpiket me të gjitha mundësitë për të devijuar dhe denatyrizuar çdo cilësi të njeriut.

Besimtari duhet të jetë vigjilent përsa i përket kompleksitetit të egos. Në asnjë mënyrë nuk duhet të harrojë që shejtani luan me egon, pra me veten tonë.

Ne nuk hamë ushqime të prishura, sepse ata dëmtojnë rëndë stomakun dhe funksionet e organizmit. E njëjta gjë ndodh edhe nëse egoja jonë ndotet dhe pushtohet nga shejtani, prandaj duhet të merren masa dhe të tregohet vigjilencë për të mos i dhënë mundësi shejtanit të ndotë dhe dëmtojë nefsën.

Në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që shejtani dhe nefsi të krijojnë aleancë për të na penguar nga rruga drejt amëshimit.

Sapo të vihen re gjurmë të shejtanit në ego, menjëherë duhet filluar pastrimi dhe purifikimi.

Pastaj duhet të merren masa për të krijuar mekanizma mbrojtës kundër sulmeve të shejtanit ndaj egos, ndaj botës sonë të brendshme. Nefsi vazhdimisht duhet të jetë nën kontroll dhe të kalojë nëpër procese edukimi.

Egoja nuk duhet vrrarë, sepse një gjë e tillë nënkupton eliminimin e dinamizmit të brendshëm të njeriut.

Nefsi në asnjë mënyrë nuk duhet të humbasë entuziazmin për t’u ngjitur në miraxh. Për të marrë rrugën drejt hyjnore, është i nevojshëm entuziazmi i nefsit

Shehadeti duhet shprehur me dashuri, emocion dhe entuziazëm.

Artikuli me gojë i shehadetit duhet të shoqërohet si një kor nga çdo qelizë e organizmit të njeriut.

Zemra jonë duhet të dridhet kur të dëgjojë fjalën “Allah”.

Uni ynë duhet të pushtohet nga entuziazmi kur shikohen, dëgjohen apo lexohen shenjat e Krijuesit në veten tonë, në univers dhe në fjalën e Tij të shkruar.

Mbrojtja dhe ruajtja e egos nga sulmet djallëzore në një sistem dhe mjedis të cilin e ka krijuar vetë shejtani, është shumë e vështirë.

Të presësh një besimtarë të mirë prej një uni i cili qëndron dorë për dorë me shejtanin, është pothuajse e pamundur.

Nefsi duhet të ruhet prej zjarrit dhe për ta ruajtur atë

nga zjarri duhet thënë me gjithë qenien: “Më mjafton Allahu”.

Së pari duhen thyer të gjithë idhujt e jashtëm, pastaj duhen fshirë ata që gjenden brenda nesh.

Pra, për të shpëtuar nefsën, duhet të bëhemi si Ibrahim (a.s.).

Si duhet edukuar që të bëhemi si Ibrahim?

Edukimi është një proces që i ngjan procesit të farkëtimit, prej të cilit përpunohet një metal, pastrohet dhe i jepet forma e caktuar duke e nxehur në farkë, duke e rrahur me çekiç etj.

Edukimi i ngjason procesit të rafinimit, në të cilin pastrohet një lëndë nga pjesët e huaja, duke u përpunuar në mënyrë të posaçme, duke i hequr përzierjet e tjera dhe duke e bërë të kulluar e të pastër.

Duhet të jemi vigjilentë dhe të forcojmë imunitetin e nefsit kundrejt sëmundjeve, si mendjemadhësia, mburrja, vetëpëlqimi, zilia, koprracia etj.

Ndonjëherë duhen bërë punë të rëndomta për të mposhtur mburrjen, ndonjëherë tjetër duhen vizituar të sëmurët për të qenë të ndërgjegjshëm për mirësitë e Allahut dhe falënderuar për to. Për të mposhtur koprracinë dhe zhvilluar virytin e bujarisë, duhet dhënë edhe ajo për të cilën ke nevojë. Për të ruajtur zemrën, duhet kujtuar vdekja së më shpesh dhe derdhur lot para agimit.

Egos asnjëherë nuk i duhet krijuar hapësirë bosh, ajo vazhdimisht duhet angazhuar me vepra dhe punë të mira.

Për të bërë këto, duhet krijuar atmosfera e përshtatshme. Duhet qëndruar me njerëz të mirë dhe bamirës, njerëz të cilët e kanë mbajtur të pastër zemrën nga ndotja dhe papastërtitë.

Zemra duhet selitur me dhikër, sepse vetëm përmes dhikrit mund të mbajmë një kanal të hapur jashtë ndikimit të shejtanit midis nefsit dhe zemrës.

Në kohën në të cilën jetojmë, i duhet dhënë një rëndësi e madhe pastrimit shpirtëror. Duhet të krijojmë të gjitha mekanizmat mbrojtës për të ruajtur nefsën nga sulmet e shejtanit.

Lusim Allahun të na ndihmojë në luftën dhe përpjekjen për të përmirësuar veten dhe mbajtur egon të pastër nga papastërtitë, të cilat bëjnë të mundur një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e ndjenjave djallëzore. Lusim Allahun të na bëjë prej atyre që fitojnë dashurinë e Tij.



Besimtarët dhe bleta

All Riza Temel

Pejgamberi, (a.s.), e ka shpjeguar ngjashmërinë e besimtarit me bletën në mënyrë koncize dhe interesante: *"Betohem për Allahun, në lejen dhe fuqinë e të Cilit është jeta ime, besimtari është si bleta, e cila ha pastër, prodhon atë që është e pastër dhe nuk e thyen dhe e prish vendin ku qëndron."* (Ahmed b. Hanbel, Müsned, 2/199)

Bleta zë një vend të veçantë në botën e gjallë. Një sure e Kuranit të Madhërishëm quhet *Bleta-Nahl*. Bleta është nderuar në shpalljen, pra në frymëzimin

e Allahut. Allahu i ka dhënë asaj instiktin dhe mjeshtërinë për të prodhuar mjalhtë. Allahu i Lartësuar, në lidhje me bletën thotë:

"Zoti yt e frymëzoi bletën, (duke thënë): 'Ndërto shtëpi në male dhe në drurë dhe në atë (kosheret) që kanë ngritur njerëzit! Ushqehu me gjithfarë lloje frutash dhe ec rrugës së Zotit tënd përulshëm! Nga barku i tyre del lëng me ngjyra të ndryshme, në të cilin ka ilaç e shërim për njerëzit. Vërtet, kjo është shenjë për ata që përsiatin (meditojnë).'" (Nahl, 68-69)

Bleta është njëkohësisht simboli i zelltarisë dhe i disiplinës. *"Punon si bletë"* i thuhet njeriut që punon shumë. Bletët punojnë në bashkësi. Sipas të dhënave, një bletë mund të mbijetojë e vetme vetëm dy ose tri ditë, ndërsa dy bletë mund të mbijetojnë së



bashku deri në një javë. Në një koshere (zgju) gjenden pesëdhjetë-gjashtëdhjetë mijë bletë. Nuk ka koshere me më pak se dyzet mijë bletë. Kjo gjendje tregon forcën dhe begatinë e bashkësisë.

Për formimin e mjaltit kërkohet punë e madhe dhe disiplinë. Për të nxjerrë gjysmë kilogram mjaltë, nevojitet nektar lulesh, në të cilat janë ulur 37 mijë bletë. Të fluturosh në distanca të largëta, të zgjedhësh lule të dobishme, të kthehesh në të njëjtën koshere pa e ngatërruar aspak atë, është e mundur vetëm me frymëzimin hyjnor dhe aftësinë që Allahu ia ka dhuruar asaj. Është e pamundur ta shpjegosh në mënyrë tjetër këtë punë të mrekullueshme.

Siç janë shenjat e bletës ushqyerja e pastër, mosdëmtimi dhe mosprishja, lëvizja në përputhje me shpalljen dhe frymëzimin hyjnor, ashtu edhe shenjat e besimtarit janë fitimi hallall, të ngrënët hallall, të japësh gosti hallall dhe të pastër, të mos shqetësosh të tjerët kur siguron të ardhura dhe mosprishja e rendit të tregtimit.

Një besimtar i përkryer sillet si bletë punëtore në mënyrën dhe drejtimin që i ka treguar Allahu, hap punë dhe shërbime të dobishme, si për vete ashtu edhe për të tjerët. Siç është shërim mjalti që bleta e prodhon të pastër, po ashtu janë shëruese edhe ato që kanë fituar dhe prodhuar besimtarët. Ndërsa haramet janë në dispozitën e helmit, që shkatërrojnë strukturën shpirtërore të individit e të shoqërisë dhe dëmi përcillet brez pas brezi. Thonë se nuk ka ndërtesë harami. Nëse besimi i pastër është ushqimi i shpirtit, ushqyerja e trupit bëhet me ushqime të pastra dhe hallall.

Allahu i Lartësuar na urdhëron të sigurojmë të ardhura dhe t'i shpenzojmë ato në mënyrë të lejuar (hallall).

“O njerëz! Ushqehuni me të gjitha ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë...” (Bekare, 168)

“Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht! Dhe mos u bëni mitdhënës te gjykatësit për

t’ua përvetësuar në mënyrë të paligjshme dhe me vetëdiqe njerëzve një pjesë të mallit.” (Bekare, 188)

“... Profeti (që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Ungjill) do t’i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t’i ndalojë nga të këqijat; do t’ua lejojë të mirat e do t’ua ndalojë të këqijat, ...” (A’raf, 157)

Besimtari është punëtor si bleta. Përshkon distanca të largëta për të siguruar të ardhura hallall. Sjellja e tij në këtë mënyrë është urdhër i Allahut, i cili thotë: **“Ai jua ka bërë Tokën të përdorshme (ua ka nënshtruar juve), andaj ecni nëpër viset e saj dhe ushqehuni me atë, që ju ka dhënë Ai. Si të ringjalleni, do të ktheheni tek Ai.”** (Mulk, 15)

Kushti më minimal është që fitimi të jetë hallall (i lejuar). Përveç kësaj, kërkohet të jetë i pastër dhe cilësor. Në përgjithësi, mjalti është shërim. Ndërsa cilësia e mjaltit dhe proporcioni shërues, ndryshon sipas veçorive të mjedisit dhe bimëve. Mjaltrat e tjera nuk kanë cilësi të ngjashme me mjaltin anzer. Ndërsa mjalti i luleve nuk ka shije të njëjtë me mjaltin e pishës. Si kjo edhe të ardhurat e fituara dhe ushqimet, aq sa të lejuara (hallall), të pastra dhe të rafinuara dhe legjitime të jenë mënyrat e prodhimit, po aq do të jetë dobia dhe begatia e tyre.

Fitimi më i mirë është ai që arrihet nga puna e krahut dhe me djersën e ballit. Profeti, (a.s.), ka thënë: **“Askush nuk ka ngrënë asgjë më të mirë sesa ushqimi që e ka fituar nga puna e duarve të veta. Pa dyshim se Daudi, (a.s.), i cili është i Dërguari i Allahut hante nga puna e duarve të veta.”** (Buhari, Buju’- Shitblerja, 15)

Ka shumë mënyra për të fituar hallall. Bujqësia, blegtoaria, mësuesia, mjekësia, gjykatësia, rrobapqepësia, mjeshtëria e riparimit, tregtia, industria, turizmi, sektori i shërbimeve, marketingu etj.

Krahas kësaj, ekzistojnë edhe shumë metoda për fitim të ndaluar (haram). Fajde, të ardhura që arrihen nga tregtia e alkoolit dhe e narkotikëve, imoraliteti, terrori, kontrabanda, vjedhja, grabitja, të ardhura që



sigurohen përmes kumarit (*bixhozit*), të bësh hile në peshore dhe në masën e saj, të ardhura që sigurohen nga shitja e ushqimeve të ndaluara (*haram*), si tregtimi i derrit, falli, hipnoza, mashtrimi i klientit, fitimi përmes metodave jolegitime, si shitja e produkteve me hile dhe të falsifikuara, ngrënia e pasurisë së jetimit, tregtia në të zezë etj. Të gjitha këto fitime janë të ndaluara. Janë gjëra që e helmojnë shpirtin e njeriut. Fitimi i njeriut krijon marrëdhënie me jetën e tij shpirtërore nëpërmjet ngrënien dhe pirjen e tij. Zotëruesit e fitimeve të ndaluara nuk duhen as nga njerëzit e as nga Allahu. Madje, këtyre nuk u pranohet as lutja.

Profeti, (a.s.), ka thënë: “Një burrë i pluhurosur nga rruga që udhëton në rrugë të Allahut, lutet e përgjërohet me duar të ngritura nga qielli duke thënë: ‘O Zot, o Zot!’ Mirëpo, ajo që ka ngrënë është haram, ajo që ka pirë është haram dhe ajo që ka veshur është haram. Si mund t’i pranohet lutja një njeriu të këtillë?” (Muslim, Zekat-Lëmosha, 19)

Sa’d b. Ebi Vakkas, ka thënë: “Le të jetë i pastër ushqimi im, që të më pranohet lutja.”

Zotëruesit e fitimit hallall jetojnë në qetësi dhe begati. Pasuritë që fitohen në rrugë të ndaluara, janë shkaqe fatkeqësie, si për të zotët e tyre, ashtu edhe për shoqërinë. Për pasurinë nuk është e rëndësishme sasia, por të qenët hallall dhe i pastër. **“Nuk barazohet e keqja me të mirën, edhe sikur të të habisë bollëku i së keqes...”** (Maide, 100)

Edhe pasuria, zekati i së cilës nuk është dhënë dhe brenda së cilës njerëzit kanë të drejtën e tyre, është në dispozitën e pasurive të papastra. Zekati dhe lëmoshat, pastrojnë pasurinë dhe e bëjnë të begatshme, por pastrojnë edhe të zotët e tyre nga pislëqet, si koprracia dhe zilia.

Domethënë, besimtari duhet të jetë i pastër si bleta e mjalti; do t’i bëhet shëndet ajo që ha dhe që jep për të ngrënë, do të respektojë rregullat që ka vendosur Allahu, nuk do të thyejë dhe të derdhë, nuk do të bëjë shkatërrime; do të bëhet punëtor si

bletët, nuk do të ndahet nga shoqëria dhe do të jetojë i disiplinuar. Çdo aspekt i tij duhet të jetë sipas përcaktimit të të Dërguarit të Allahut: “*Sa njeri i mirë është ai, fitimi i të cilit është i pastër, zemrën e ka të gjallë, nga jashtë është i respektueshëm, nuk dëmton njerëzit, praktikon ato që di, shpenzon tepërisht e pasurisë dhe me maturi nuk e tepron fjalën e vet.*” (Mundhiri, Tergib, 2/547)

Edhe milingona është një kandërr punëtore dhe e pastërt si bleta. Në Kuranin e Madhërishëm është edhe një sure me emrin e saj. Ushqimin e dimrit e përgatit që në verë, nuk e shpërdoron, është e disiplinuar. Në anë të kundër të kësaj, ekzistojnë edhe kafshë që ushqimi i tyre është i fëlliqur dhe gjithë puna e tyre është të dëmtojnë të tjerët. Ata që ushqimin e kanë të papastër nuk e pëlqejnë pastrimin

dhe pastërtinë. Kështu janë edhe ata që kujdesen dhe nuk kujdesen për hallall-haramin. Ata që fitimin e tyre e kanë haram, ushqehen me fëlliqësira. Gostia e tyre është e fëlliqur. Ndërsa ata që fitimet e tyre i kanë hallall, janë si bleta dhe milingona. E pastër është ajo që hanë dhe ajo që u japin të tjerëve për të ngrënë. Janë burim për begati.

Le ta dëgjojmë së bashku me kujdes këtë fjalë të Profetit tonë të Nderuar, (a.s.): “O njerëz! Allahu është i pastër, i bukur

dhe pranon vetëm atë që është e pastër dhe e bukur. Allahu i ka urdhëruar besimtarët ashtu siç i ka urdhëruar pejgamberët. Në të vërtetë, i ka urdhëruar pejgamberët, duke thënë: **“O pejgamberë! Hani nga ato që janë të pastra dhe bëni vepra të mira (të dobishme).”** (Mu’minun, 51) **“O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që ju kemi dhënë...”** (Bekare, 172). (Muslimi, zekat-lëmosha 65)

Kush dëshiron t’i ngajë dikujt, le ta marrë atë si shembull. Allahu na bëftë prej robërve, zemra e të cilëve është e pastër, si brenda ashtu edhe jashtë saj, hanë të pastrën dhe nxjerrin të pastrën, si dhe prej atyre që do të kenë fatin të hyjnë në vendin më të pastër, pra në xhenet.

Amin...



Lutje Mëshiruese *për pastrimin e shpirtit...*

Dr. Adem Ergyl

Njeriu është një qenie plot ambicie. Brenda tij qarkullojnë thirrjet që ftojnë për vepra të mira dhe të këqija. Ashtu është krijuar ai. Ndoshta këtu është sekreti i sprovës. Domethënë, jemi të obliguar të qetësojmë thirrjet djalëzore dhe egoiste të botës sonë të brendshme dhe të sigurojmë mbizotërimin e mesazheve dhe frymëzimeve mëshiruese. Një sovranitet i tillë në klimën e trupit, kërkon një xhihad të madh. Pra, ky xhihad (luftë) quhet "*Tezkijetu'n-Nefs (Pastrimi i Vetes)*". Ai shpreh edhe procesin e pastrimit edhe procesin e lartësimit shpirtëror dhe të arritjes në performancën e njeriut të përkryer.

Pastrimi i vetes (*Tezkijetu Nefs*), është procesi i islamizimit të njeriut nga jashtë brenda ose nga brenda jashtë. Është ngjarje e dimensioneve besim, Islam dhe ihsan (*mirëbërësi*), të cilat operojnë qelizë më qelizë në personalitetin dhe jetën e tij. Është kauza për të dalë para Allahut të Lartësuar jo me ndjenja, mendime dhe sjellje të ndyra, por me një çiltërsi të përsosur e të dëlirë, me vepra të mira dhe me një fytyrë rrezatuese. Nga kjo varet triumfi apo dështimi i njeriut në Gjyqin e Madh (*Gjykatë Hyjnore*). (*Shiko Suretu'sh-Shems, 7-10*) Por, si mund të realizohet kjo? Cilat janë mjetet e tezkijes? Çfarë rruge duhet të ndiqet?

Lënda që e quajmë *letërsi mistike* në kulturën islame, përqendrohet pothuajse fund e krye rreth kësaj teme. Shumë dijetarë dhe njerëz të mençur gjatë gjithë historisë, kanë shkruar shumë vepra dhe kanë shkëmbyer eksperiencat e tyre pafund të çmueshme rreth kësaj, si për të gjetur përsosmëri (për të arritur pjekuri), ashtu edhe për të arritur të tjerët tek e përsosura.

Një nga përfundimet që kanë arritur është si vijon: Çdo njeri është i veçantë dhe rrugët që të çojnë tek Allahu janë sa numri i krijesave. Kuptimi është ky: Nëse ekzistojnë rregulla themelore që duhet t'i respektojë gjithsekush për të pastruar shpirtin, gjithmonë do të bëhet fjalë për mënyra të posaçme për çdo njeri, i cili nuk është i barabartë me tjetrin.

Nefsi, nga aspekti i konstruktit të tij ekzistues, zotëron një përbërje "*urdhëron vazhdimisht dhe me këmbëngulje për të këqija*". (*Surja Jusuf, 53*) Ashtu siç ka thënë i Dërguari i Allahut në lutjet e tij, është një armik i brendshëm, "*që nuk duhet t'i japim asnjë mundësi, qoftë edhe një çast*." Është një



përpjekje shumë e vështirë ta kthesh këtë armik në të paefektshëm dhe ta shpiesh atë në një pozitë që të nënshtrohet me sineritet në kufijtë e Allahut. Është e pamundur të jesh fitimtar nga kjo luftë, pa ndihmën dhe mirësinë e Allahut. Në fakt, është thënë kështu:

“O besimtarë! Mos ndiqni gjurmët e djallit! Kush ndjek gjurmët e djallit, (le ta dijë se) do të nxitet nga ai të bëjë vepra të këqija e të shëmtuara. Sikur të mos ishte mirësia e Allahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, askush nga ju nuk do të ishte pastruar kurrë (prej gjynaheve); Allahu pastron atë që dëshiron Vetë. Allahu i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.” (Nur, 21)

Pra, Mëshira e Mëshiruesit për pastrimin e shpirtit është e domosdoshme. Në të vërtetë, ky realitet njoftohet kështu nga gjuha (Disa komentues të Kuranit thonë se këto shprehje i përkasin Zulejhasë) e Jusufit, (a.s.), në Suren Jusuf: **“Unë nuk e shfaqësoj veten (me mundësitë dhe forcën time), sepse shpirti (i njeriut) është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im. Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirëplotë”.** (Jusuf, 53)

Pra, fraza kyçe për pastrimin e shpirtit është: “Të synosh mëshirën e Zotit dhe të marrësh pjesën tënde nga deti i mëshirës hyjnore.” Por, si mund të bëhet e mundur kjo? Allahu, a mund ta bëjë të posaçëm mëshirën e Vet? Natyrisht po. Kush mund t’i vendosë kufizime vullnetit hyjnor? Ai u jep mëshirë me bollëk robërve të Tij, duke mos pritur asnjë shpërblim. Ndërsa pyetja tjetër është: A mund të arrijë rob mëshirën e Allahut, duke u kapur pas shkaqeve që tërheqin mëshirën hyjnore? Natyrisht që mund ta arrijë me lejen e Allahut.

Pra, kjo derë e hapur në emër të pastrimit të shpirtit, në fakt është një derë e madhe. Zoti ynë, i cili është Mëshiruesi Mëshirëbërësi, i thërret robërit e Tij gjithnjë te kjo derë e madhe: **“Kështu, ata që besojnë Allahun dhe mbështeten fort tek Ai, (ta dinë se) Ai do t’i fusë në mëshirën dhe mirësinë e Vet dhe do t’i udhëzojë drejt Vetes nëpërmjet rrugës së drejtë.”** (Nisa, 175)

Në ajete të ndryshme të Kuranit të Madhërishëm thuhet kështu për ata që do të përfitojnë prej mëshirës hyjnore:

- Ata që besuan dhe iu nënshtuan plotësisht Allahut, do ta arrijnë këtë mëshirë. (Shiko: Suretun-Nisa, 175)

- Kurani i Madhërishëm është një burim që vjen prej Allahut. (Shiko: Suren Araf, 203, Suren Junus 57) Ata që integrohen në të, duke gjetur jetë me mesazhin e tij, do të pastrohen në detin e mëshirës hyjnore dhe do të përparojnë.

- Profetët dhe në veçanti Profeti, (a.s.), janë mëshirë e Allahut për njerëzimin. (Shiko suren Enbija, ajeti 107) Ata që ndjekin rrugën e tyre, që pranojnë udhëzimet e tyre dhe marrin si shembull rrugën e tyre, do të përfitojnë nga pastrimi hyjnor.


- Ata që luftuan në rrugë të Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre (Suretun-Teube, 20-21), ata që afrohen drejt tyre me dhembshuri dhe mëshirë, do të joshen drejt mëshirës hyjnore. Në këtë kuptim, t’u shërbesh krijesave është mjeti më i rëndësishëm i pastrimit të shpirtit.


- Ata që ekspozojnë një qëndrim të bukur me një durim të plotë kundrejt sprovave dhe zotërojnë një ndërgjegje: **“Ne të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi”**, do të përjetojnë një mëshirë të madhe nga Zoti i tyre. (Surja Bekare, 156-157) Në këtë ajet madhështor, përmenden në një vend situatat dhe sjelljet e tjera që bëhen shkak për mëshirë: **“Besimtarët dhe besimtare janë miq për njëri-tjetrin. Urdhërojnë për vepra të mira dhe ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zeqatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t’i mëshirojë Allahu. Se Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”** (Teube, 71)

Këto çështje që bëhen shkak për mëshirë, njëkohësisht janë shkaqe edhe për pastrim (tezkije). Pastrimi i shpirtit mund të realizohet vetëm me kapjen fort pas një vullneti serioz dhe qëllimi të shëndoshë. Megjithatë, shumë njerëz nuk e shfaqin këtë vullnet në emër të pastrimit. Në këtë kontekst, Zoti ynë i Lartësuar i ka obliguar profetët e Tij që përmendëm dhe nuk përmendëm më lart, për të pastruar robërit e tij, duke përdorur shumë rrethana. Në këtë aspekt, udhëheqja e pastrimit (tezkije) dhe devotshmërisë (takva), është një domosdoshmëri.

Ndërsa, dijetarët dhe njerëzit e mençur edukatorë, që janë integruar në moralin e Profetit, e kanë përkryer obligimin e këtij edukimi dhe pastrimi sublim atëherë dhe atje ku mungonte prezenca e profetëve.

Fara e personalitetit që ekziston në natyrën e njeriut, është vaditur dhe kultivuar me pika të mëshirës hyjnore nga kopshtarë kompetentë të trashëgimisë profetike. Vërtetësia e këtij procesi varet nga zhvillimi i personalitetit shembullor (model), çiltërsia dhe vullnetaria. Shkurtimisht, shpëtimi i shpirtit varet nga takimi me mëshirën e Zotit. Pra, duhet edhe të kapesh pas shkaqeve që tërheqin mëshirë, por edhe të lutesh për mëshirë me një kërkesë dhe përgjërime të madh.





ÇFARË QENIEJE ËSHTË DJALLI DHE SI E MASHTRON NJERIUN

Abdurrahim Somunxhu

Iblis është emri i djallit që ishte në xhenet. Pasi u dëbua nga xheneti, djalli mori emrin e vet. Xhindët dhe djajtë janë krijesa që nuk perceptohen nga organet tona të shqisave. Xhindët dhe djajtë zotërojnë vetëdije dhe vullnet. Këta janë të obliguar të respektojnë urdhëresat dhe ndalesat e fesë islame.

Djalli është prej xhindëve të egër dhe të devijuar. Në Suren Kehf, ajeti 50 thuhet se djajtë janë prej kategorisë së xhindëve. Djalli është një qenie që e shtyn njeriun në rrugë të gabuar, që e cyt zemrën e tij nga jashtë dhe i pëshpërit fshehtas. (Surja Nas, 5)

Në Suren Bekare, ajeti 34 përmendet njoftimi i Allahut ndërkohë që iblisi (djalli) jetonte me engjëjt në xhenet: **“...Kur u thamë engjëjve (dhe xhindëve): ‘Përluni në sexhde para Ademit, ata u përlun,**

përveç Iblisit (djallit), i cili nuk deshi, u tregua mendjemadh dhe u bë mosbesimtar.”

Fakti se përse djalli nuk i bëri sexhde Ademit shpjegohet kështu në Suren A'raf, ajeti 12: **“Allahu tha: ‘Çfarë të pengoi ty të mos përuleshe, kur të urdhërova?’ Ai (iblisi) u përgjigj: ‘Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta’.** (Tha se zjarri ka pozitë më të lartë se balta dhe kundërshtoi duke mos iu bindur urdhrit të bënte sexhde (t'i përkulej) Ademit).”

Edhe xhindët, si djalli dhe njerëzit, hanë, pinë, lindin, martohen, bëjnë fëmijë dhe vdesin. Profeti, (a.s.), i shikonte e i njihte xhindët. Ai ishte profet edhe i tyre. Ai gjykonte për zgjidhjen e problemeve midis xhindëve.

Sulejmani, (a.s.), ndërtoi Mesxhid-i Aksanë, duke vënë në punë edhe xhindët. Xhindët nuk e dinë të fshehtën. Në Suren Se'be ajeti 14 bëhet e ditur se xhindët nuk e dinë të fshehtën.

Krijimi i xhindëve daton para krijimit të njerëzve.

Njerëzit, të cilët i mashtroi për herë të parë djalli dhe u përpoq t'i nxirrte nga rruga e drejtë duke u betuar rrejshëm, ishin prindërit tanë Ademi dhe Havaja (a.s.). Ademi, (a.s.), bashkë me nënën tonë, Hava, jetonin në xhenet. Teksa hëngrën nga pema që ua kishte ndaluar Allahu, djalli i këshilloi dhe i garantoj ata duke u betuar rrejshëm se nuk do t'i dëmtonte asgjë, nuk do të dilnin nga xheneti dhe do të qëndronin përjetësisht në të. Në Suren Araf, ajetet 19-22 përmenden: **"Dhe iu betua atyre (duke thënë): 'Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sinqertë!'"**

Djajtë i zbukurojnë gjërat e gabuara për të devijuar njerëzit nga rruga e drejtë. (Surja An-kebut, 38) Djalli është përpjekur ta nxjerrë nga rruga babain tonë, Ademin, (a.s.), i cili është njeriu dhe profeti i parë dhe ta nxjerrë bashkë me bashkëshorten e tij prej xhenetit. Vallë, a nuk mund të na devijojë nga rruga e drejtë djalli, si (nipër) pasardhës të babait tonë Ademit?

Në Suren Araf, ajeti 17 thuhet se djalli do t'i largojë njerëzit nga rruga e drejtë: **"(ai kundërshtoi Allahun duke thënë: ...) e pastaj, do t'u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vëshesh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës!"**

Çfarë dëshirojnë të bëjnë djajtë për t'i devijuar njerëzit në rrugë të keqe? Për këtë, në Suren Maide, ajeti 91 thuhet: **"Vërtet, djalli me pije alkoolike (që të dehin) dhe me bixhoz kërkon të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë (nga këto)?"**

Gjithashtu, në Suren Bekare, ajeti 268 bëhet e ditur se djalli i urdhëron njerëzit në varfëri dhe ligësi. Megjithatë, siç është djalli prej xhindëve që kanë

devijuar, ashtu është edhe prej njerëzve. Për këtë, në Suren Nas, ajetet 4, 5, 6, thuhet: **"(Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve) ... nga sherri i djallit cytës (që u cyt njerëzve gjëra të këqija) që fshihet (pasi cyt) e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (qoftë ai djalli) prej xhindëve apo njerëzve!"** Në këtë sure bëhet e ditur se ka edhe djaj prej njerëzve përveç djallit prej xhindëve.

Cila është detyra që na bie? Është ta njohim djallin si armik dhe të mos shkojmë pas gjurmëve të tij. Prej nesh kërkohet mbështetje te Allahu për t'u mbrojtur nga sherri dhe cytjet e këtij djalli. Në suren Mu'minin, ajeti 97 thuhet: **"Dhe thuaj: 'O Zoti im, kërkoj të më mbrosh nga nxitjet (shigjetat helmuese që i hedhin në zemër) e dajave ...'"** Mënyra për t'u mbrojtur nga djalli është të mbizotërosh mendjen dhe të

mbrohesh nga sherri i djallit, duke lexuar: **"Eudhu bil-lahi mine'sh-shejtani'rr-raxhim!"**, që është arma shpirtërore e besimtarit.

Si përfundim, kur të hyjë në xhenet i zgjedhuri për në xhenet dhe në xhehenem i zgjedhuri për në xhehenem; kur të mblidhen rreth djallit pasuesit e tij dhe t'i thonë se na mashtrove dhe u bërë shkak që ne të hyjmë në xhehenem, përgjigjen që jep djalli e mësojmë nga Surja Ibrahim, ajeti 22: **"Dhe, kur të marrë fund**

puna, djalli do t'u thotë (atyre): 'Vërtet, Allahu ju bëri një premtim të vërtetë. Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova (devijova nga fjala ime). Unë nuk kam pasur kurrfarë (force) pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra (të mohonit dhe kundërshtonit) e ju m'u përgjigjët. Prandaj, mos më qortoni mua, por qortoni veten! Unë nuk jam shpëtimtari juaj e as ju nuk jeni shpëtimtarët e mi! ...'"

Profeti, (a.s.), ka thënë: **"Çdo njeri ka një djall."** Myslimani duhet të kërkojë gjithnjë mbrojtje prej Allahut. Nga Profeti këshillohet leximi i Ajetu'l-Kursij dhe i sureve Felek e Nas kundër ndikimit negativ të xhindit dhe djallit. (Buhari, "Vekale-Kujdestaria", 10; Tirmidhi "Tib-Mjekësia", 16)

Allahu na mbroftë nga e keqja e dajave prej njerëzve dhe xhindëve!

"Vërtet, djalli me pije alkoolike (që të dehin) dhe me bixhoz kërkon të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë (nga këto)?"

Realiteti i vdekjes NË KURAN

Dr. Kerim Bulladë

Allahu i Lartësuar, në Suren Enbija, ajeti 34 thotë: ***“Ne nuk kemi bërë asnjë të pavdekshëm para teje. Pra, nëse ti vdes, a do të mbesin ata të përjetshëm?”***

Shkrimin tonë duam ta fillojmë në kuadrin e vargjeve të mësipërme kuranore dhe të kontribuojmë për të bërë një përlogaritje të hollë, duke theksuar edhe një herë realitetin e vdekjes.

Taberi e ka komenduar kështu këtë ajet: “O Muhammed! Ne nuk kemi krijuar para teje askënd prej bijëve të Ademit, i cili do të jetë i përjetshëm, që të të krijojmë edhe ty të përjetshëm atje. Edhe ti do të vdesësh patjetër, ashtu siç kanë vdekur profetët para teje. Nëse ti vdes, a do të mbesin të përjetshëm pas teje në këtë botë ata që i bëjnë ortakëri Zotit të tyre? Jo, situata nuk është aspak e tillë. Edhe nëse jeton apo vdes edhe ata do të vdesin patjetër.” (Taberi, Muhammed b. Xhafer et-Taberi, Xhamiu'l-Bejan fi Tefsiri'l-Kur'an, Kajro, 1987, vol. IX, kapitull. XVII, 18-19.)

Sipas mendimit të shumicës së komentuesve, ky ajet ka zbritur pas fjalës së politeistëve për Profetin, (a.s.): ***“A mos vallë po thonë: ‘Ai është vjershëtar, të presim derisa ta zhdukë vdekja?’***” në ajetin 34 të sures Tur. Ata donin që Profetin, (a.s.), ta godiste ndonjë shqetësim dhe të ngushëlloheshin e të gëzoheshin me këtë. (Shevkani, Muhammed b. Ali b. Muhammed esh-Shevkani, Fethu'l-Kadir Xhamiu bejne Fennej'r-Rivajeti ve'd-Dirajeti min Ilmi't-Tefsir, Tas'hih, Ahmed Abdus-selam, Bejrut, 1994, III, 503; Nisaburi, Muhammed b. Hysejn Kummi en-Nisaburi, Tefsiru Garaibi'l-Kur'an ve Ragaibu'l-Furkan, Bejrut, 1987, vol. IX, kapitull. XVII, 21 (Është botuar në anë të tefsirit të Taberit).

Askush nuk e di ku, në ç'kohë dhe si do të vdesë.

Kjo është një çështje e fshehtë. Njeriu vdes atje ku Allahu ia ka përcaktuar vendin. Pas betejës së Uhudit, mushrikët (politeistët) filluan të bënë thashetheme dhe e shfaqën hidhërimin e tyre duke thënë: "Po të kishin marrë mendimin tonë në këtë çështje, nuk do të vdisim këtu." Ata pretendonin se do të shpëtonin nga vdekja duke mos marrë pjesë në betejë, nëse ata vetë do të kishin një autorizim lidhur me të. U kërkua një përgjigje e këtillë nga Profeti, (a.s.), për fjalimin e tyre të pavlerë dhe për moszotërimin e kompetencave të përcaktimit dhe planeve rreth realitetit të vdekjes. **"... Thuaju: 'Edhe sikur të kishit qenë nëpër shtëpitë tuaja, prapëseprapë atyre që u është shkruar të vriten, do të dilnin në vendin e vrasjes...'"** (Al' Imran, 154)

Askush nuk vdes pa caktimin dhe lejen e Allahut. Asnjë armik dhe asnjë sulmues nuk mund ta vrasë dikë, të cilit nuk i është shkruar vdekja akoma. Në të vërtetë, Kurani i referohet kësaj çështjeje me shprehjen: **"Çdo shpirt vdes vetëm me lejen e Allahut, ngase vdekja është shkruar sipas një kohe të caktuar..."** (Al' Imran, 145)

Siç e pamë, vdekja ndodh vetëm me caktimin dhe lejen (vullnetin) e Allahut. Por njeriu duhet të marrë masa të rëndësishme dhe të bëjë përgatitjet e domosdoshme kundër rreziqeve, sëmundjeve dhe sulmeve të ndryshme, si dhe të përpiqet të çojë në vend të gjitha mundësitë për t'u vetëmbrojtur. Kjo është detyra e tij si njeri. Por nuk është në dorën e tij pen- gesa dhe vonesa e vdekjes. Nuk i është bërë e ditur askujt se kur do t'i vijë vdekja. Nuk ka asnjë zgjidhje tjetër përveç bindjes për këtë çështje.

Sado fort të mbrohet njeriu, sado të marrë masa, sado të përpiqet për të ruajtur veten, vdekja do ta kapë atë. Ajeti 78 i Sures Nisa e thekson kështu këtë fakt: **"Vdekja do t'ju arrijë kudo që të gjendeni, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta!"** Sa njerëz të fuqishëm, të zotë, arrogantë për të pranuar pamposhtjen e tyre dhe që cenojnë të drejtat e njerëzve kanë rënë pre e vdekjes, por ky vetëpëlqim nuk u ka siguruar atyre asnjë dobi.

Faraoni, që persekutoi bijtë e Izraelit dhe prete- ndonte hyjnizim, u mbyt në detin e kuq bashkë me ushtrinë e vet, duke përzënë Hz. Musain dhe ata që i

besuan atij. Kurani i Madhërishtëm na njofton kështu për fjalët që tha dhe përsëriti Faraoni gjatë mbytjes, në mënyrë që gjithë njerëzimi të marrë mësim:

"Ne i mbartëm izraelitët përtej detit dhe Faraoni me ushtrinë e tij i ndoqi ata nga ligësia dhe armi- qësia. Por, kur po mbytej, (Faraoni) tha: 'Besoj se s'ka zot tjetër përveç Atij që i besojnë bijtë e Izra- elit; dhe unë jam prej myslimanëve.' "Vallë, tani (po beson), ndërkohë që më parë ishe i padëgjueshëm dhe ngatërrestar? Sot do të shpëtojmë vetëm tru- pin tënd, që të bëhesh mësim për ata që vijnë pas teje." (Junus, 90-92)

Sado të arratiset njeriu, sado të marrë masa, vdek- ja do ta arrijë atë. Rreth kësaj çështjeje është thënë kështu: **"Vdekja prej së cilës po ikni, do t'ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, i Cili e di të paduk- shmen dhe të dukshmen dhe Ai do t'ju njoftojë ju për atë që keni bërë."** (Xhumu'a, 8)

Siç vihet re qartë në ajet, vdek- ja është kthim tek Allahu. Vdekja është përcaktuar për njeriun që të pyetet se si e ka harxhuar mi- rësinë e jetës që i është dhënë si amanet dhe përgjegjësi. Të gjithë do të njoftohen për çdo gjë që kanë bërë. Çdo gjë është e përkohshme, përveç Allahut. **"Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim."** (Rahman, 26-27) Çdo njeri do të vdesë dhe do të kthehet pranë Allahut të Lartësuar.

"Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni." (Ankebut, 57)

Domethënë, vdekja është pragu i sprovës. Pasi të kalohet ky prag, të gjithë ne do të japim provimet e jetës. Atëherë, le të bëjmë përgatitje siç theksohet në ajetin 18 të Sures Hashr: **"O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!"**

Duhet të shkojmë të përgatitur përtej vdekjes dhe ta bëjmë gjithmonë llogarinë e kësaj. Duhet të respek- tojmë kënaqësinë e Allahut në të gjitha punët tona dhe ta ndërtojmë jetën tonë sipas kësaj. Sepse ne jemi të vdekshëm. Kemi ardhur në këtë botë për t'u sprovuar. Për të fituar provimin, duhet të japim përpjekjet tona për të jetuar si myslimanë.

Thuaj:
"Vdekja prej së cilës
po ikni, do t'ju arrijë.
Pastaj, ju do të ktheheni tek
Ai, i Cili e di të padukshmen
dhe të dukshmen dhe Ai
do t'ju njoftojë ju për atë
që keni bërë."

(Xhumu'a, 8)

NUK KA UDHËZIM PA PEJGAMBERË

Prof. dr. Sulejman Derin

Për të arritur tek e vërteta, njerëzit zakonisht ndjekin dy rrugë. Ose lidhen me filozofë që pretendojnë se zgjidhin gjithçka vetëm me mendje, ose ndjekin pejgamberët që ka dërguar Allahu, të cilët janë udhërrëfyes që ndjekin udhëzimet e Zotit. Sado që mendja është një mjet mjaft me rëndësi për të arritur tek e vërteta, të ndjekësh atë duke anashkaluar shpalljen hyjnore, sipas Imam Rabbanit, nuk është tjetër veçse devijim. Veçanërisht në ditët e sotme, kur mendja është kthyer në idhull dhe ka mbërritur deri aty sa të përshtaten tekstet fetare sipas mendjes, *Letra* e Imam Rabbanit përbën një rëndësi të veçantë. Imam Rabbani fillon *Letrën* e tij, duke kujtuar rëndësinë që kanë për njerëzimin pejgamberët:

Pejgamberët janë mëshirë për botët. Allahu i Lartmadhëruar, për njerëz si ne, të mangët në arsyetim dhe me kufizime të caktuara gjykimi, përmes njerëzve të tillë të lartë, e ka bërë të ditur origjinalitetin (Dhati) dhe cilësitë (Sifat) e Tij. Kështu, Ai na i ka bërë të ditura thellësitë e gjykimit që kanë origjinaliteti dhe cilësitë e Zotit. Sërisht, po këta njerëz të mëdhenj na kanë lajmëruar se cilat janë ato vepra që pëlqen Zoti dhe cilat janë ato që nuk i pëlqen Ai. Na kanë dhënë mundësinë të marrim përfitimet tona të kësaj bote dhe të tjetrës, si dhe na kanë mësuar se si të shpëtojmë nga dëmet. Sikur të mos ishin këto personalitete, mendja njerëzore do të ishte e pafuqishme të perceptonte ekzistencën e Allahut e as që do të kuptonte përsosmërinë e Tij. Për këtë arsye, filozofët grekë që e shikonin veten si shumë të mençur, duke refuzuar ekzistencën e Allahut, ndryshimin që ndodh në gjithësi e kanë lidhur me kohën. (III, 23.)

Imam Rabbani mendon se edhe ata filozofë që pretendojnë se kanë arritur tek e vërteta vetëm përmes arsytimit, këtë nuk e kanë bërë siç thonë ata përmes arsytimit, por duke shfrytëzuar dritën e pejgamberëve. Sidoqoftë, këta filozofë nuk i kanë lënë në pjesën e natyrshme të tyre ato çfarë kanë marrë nga pejgamberët, por i kanë përzier me dëshirat dhe epshin e tyre:




Si përfundim, pa pasur ndërmjetësimin e pejgamberëve mendja është një mjet i mangët për të arritur të perceptojë origjinalitetin dhe cilësitë e Allahut. Atëherë kur u përhap kumtesa që kanë bërë pejgamberët për ekzistencën e Allahut, njerëzit e çdo epoke të dhënë pas epshit, kur panë që ftesat e tyre po pranohen, u detyruan të pranenin ekzistencën e Allahut, si dhe krijimin e gjërave ia adresuan Allahut. Ky është një nur i marrë nga pishtari i pejgamberëve, i cili do të ndizet deri në pafundësi. Ndërkaq edhe cilësitë e Allahut, dërgimi i pejgamberëve, pafajshmëria e engjëjve, ringjallja, xheneti – xhehenemi, dhuntia e përhershme apo dënimi i përhershëm etj., janë të vërtetat që përcillen tek ne përmes kumtesës së pejgamberëve. Mendja është e paaftë të perceptojë në mënyrë të pavarur ekzistencën e Zotit. Një njeri që mendjen e sheh si burimin e vetëm të diturisë dhe nuk pranon asnjë

mjet tjetër dijeje përveç saj, në fakt ka mohuar institucionin e profetësisë dhe u ka shpallur luftë të vërtetave të qarta.

Imami, duke treguar se shumica e filozofëve grekë nuk kanë arritur tek e vërteta, shprehet kështu:

“Sikur mendja të mjaftonte e vetme, atëherë filozofët grekë që kanë pranuar një gjë të tillë, nuk do të binin në greminën e devijimit dhe do ta njihnin Allahun më parë se të gjithë. Mirëpo, ata janë njerëzit më injorantë lidhur me njohjen e origjinalitetit dhe cilësive të Allahut. Pasi ata mendojnë se Allahu po pret në një vend të zbrazët dhe pretendojnë se vetëm diçka del prej tyre dhe kjo gjë nuk del nga vullneti i Allahut dhe që do të realizohet në mënyrë të domosdoshme.

Filozofët kanë imagjinuar diçka me emrin “*akli faal*” (intelekti aktiv) dhe kanë menduar se gjithçka bazohet te kjo. Kështu, nuk ia kanë adresuar Allahut ngjarjet në gjithësi, si krijuesi i qiejve dhe tokës, pra nuk ia kanë dedikuar veprën mjeshtrit të vërtetë, por diçkaje tjetër imagjinare. Sipas tyre, përfundimi, është përfundimi i shkakut të afërm. Shkaku i të qenit larg nuk ka asnjëfarë ndikimi. Për arsye të injorancës



së tyre, të qenit diçka “e Allahut”, kanë menduar se është pjesë e përsosmërisë së Allahut dhe të qenit Allahu ‘i zbrazët’ është një lartësim për Allahun. Ndërkohë Zoti i Madhëruar në Kuranin Famëlar – të lavdëron veten duke thënë: “Zoti i Tokëve dhe Qiejve dhe Zoti i Lindjes dhe i Perëndimit!” Ata, sipas filozofisë së tyre, nuk kanë nevojë për Allahun dhe as që të mbështeten tek Ai. Kështu, kur gjenden në vështirësi, i referohen *intelektit aktiv* dhe kërkojnë prej tij atë çfarë u duhet. Mirëpo, sipas besimit të tyre, për arsye se është i domosdoshëm veprimi i *intelektit aktiv*, nuk duhet ta kërkojnë as prej tij.”

Së dyti, Imami, kritikon edhe ata që i besojnë vetëm zbulimit hyjnor (keshf) dhe frymëzimit hyjnor (ilham).

Sado që ai është një sufi, nuk ruhet që të mos paraqesë gabimet që bëjnë sufitë. Aq sa mendja nuk mund të jetë mjet i mjaftueshëm që njeriu të arrijë tek e vërteta, pa ndihmën e profetëve; as *rijazeti* me *muxhahede* – në nuk mund të jenë si mjete të mjaftueshme për të mbërritur tek Allahu. Imami këtë gjendje e shpreh kështu: “Një grup nga këta filozofë në fjalë, kanë zgjedhur rrugën e *rijazet*-it dhe *muxhahede*-së, ata nuk kanë pranuar si udhërrëfyes pejgamberët, por sufitë që gjenden në çdo shekull. Këta njerëz, kanë pranuar si masë për gjendjet e tjera, zbulimet hyjnore (keshif) imagjinare duke u mashtruar pas ëndrrave dhe imagjinatave, sipas thjeshtësisë së gjendjes së tyre. Gjendja e qetë dhe e paqetë që përshkruajnë ata, në fakt është vetëm një gjendje e nefsit, që e shpie njeriun në devijim.

Si përfundim, çdo mjet që bëhet shkak për të arritur tek Zoti, qoftë zemra dhe qoftë mendja, ka nevojë për udhëzimin e pejgamberëve dhe mbikëqyrjen e tyre. Ata që përjashtojnë pejgamberët, çfarëdolloj metode që të përdorin, qoftë atë të tasavufit apo të filozofisë, nuk mund të arrijnë tek e vërteta.

Lutja që i bëjmë Zotit, është që të na udhëzojë në rrugë të vërtetë bashkë me mendjen dhe zemrën tonë brenda kontureve të sunetit profetik dhe të na mbrojë nga teprimi.

Amin!



Mos mendo kurrë **SE ALLAHU** **NUK E VËREN ATË QË BËJNË KEQBËRËSIT!**

Prof. dr. Omer Çelik

Titullin e këtij shkrimi e mora nga ajeti 42 i sures Ibrahim. Ky mesazh hyjnor është një ngushëllim për të gjithë të shtypurit që rezistojnë ndaj mizorive anembanë botës, kurse për zemrën e keqbërësve është një kërcënim.

Me keqardhje duhet thënë se skenat makabre në ditët e sotme po ndjekin njëra – tjetrën. Gjaku i myslimanëve po rrjedh pareshtur.

Lufta civile, që vazhdon prej dy vitesh e gjysmë në Siri, u bë shkak që me mijëra njerëz të vdesin, me qindra mijëra të mbesin pa strehim dhe pa asnjëfarë mbështetjeje. U vranë gra, fëmijë dhe të moshuar. Me

mijëra njerëz u vranë si pasojë e armëve kimike.

Ato çfarë po përjetohen në Egjipt janë një tjetër vitrinë e makabritetit. U hap zjarr me plumba të vërtetë ndaj atyre njerëzve që bënin protestë paqësore, për të mbrojtur të drejtat e tyre më të natyrshme, ata njerëz që shprehnin se edhe sikur t'i vrisnin, nuk do të vrisnin njeri. Me mijëra njerëz u vranë pa mëshirë dhe me mijëra u plagosën.

Ato çfarë ndodhën në Irak, Palestinë, Afganistan, Turkistanin Lindor dhe në Birmani janë ngjarje të ngjashme me njëra-tjetrën...

Në fakt, keqbërja është një veçori e pandarë e na-

tyrshmërisë së njerëzve profanë të çdo fushe njerëzore. Kur Allahu i Madh ua ofroi qiejve, tokës dhe maleve amanetin e robërisë ndaj Tij, ata nuk pranuan të merrnin përsipër përgjegjësinë e rëndesës së këtij amaneti, pasi atë e panë si shumë *"dhalum"* (dhunë) dhe shumë *"xhehul"* (inJORANCË). Pikërisht kjo është edhe urtësia e dërgimit të pejgamberëve dhe librave të shenjtë. Këto dituri të sakta, që vijnë nga Allahu, do ta kuronin sëmundjen e inJORANCËS së njeriut; kurse kryerja e veprave të mbara, do t'ia shëronte njeriut sëmundjen e *"mizorisë"*. Mirëpo, njerëzit që rriten në mungesë me edukimin dhe arsimimin fetar, për arsye se nuk mund të kurojnë sëmundjen e dhunimit dhe të inJORANCËS, në këtë mënyrë do të vijnë si burimi i së ligës dhe së keqes. Mizoria dhe padrejtësia më e madhe, do të burojnë prej tyre, pasi Zoti i Madhëruar ka njoftuar se femohuesit janë gjallesat më të liga që ecin mbi sipërfaqen e tokës. (Shih. Enfal, 55.)

Në procesin historik veçoria e të qenit të njeriut kaq mizor, shkatërrimtar dhe gjakatar, ka pasur pasqyrime në përmbajtje dhe thellësi të ndryshme. Kur u hedhim një sy shembujve që jepen në Kuranin Famëllartë, përballemi me skena që njeriun e bëjnë të tmerrohet:

Shokët e Uhdudit u hodhën në mënyrë të pamëshirshme në gropën me flakë. Ndoshta ata ishin me mijëra... Vetëm pse besonin në Allah u hodhën të digjeshin në zjarr. Ata që e bënë këtë vepër makabre, u ulën të qetë duke parë se si do të digjeshin besimtarët.

Faraoni i dhunonte bijtë e Izraelit. Duke i asimiluar, donte t'ua shuante rrënjët e tyre. Sipas një ëndrre të keqe që pa, vrau të gjithë fëmijët meshkuj që hapën sytë në këtë botë, duke menduar: "Ky është djali që do të më shkatërrojë pushtetin tim". Thuhet se janë vrarë me dhjetëra mijëra fëmijë të sapolindur...

Magjistarëve, të cilët nuk u vinin veshin kërcënimeve "të var, të vras!", të Faraonit, iu prenë këmbët tërthorazi dhe u varën në pemët e hurmave. Ky fund i tyre ishte vetëm pse besonin Allahun. Dhe në frymën e fundit janë lutur duke thënë: **"O Zoti ynë, na jep durim të madh dhe bëna të vdesim myslimanë!"** (Araf, 126), me kujdesin që "të mund të vdisnin si myslimanë".

Habibi Nexhari u martirizua duke u gjuajtur me gurë dhe duke u rrahur, vetëm pse mbështeti delegacionin që kishte ardhur për t'i ftuar njerëzit në besimin e vërtetë dhe, ngaqë ai ftoi të afërmit e vet tek e vërteta. Dhunohet dhe vritet. Mirëpo, kur është duke vdekur, me një zemër të gjerë dhe me ndjenjën



e mëshirës, lutet: **“Ah, sikur ta dinte populli im se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!”** (Jasin, 26 – 27)

Sa e sa ngjarje tregohen në Kuranin Famëlartë, me qëllim që njeriu të marrë shembull...

Kjo do të thotë se skenat e tmerrshme makabre nuk ndodhin vetëm në ditët e sotme. Natyrisht që kjo gjë nuk bën që ta shikojmë mizorinë si diçka normale. Mizoria është mizori dhe duhet dënuar mjaft i ashpër. Mirëpo, shembujt që kemi dhënë lart janë për t’u analizuar shumë thellë, me mendje të shëndoshë dhe gjakftohtë. Besimtarit i jep fuqi dhe vendosmëri të veçantë fakti që ai është në një sprovë. Pejgamberit (a.s.), thuajse i është marrë fryma përballë dhunës dhe mizorisë dhe formave të ndryshme të saj, por sjellja e tij është bërë burim ngushëllimi dhe qëndrese për të gjithë njerëzit.

Nuk duhet harruar edhe ky detaj: nëse keqbërësi ka me vete keqbërjen dhe fuqinë e ushtrimit të dhunës, i dhunuari ka me vete Allahun. Allahu i Madhëruar herët a vonë do ta ndihmojë të dhunuarin. Do të largohen errësirat dhe do të lindë dielli i lumturisë dhe i gëzimit në atmosferën e prehes së Islamit.

Mes duasë së të dhunuarit dhe Allahut nuk ka asnjë pengesë. Allahu përmbush medoemos duanë e të dhunuarit.

Atëherë kur i dhunuari fiton fuqi, ka të drejtë të rimarrë të drejtën e cenuar nga dhunuesi brenda kornizës juridike. Aq sa ka bërë dhunuesi ndaj të dhunuarit, i ushtrohet në të njëjtën masë ligjore edhe dhunuesit. Kjo është e drejta e tij më e natyrshme. Mirëpo, kur je i fuqishëm, falja dhe durimi kanë një vend të veçantë për nga aspekti i krijimit të paqes dhe qetësisë në botë. Për këtë ka shumë shembuj:

Kur mushrikët e braktisën Uhudin, Resulullahu (a.s.), shkoi pranë të vvarëve. Ai u përball me një skenë që e lodhi shumë shpirtërisht. Pasi pa që ia kishin hapur barkun xhaxhait të vet, që e donte aq shumë, Hz. Hamzait, dhe ia kishin prerë hundën dhe veshët, psherëtiu në këtë mënyrë:

“Sikur të mos ishin mërzhitur gratë dhe sikur të mos ishte një mënyrë që do të ndiqej pasi të iki unë nga kjo botë, do ta lija në atë mënyrë deri në çastin e

ringjalljes, në Ditën e Kiametit, që ta hanin kafshët dhe shpendët grabitqare. Beto hem që, në vendin e tij, do të bëj kisas shtatëdhjetë mushrikë.”

Pastaj kërkoi të sillej një mbulesë. Me atë mbuloi fytyrën e Hamzait (r.a.), kurse këmbët i mbetën jash-të. Resulullahu (a.s.), me atë mbulesë mbuloi fytyrën, ndërsa këmbët ia mbuloi me barin iz’hir. Dhe pasi e mori përpara, bëri dhjetë herë tekbir. Pastaj u mblo-dhën të gjithë shehidët përreth dhe iu fal namazi i xhenazes. Kurse Hz. Hamzain (r.a.), e lanë në vendin ku e kishte lënë ai. Kështu që, për Hz. Hamzain u fal shtatëdhjetë herë namazi i xhenazes, sepse numri i atyre që kishin rënë shehidë në Uhud ishte shtatëdh-jetë. Pasi përfundoi varrimi i shehidëve, u shpallën ajetet 126 – 127 të sures Nahl;

“Nëse ndëshkoni, ndëshkoni aq sa jeni ndëshkuar, por, nëse duroni, kjo është më e mira (rru-

gë) për të durueshmit. Prandaj duro! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Dhe mos u pikëllo për ta e mos u ngushtoj për shkak të dredhi-ve të tyre!” I Dërguari i Allahut (a.s.), duroi dhe nuk i bëri askujt kisas. (Darekutni, IV, 118)

Allahu i Madhëruar thotë:

“Shpërblimi për të keqen është i njëjtë me atë të keqe. Por atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i Allahut. Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët.”

(Shura, 40)

Të kundërveprosh ndaj së keqes me të njëjtën masë është drejtësi, kurse të durosh të keqen që të bëhet dhe ta falësh atë që ta bën atë, është një virtyt i lartë. Këto ajete, përmes Resulullahut (a.s.), këshillojnë të gjithë besimtarët të veprojnë me kujdes dhe me virtyte, të jenë të durueshëm dhe të matur.

Sa skenë e mrekullueshme është shembulli i faljes që tregoi Resulullahu (a.s.), ndaj armiqve të përbe-tuar të myslimanëve gjatë çlirimit të Mekës!

Me shpresën që të vijnë ditët e lumtura, të paqta dhe të gëzuara, kur mund të marrim fuqi dhe pushtet për të shpëtuar nga të qenit të dhunuar; kur mund të mbrojmë të drejtat e atyre që janë dhunuar, ashtu sikurse mbrojmë të drejtën tonë; kur të manifestoj-më shembuj faljeje që bëjnë njerëzit të ngrohen me Islamin, madje edhe vetë mizorët...



MENDJA E SHËNDOSHË DHE DREJTËSIA

M. Sami Ramazanogllu



I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

"Kush pretendon se është e vetja diçka që nuk i përket atij, ai nuk është prej nesh, nuk është prej atyreve që janë në rrugën tonë. Ai le të përgatisë vendin e tij në zjarr (xhehenem)." (Ibn Maxhe)

"Nëse njerëzve do t'u jepej gjithçka dëshironin, padyshim që atëherë disa njerëz do të ankoheshin për pasuritë dhe të drejtat e të tjerëve." (Buhariu)

"Të gjithë njerëzit janë të barabartë, porsì dhëmbëzat e krehrit. Vetëm përmes ibadeteve bëhen njëri më i lartë se tjetri. Mos u bëj mik me asnjërin që nuk e sheh gabimin si gabim dhe të drejtën si të drejtë!"

Ja një nga burimet e shenjta të të drejtave të njeriut dhe barazisë njerëzore; demokracisë islame!

Koncepti i ibadetit që të jep mundësinë e lartësisë, është gjithëpërfshirës për të gjitha detyrat e njeriut, qofshin personale, familjare apo edhe kombëtare, sepse që të gjitha këto janë ibadet në fenë tonë. Në këtë hadith, nënvizohen të drejtat dhe detyrat e ndërsjella të miqësisë.

"Shkaku pse u shkatërruan ata që ishin para jush, ishte vetëm për këtë: nuk ia vinin veshin atij që ishte i ndershëm dhe kur kishte njerëz të dobët vepronin me ashpërsi kundrejt tij. Beto hem në Allahun që, nëse edhe vajza e Muhamedit, Fatimeja do të vidhte, do t'ia prisja dorën pa hezitim." (Buhariu, Muslimi)

"Nëse gjyqtari jep një gjykim duke u përpjekur në maksimumin e tij për ta zgjidhur, dhe arrin ta zgjidhë me drejtësi, atëherë ka dy sevape. Nëse pasi të ketë bërë përpjekje jep një vendim dhe vendimi i tij nuk është i drejtë, atëherë ka vetëm një sevap." (Buhariu, Muslimi)

"Mua më keni sjellë të gjykoj çështjet tuaja, por unë nuk jam tjetër veçse një njeri. Mua nuk më vijnë me shpallje hyjnore se cili prej jush është i saktë e cili është i gabuar. Unë jap mendimin tim personal, kur nuk më vjen shpallja hyjnore lidhur me çështjet në diskutim."

Mundet që njëri mund ta trajtojë më mirë sesa tjetri çështjen e vet dhe e shpreh më me ndikim çështjen në favor të vet. Si rrjedhojë, unë duke menduar se ka ai të drejtë, jap gjykim në favor të tij. Por kushdo që sheh se unë kam gabuar dhe si pasojë ka përfituar diçka që i përket vëllait të vet, le të mos e marrë, pasi unë nuk i jap tjetër veçse një copë zjarri. Por, kush e merr përsipër këtë, le ta mbajë mbi shpinë ose të heqë dorë e t'i drejtohet Zotit të Vërtetë."

Sipas asaj çfarë thotë hadithi, ata që japin gjykime sipas asaj çfarë duket, nëse në të vërtetë kanë gabuar, kurrë nuk mund të shpëtojnë nga përgjegjësia hyjnore dhe shpirtërore. Ata pa diskutim do të dënohen, mos në këtë botë, në tjetrën.

"(O njerëz,) ju do të keni udhëheqës sipas gjendjes tuaj shpirtërore." (Dejlemiu)

Shtetet lindin nga strukturat shoqërore. Sa më e mirë dhe e shëndetshme të jetë struktura, pra shoqëria, edhe udhëheqja e saj ashtu do të jetë. Të mos i vendosësh rëndësinë e duhur strukturës dhe të presësh gjithçka nga shteti është e gabuar. Pikësëpari duhet të rregullojmë veten tonë, pastaj shoqërinë, atëherë do të shohim se gjithçka është rregulluar.

"Kur Allahu dëshiron t'i dhurojë mbarësi ndonjë drejtuesi (që përpiqet për mbarëvajtjen e njerëzve të vet), i jep një ndihmës të drejtë, që nëse drejtuesi harron diçka, ai ia kujton. Kështu ndihmohet drejtuesi. Kur Allahu dëshiron të mos i dhurojë mbarësi ndonjë drejtuesi (që nuk përpiqet për mbarëvajtjen e njerëzve të vet), atëherë i jep një ndihmës jo të drejtë, i cili nuk ia kujton atij gjërat që harron kur ai harron. Kështu nuk e ndihmon drejtuesin." (Ebu Davud)

"Të gjithë jeni barinj, të gjithë jeni përgjegjës për grigjën tuaj." (Buhariu)



Xhafer Durmush

EMRAT MË TË BUKUR TË ALLAHUT

Në tre ajetet e fundit të sures Hashr gjejmë një buqetë prej emrave më të bukur të Allahut të Lartësuar, të cilët janë çelësi i bamiresive dhe kyçi i të këqijave për besimtarët që e lexojnë atë duke besuar shpërblimin e saj. Këto janë ajete të bekuara që lutemi me disa prej emrave të Allahut të Lartësuar, duke thënë: **"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë."** (Fatiha, 5)

Tani mendoj se sa e ndjej dashurinë për emrat më të bukur të Allahut, kur më rrëshqasin fjalët nga goja. Sa i vetëdijshëm jam për përsosmërinë dhe hijeshinë në rregullsinë e saj? A jam gati të lexoj ajetet me aromë trëndafili dhe të hedh një hap përpara?

Thuhet: **"Ai është Allahu, përveç të Cilët nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim), Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes. Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti! Ai është Allahu, përveç të Cilët nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim). Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqëdhënësi, Dhënësi i siguri-së, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)! Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që çdo gjëje i jep trajtë. Atij i përkasin emrat më të bukur. Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti."** (Hashr, 22-24)

Sipas përkufizimeve në tefsir (interpretim), është e rëndësishme renditja e këtyre vargjeve (ajeteve) të begata, që përmenden për të shpjeguar madhështinë dhe fuqinë e Allahut të Lartësuar dhe për të dëshmuar domosdoshmërinë e frikës ndaj Allahut. Në të vërtetë, atributet (Rahman dhe Rahim) Gjithëmëshiruesi dhe Mëshirëploti - që do të ngjallin ndjenjën e dashurisë

dhe të shpresës kundrejt Allahut - kanë ardhur para të përmendurit e emrave. Dhe në të njëjtën fjalë, atributi *Ilm* (dituri) ka ardhur para *Rahmetit* (mëshirës) dhe *Vahdaniyeti* (njësimi) para *Ilmit* (diturisë). Dome thënë: hashjetullah nuk është frikë që përbëhet nga një lemeri absolute. Përkundrazi, është respektim absolut që është shkrirë me dashuri dhe respekt...

Allahu është hyjnia që edhe malet përlulen duke kërkitur nga frika ndaj Tij, i cili nuk ka të adhuroar tjetër përveç Allahut që meriton të adhurohet. Dhe Ai është i pastër nga çdo lloj përngjasimi. Çdo gjë që është në botën e fshehtë dhe të dukshme, është e përfshirë në Dijeninë e Tij.

Ai është *Rahman* (i Gjithëmëshirshmi) dhe *Rahim* (Mëshirëploti): i Gjithëmëshirshmi me mëshirën që do të përfshijë të gjitha krijesat në këtë botë; ndërsa Mëshirëploti me mëshirën që do të përfshijë vetëm besimtarët në botën tjetër (*ahiret*). *Melik* (Sunduesi), Ai është sunduesi i vërtetë. Ai zotëron aftësinë për të udhëhequr krijesat me urdhra dhe ndalesa. Është *Kuddus* (i Shenjti), Ai është i pastër nga çdo e metë.

Ai është *Selam* (Paqëdhënësi): jep mirëqenie dhe shëndet, qenia e Tij e Lartësuar është e mbrojtur nga të gjitha mangësitë. Është *Mu'min* (Dhënës i siguri-së): Ai jep ndjenjën e besueshmërisë dhe të siguri-së, njerëzit i bën të sigurtë nga padrejtësia dhe i mbron nga dënimi ata që kanë besuar. Ai është *Muhejmin* (Mbikëqyrësi mbi gjithçka): është Ai që mbron dhe plotëson çdo nevojë. Në qenien e Tij gjenden edhe atributet *Shahid* (Dëshmuesi), *Hafidh* (Mbrojtësi) dhe *Rakib* (Shoqëruesi), etj.

Ai është *Aziz* (i Plotfuqishmi): zotëron fuqi dhe forcë që askush nuk mund të dalë përballë Tij. Është *Xhebbbar* (Imponuesi): është zotërues i imponimit

dhe rregullon e ndreq çdo gjë me forcë. I zhgënjën të padrejtët dhe mjekon plagën e të dëmtuarve. Është *Mutekebbir* (Madhështori): Vetëm Ai zotëron madhësi dhe krenari, që krenaria e Tij është të mos denjosh për t'iu nënshtruar dikujt.

Ai është *Halik* (Krijuesi): Ai e krijoi dhe i dha vlerë gjithësisë me një urtësi që i përshtatet rendit të saj. Është *Bari'* (Zanafillësi): Ai shpik dhe krijon sipas përcaktimit për të cilin është folur më parë. Ai është *Musavvir* (Ai që i jep trajtë çdo gjëje): Ai krijon me gjendje dhe forma të posaçme trajtën e krijesave.

Me pak fjalë, Ai është Krijuesi, Rregulluesi dhe Formuesi. Fuqia e Tij mjafton për çdo gjë dhe sundon çdo gjë. Atij i takojnë emrat më të bukur. Ai ka edhe shumë emra/tribute të bukur që nuk janë përmendur këtu, që çdo gjë që ndodhet në qiej dhe në tokë madhëron qenien e Tij. Ka urtësi dhe është i gjithëfuqishëm në punën e Tij.

Transmetohet nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), se ka thënë kështu për vlerën e leximit të këtyre ajeteve të begata në mëngjes e mbrëmje: "*Allahu i Lartësuar i cakton shtatëdhjetë mijë engjëj atij që del në mëngjes dhe lexon tre ajetet e fundit të Sures Hashr, duke thënë: "Eudhu bil'lahi's-Semi'il-Alim mine'sh-Shejtani'rr-Rraxhim" dhe ata luten për të deri në mbrëmjen e asaj*

dite. Nëse e lexon kur arrin mbrëmjen, ka të njëjtën mbrojtje për atë deri në mëngjes." (Sujuti, ed-Durru'l-Mensur, 6/202)

Falënderojmë Allahun se një buqetë nga emrat më të bukur të Allahut që gjendet në ajetet që formulojnë temën tonë na ofrohen në mendjet tona me këtë rend. Profeti, (a.s.), na tregon për rëndësinë e leximit të këtyre. Ndërsa tani, ajo që kemi nevojë ne, është të fillojmë emrat më të bukur të Allahut në klimën e qetësisë çdo ditë në mëngjes, duke shpresuar virtytet që tregohen në hadithin sherif. Në mbrëmje, të futemi në bereqetin e darkës me të njëjtën qetësi. Të përvetësojmë me vetëdije përsëri se Ai është *Rahman* (i Gjithëmëshirshmi) dhe *Rahim* (Mëshirëploti), *Aziz* (i Plotfuqishmi) dhe *Hakim* (i Urti), *Mu'min* (Dhënës i sigurisë) dhe *Muhejmin* (Mbikëqyrësi mbi gjithçka). Duhet ta ndjejmë në damarët tanë se Ai është *Halik* (Krijuesi), *Bari'* (Zanafillësi) dhe *Musavvir* (Ai që i jep trajtë çdo gjëje), *Kuddus* (i Shenjti) dhe *Selam* (Paqëdhënësi), *Xhebbbar* (Imponuesi) dhe *Mutekebbir* (Madhështori). Të jesh i vetëdijshëm për mosekzistencën, duke menduar Madhësinë dhe Krenarinë e Allahut. Të marrësh frymë dhe të mbushesh me Atë, deri në palcë.

Lexo - Mendo

ÇFARË DO TË NDODHË NË TË ARDHMEN?

Siç na bën të ditur Kurani i Madhërishëm për ngjarjet që kanë ndodhur, në mënyrë që ne të marrim mësim; po ashtu na njofton edhe për ngjarjet që do të ndodhin, në mënyrë që ne të përgatitemi në kohën e duhur. Sa të vëmendshëm jemi ndaj tyre?

Për shembull: Bëhet fjalë për "**Për Lajmin e madh**" (Nebe, 2). Njoftohemi për "**Kur qielli të çahet dhe ujet të derdhen...**" (Infitar, 1-2) "**Kur Dielli të mblidhet e të humbë shkëlqimin...**" (Tekvir, 1) Në Suren Al'Imran, ajeti 185 thuhet: "**Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen.**" Surja Enbija, ajeti i parë na kujton: "**Po u afrohet njerëzve dita për të dhënë llogari, por ata vazhdojnë të jenë të shkujdesur e të shmangur (nga e vërteta)**". Muhbir-i Sadik - Lajmëruesi i Drejtë, (a.s.), na njofton fare qartë për këto realitete me shprehjen: "*Kur të vdesë njeriu, do të ndodhë kiameti i tij*".



Këtu, ne duhet të bëjmë këtë vlerësim: Kjo botë është kalimtare dhe përparon drejt fundit të vet që është përcaktuar. Ndërsa ne jemi udhëtarë të Ahi-retit, që kemi të drejtë të udhëtojmë aq sa është jeta jonë, e cila është përcaktuar për ne. Prandaj, në të ardhmen patjetër që do të ketë vdekje për të gjithë, do të ketë varr, do të ketë llogari, do të ketë jetë të amëshueshme. Më në fund, do të ketë takim në xhenet edhe me Bukurinë e Allahut (*Xhemalullah*). Do të ketë edhe nga ata që e meritojnë xhehenemin. Vendbanimi i përjetshëm do të jetë vendi tek i cili do të mbërrijnë. Dhe atje nuk bën dobi të thuash: "Sikur..."

Duhet t'i ndajmë kohë çdo gjëje sipas vlerës së saj. Udhëtari nuk duhet të ketë dashuri për banesën duke harruar destinacionin e tij. Ato që kanë ndodhur, duhet t'i shikojë me pikëpamjen për të nxjerrë mësim dhe t'u kushtojë kujdes informacioneve që do të ndodhin më vonë.

PËRPIEKJA E MYSLIMANIT ËSHTË LUTJE

Idris Arpat

Përpiku, sepse aq sa të përpiqesh do të marrësh. Punët që duhet të bësh, bëji edhe nëse janë të vështira. Mos të të interesojnë ligjet që janë vënë në të kaluarën. Ti merru me punët që duhet të bësh. Dijen e kaderit nuk e di as ti dhe as të tjerët. Ti bëj atë që duhet të bësh!"

Vlerën e njeriut e cakton synimi, vetëdija e përgjegjësisë dhe përpjekja. Përpara gjithë këtyre, vjen dija.

Nëse dëshirojmë që këtë jetë ta jetojmë me drejtësi e në përputhshmëri me kënaqësinë e Allahut Teala dhe të mos konsumohemi pa ndonjë qëllim në këtë botë të vdekshme, në krye të çdo pune na del përballë dija duke e shfaqur veten si një bazë e patundshme.

Së pari, ne duhet të dimë nga kemi ardhur, ku do të shkojmë dhe cila është detyra e misioni ynë në këtë botë. Që nga fillimi e deri në fund, rezultatet pozitive të synimit, vetëdijes së përgjegjësisë dhe përpjekjes sonë, janë në raport me kuptimin e saktë të natyrës së jetës. Destinacionin duhet ta përcaktojmë saktë dhe hartën e rrugës duhet ta lexojmë pa gabime.

Të gjitha përgjegjësitë e myslimanit i cakton Kurani Fisnik dhe Suneti (tradita profetike), i cili është shpjegim i Kuranit. Synimi përfundimtar i myslimanit në çdo vepër të tij, është kënaqësia e Allahut të Madhëruar. Përpjekja është xihadi i myslimanit. Ajo përfshin të gjitha mundimet për të kryer përgjegjësitë. Këto gjëra mund të mësohen vetëm me anë të dijes. Allahu Teala në Kuranin Famëlartë thotë: **"Njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar. Sigurisht se përpjekjet e tij do të shfaqen para syve kur të vijë dita dhe së fundi, do të shpërblehet me shpërblim të plotë."** (Nexhm, 39-41)

Pasi myslimani ta formojë saktë bazën mendore dhe shpirtërore,

nuk duhet të humbasë kohë, por duhet të përpiqet për të përparuar. Dyshimet dhe hezitimet duhet të kapërcen. Të urtët thonë: "Vendimi më i keq, është më i mirë se paqëndrueshmëria." Edhe pse është tepër pak në këtë fjalë, prapëseprapë është thënë saktë. Njeriu duhet të vendosë saktë dhe të marrë rrugën. Udhëtari duhet të udhëtojë. Për njeriun është e papranueshme të humbë kohë, ndërkohë që të gjitha krijesat në këtë botë lëvizin dhe kryejnë detyrat e tyre.

"O njerëz! Ai që shqetësohet (i prishet morali) për shkak të një fjale të padrejtë, nuk është i mençur. Edhe ai që kënaqet nga lavdërimi i injorantit, nuk është i urtë. Njerëzit njihen me arritjet që kanë korrur. Vlera e çdo njeriu është sa suksesi që ka arritur. Për të njohur vlerën tuaj, mësoni sa më shumë!" (Hz. Aliu r.a.)

"Jo vetëm namazi dhe agjërimi, por edhe vitet e kaluara kanë kaza. Ne duhet t'i bëjmë kaza vitet e kaluara. Por si? Duke punuar më shumë, duke kryer shërbime fetare dhe duke hapur medresetë që do të edukojnë me mijëra fëmijë..."

Çfarëdo që njeriu të kërkojë, duhet ta kërkojë nga Allahu (xh.xh.) dhe çfarëdo që të presë, përsëri duhet ta presë nga Allahu (xh.xh.). Ndërsa qëndrimet e tjera, janë adhurim ndaj krijesës. Njeriut duhet t'i interesojë vetëm detyra e tij. Ato çfarë thonë njerëzit, nuk kanë asnjë vlerë. Çdo vepër tonën, e shikon Allahu (xh.xh.) dhe e shkruajnë engjëjt. Kaq e thjeshtë është kjo çështje. Interesimi për atë që thonë njerëzit dhe jo për atë që thotë Allahut i Madhëruar, është një gjendje e dhimbshme që i ngjan orientimit nëpërmjet xixëllonjave kur ka lindur dielli.

Çdo përpjekje dhe çdo punë e mirë në interes të njerëzimit, është vepër e mirë dhe ibadet. Krahas këtyre, studimet shkencore ndihmojnë për ta jetuar jetën sipas orientimit islam, për ta bërë atë sa më produktive dhe sublime.

"Çdo punë, e bën njeriu. Njeriu punon duke formuar organizata dhe institucione."

Nëse detyrat në të kaluarën janë neglizhuar, do të thotë se barra është shumëfishuar dhe është bërë më e rëndë. Nëse koha nuk na mjafton për të kryer detyrat tona, do të thotë se duhet të punojmë më shumë. Koncepti "të bësh kaza vitet e kaluara", është një koncept shumë delikat. Ai reflekton vetëdijen e thellë të për-

gjegjesisë. Ky koncept do të thotë të shikosh shkaqet e mosrealizimit të punëve. Përpjekjet e vazhdueshme do të lindin nga ky kuptim dhe nga kjo ndjenjë.


"Njeriu nuk duhet të ankohet nga mjedisi, koha dhe kushtet negative. Përndryshe, nuk mund ta kryejë detyrën e tij. A nuk është detyrë e tij që ta rregullojë kohën nëse koha që jeton është e keqe?"

Sikur bota të ishte e rregulluar, atëherë nuk do të kishte nevojë për ta rregulluar. Si mund të ketë një botë të qetë, përderisa djalli nuk e lë djallëzinë e tij? Jeta është e ndërtuar mbi të kundërtat. Sido që të jetë gjendja dhe kushtet, njeriu duhet ta gjejë një mënyrë për rregullimin e tyre. Kjo është ajo që i ka hije umetit të Pejgamberit, (a.s.), që u dërgua si mëshirë për botët. Myslimanit nuk i ka hije të bëhet barrë për njerëzit dhe vendin.

Të mos u bëhesh barrë të tjerëve dhe të marrësh përsipër përgjegjësi, nuk është një cilësi e zakonit, por një gjendje e vetëdijes së lartë dhe një perceptim që e bën njeriun të marrë atë që ka hak, të hajë prej hallallit, të bëhet "dora që jep" dhe mëshirues për të gjitha krijesat. Këtë perceptim e kanë vetëm njerëzit e "Medinetu'l-Fadile". Këta janë njerëzit të cilëve ua ndjejmë mungesën dhe të cilët i presim me përmallim. Këta janë njerëzit që përpiqen me shpirt e me zemër deri në ditën e fundit, duke thënë: **"Shpërblimin tim ma jep vetëm Allahu."** (Junus, 72)

Referencat:

1. Mustafa Ėzdamar, "A. Gejlani", fq. 100, Botimet Kërkandil, Stamboll, 1977. 2. Hasan b. Ali Harrani, Tuhefu'l-Ukul, fq. 216 Përkth. F. Alltan, Botimet "Tuba", 1998. 3. Nga libri me titull "Haxhivejizade" i Davut Shenbabait, Revista Ilkadem, Gusht, 2005, Kjo fjalë i përket të ndjerit Haxhivejizade Mustafa Kuruxhus. 4. Thomas Carlyle, Heronjtë, fq. 229, Përkth. Behzat Tanç, Botimet Ėtyken, Stamboll. 2004.



THELBI I ISLAMIT

Sezal Engin

Ebu Davud es-Sixhistani është lindur në Sixhistan, në vitin 202 hixhri dhe ka ndërruar jetë në Basra, në vitin 275. Ai ishte pjesëtar i fisit Ezd të Jemenit. Është autori i veprës “Sunen-i Ebi Davud”, e cila ishte një nga *Kutubi Sitte* (gjashtë librat) e literaturës islame. Ebu Davudi i kishte radhitur hadithet në Sunen-in e tij sipas tematikave juridike islame. Në këtë vepër bënë pjesë 4800 hadithe, prej 500.000 të tillëve, që kishte mbledhur gjatë tërë jetës së tij.¹

Lidhur me këtë autor të vyer të Sunen-it, gjenden plot lëvdata të drejtuara figurës së tij. Musa bin Harun kishte thënë se ai njeri që krijoi për hadithe dhe se nuk kishte parë ndonjëherë njeri më të virtytshëm se ai. Kurse Hakim en-Nejsaburiu ka deklaruar se Ebu Davud ishte lideri i shekullit të hadithit. Sipas Ibn Hibbanit, Ebu Davudi ishte një nga dijetarët më të rëndësishëm për nga aspekti i njohurisë që kishte në fushën e hadithit dhe të drejtës islame; për fuqinë

e memorizimit që kishte dhe për nga aspekti i devocionit në Islam.² Ai ishte gjithashtu një nga personalitetet më të rëndësishme edhe për nga aspekti i memorizimit të haditheve; rigorozyetit mbi saktësinë e haditheve; si dhe sa i përket në ibadetit, takvasë, drejtësisë dhe i saktësisë në përzgjedhje.³

Krahas këtyre vlerësimeve lidhur me personalitetin dhe dijen e tij, gjenden po ashtu edhe fjalë që tregojnë rëndësinë e veprës së tij. Ibnul-Arabiu ka bërë këtë vlerësim lidhur me Sunen-in e Ebu Davudit: “Nëse një njeri di Kuranin dhe Sunen-in e Ebu Davudit, do të thotë se ka njohuri të mjaftueshme mbi çështjet themelore të fesë.”⁴

Ebu Davudi, në kohën kur ka jetuar, ka bërë shenjë me personalitetin e tij dhe veprën “Sunen”. Në një vlerësim që është bërë për të, kanë arritur në këtë konstatim:

"Vetëm katër prej gjithë këtyre haditheve i mjaftojnë një njeriu të mençur:

1. *Veprat vlerësohen sipas qëllimit për të cilin janë kryer.*

2. *Nëse njeriu nuk merret me gjëra që nuk i bëjnë dobi, kjo është shenjë e të qenit mysliman i mirë.*

3. *Askush prej jush nuk mund të quhet besimtar i vërtetë, pa dëshiruar për tjetrin atë çfarë dëshiron për veten.*

4. *Hallalli është i qartë, po ashtu edhe harami është më se i qartë. Mirëpo, mes tyre ekzistojnë plot çështje (që duhen shmangur), që shumë prej jush nuk i njohin (nëse janë të ndaluara apo të lejuara)...⁵*

Shah Velijullah Dehleviu, bën këtë analizë lidhur me këto katër hadithe:

"...Hadithi i parë mjafton për të kryer siç duhet ibadetet. Hadithi i dytë është për të mbrojtur harxhimin e jetës së vyer të njeriut. Hadithi i tretë është udhëzues për marrëdhëniet me fqinjët, të afërmit, miqtë dhe dashamirësit. Kurse hadithi i katërt për një njeri të mençur është me plot kuptimin e fjalës një mjeshtër dhe udhërrëfyes shpirtëror."⁶

Këto katër hadithe që ka përzgjedhur Ebu Davudi, që sipas nesh janë "thelbi i Islamit", thuajse përfshijnë të gjithë fushat e jetës së myslimanit.

Hadithi: "*Veprat vlerësohen sipas qëllimit që janë kryer*", është hadithi i parë që vjen përmes raportimit të Hz. Omerit, në veprën me emër "Sahih" të Buhariut, vepër e cila pranohet si një nga burimet më të sakta të hadithit. Renditja në krye të veprës që Buhariu i bën këtij hadithi, me siguri që nuk është një rastësi. Me siguri, Buhariu do që lexuesve t'u japë një mesazh serioz: "Ji i kujdesshëm me qëllimin që ke kur bën një vepër apo kur sillesh me të tjerët..." Ky mesazh është përmendur përsëri pas disa shekujsh nga Imam Neveviu në veprën "Rijadus-Salihin", ndaj dhe këtë hadith përmend të parin, si hadithi i qëllimit.

Hadithi i dytë, bashkë me hadithin e parë janë tregues të një përshkallëzimi mbi rëndësitë që duhet të ketë njeriu: ndërkohë që si hap i parë, -para se të nisë vepra apo sjellja- rëndësi parësore ka qëllimi përse bëhen ato vepra apo sjellje. Kurse hapi i dytë është cilësia e veprës apo sjelljes. Myslimani me identitet duhet të bëjë kujdes për kualitetin e veprës apo sjelljes.

Ndërsa hadithi i tretë, i jep përparësi njërit prej problemeve të karakterit më me rëndësi të ditëve të sotme, egoizmit. Natyrisht, pasqyrimi në jetën sociale i këtij problemi të karakterit, nuk është aspak

i dëshirueshëm. Duket sikur jemi pjesë e një shoqërie të përbërë nga njerëz që jetojnë me filozofinë "ç'më duhet mua!", që nuk jetojnë për të mbështetur dhe ndihmuar njëri - tjetrin.

Hadithi i katërt përcakton qëndrimin e myslimanëve përballë çështjeve të jetës, duke shkoqitur lehtësinë e jetesës në mënyrë islame, sado që mund të ketë diversitete në interpretime dhe gjykime të ndryshme. Formula e mënyrës së jetesës islame në hadith është dhënë mjaft qartë, që do të thotë se njeriu duhet t'u shmanget temave për të cilat nuk ka njohuri dhe qartësinë e duhur. Në vazhdimin e hadithit tregohet se ai njeri që u largohet çështjeve që nuk janë të qarta, mbron nderin dhe besimin e tij; kurse ai që hyn në këto çështje, ngjan me atë bari që kullot dhentë përreth një zone të ndaluar.

Padyshim që secili hadith që është vërtetuar për saktësinë që i përket Hz. Pejgamberit, për ne përbën një rëndësi të madhe. Këto hadithe përfshijnë çështje të ndryshme dhe secila prej tyre u flet fushave të ndryshme të jetës sonë. Krahas kësaj, ashtu sikurse ka theksuar edhe Ebu Davudi, disa hadithe, për të kuptuar dhe kumtuar Islamin, kanë urtësi më praktike dhe më esenciale. Katër hadithet e lart-përmendur, përbëjnë një rëndësi të veçantë lidhur me përcaktimin e filozofisë së jetës së myslimanit qoftë në dimensionin individual, qoftë edhe në atë shoqëror. Ndaj, duhet vënë veshi këtyre katër haditheve, që myslimanët të arrijnë në pikën që dëshirojnë apo synojnë.

Shënimet: 1) Për njohuri më të hollësishme, shih: Kandemir, M.Yaşar, "Ebû Dâvûd es-Sicistânî", DIA, X, 119-121.; Şah Veliyullah Dehlevî, Bustânul'-muhaddîsîn, përkth në turq. Koçkuzu, A. Osman, 192-193. 2) Kandemir, M.Yaşar, po aty, 120. 3) Dehlevî, po aty, 193. 4) Dehlevî, po aty, 195. 5) İbnü'l-Esîr Xhezerî, Xhâmiu'l-usûl fî ehâdîthi'r-rasûl, I, 190.; İbn Rexheb Hanbelî, Xhâmiu'l-ulûm ve'l-hikem, I, 10.; Dehlevî, po aty, 194. 6) Dehlevî, po aty, 194.



"KU JANË BIJTË E MBRETËRVE NGA KËTO KËNAQËSI!?"

- KOHA NË JETËN E MYSLIMANËVE -

Nëpërmjet Kuranit dhe udhëzimeve të Hz. Muhamedit (a.s.), feja jonë na ka udhëzuar drejt sistemimit të kohës dhe vlerësimit të saj, në rrugën e ndërtimit në jetë dhe realizimit të "mëkëmbësisë" së njeriut, për Zotin, në tokë.

Vlerën e kohës, Allahu i Madhëruar na e ka treguar në disa mënyra, duke na ftuar drejt meditimit në vlerën dhe faktin se koha është vetë jeta jonë; sa të përfitojmë prej saj, aq kemi jetuar në këtë botë.

Kurani na tregon për delikatesën me të cilën është trajtuar kryerja e namazeve ditore: **"...namazi është përcaktuar si obligim për besimtarët, në kohë të caktuara"**. (Nisa, 103) Në këtë linjë udhëzimi, Hz. Muhamedi (a.s.), kur u pyet se cila ishte vepra më e mirë, u përgjigj: "Namazi në kohën e vet." Pra, koha dhe përkujdesi për shfrytëzimin e saj!

Bediuzaman Said Nursi (1877-1960), një mendimtar i shquar i shekullit të kaluar, teksa flet për vlerën e përfitimit të kohës në raport me kryerjen e namazit, thotë: "Mjerë për atë që shpenzon njëzet e tre nga orët e tij për këtë botë të shkurtër dhe nuk shpenzon një orë të vetme për atë jetë të përjetshme e të pafund!"

Fakti që namazi përsëritet pesë herë në ditë dhe kërkesa hyjnore udhëzon të respektohet koha e secilit, bën që myslimani "nëse e kryen secilin namaz në kohën e vet, në sjelljen e tij do të mbillet morali i ruajtjes së kohës dhe saktësia në orare", fakt që e bën atë një njeri të kujdesshëm ndaj jetës dhe me ndjenjën e ruajtjes maksimale ndaj kohës.

Duke ndjekur këtë logjikë, nuk ka sesi të na duket e habitshme, kur lexojmë se Imam Bukhariu ka thënë: "E kam shkruar 'Sahihun' në një periudhë prej 16 vjetësh, hadithet e të cilit i kam nxjerrë nga gjashtëqind mijë hadithe...". Sepse njeriu që vendos ta shfrytëzojë kohën e tij me një qëllim të shtrenjtë, nuk ndalet para detajeve, që në pamje të parë krijojnë hendekun për mosrealizimin e asaj pune.

Në Kuran, ekziston një dialog interesant, që do të zhvillohet në Ditën e Gjykimit, në mes të të ndëshkuarve për veprat e tyre dhe Zotit të gjithësisë. Ata thonë: "O Zoti ynë, nxirrna nga këtu, që të bëjmë vepra të mira e jo si ato që i bënim!" Zoti ua kthen: **"Po a nuk u dha-**

më juve jetë aq saqë, ai që ka dashur të mendojë, ka mundur të mendojë gjatë asaj kohe, madje juve ju ka ardhur edhe pejgamberi! Pra shijoni, se për zullumqarët nuk ka ndonjë ndihmëtar." (Fatir, 37)

Shejkh Abdulfettah Ebu Gudda, në librin "Vlera e kohës tek dijetarët", teksa flet rreth këtij ajeti, sjell komentin e Ibn Kethirit, që thotë: "Pra, a nuk jetuat aq sa jetuat në botën tuaj, po të ishit prej atyre që do të përfitonin, do të kishit përfituar gjatë periudhës së jetës tuaj?" Pra, vlerësimi i kohës në këtë jetë, do të ketë shpërblimet e veta në të përtejmen, sikurse abuzimi me kohën në këtë jetë, do të ketë një ndëshkim të meritueshëm për abuzuesit me të.

Zoti, nëpërmjet Librit të Tij, është betuar shumë herë për KOHËN, në mënyrë që krijesat e Tij të kuptojnë sesa vlen përfitimi prej saj në dobi të dijes, jetës, shoqërisë, të përtejmes etj. Ja disa shembuj të këtyre betimeve kuptimplota:

1. **"Pasha natën, që me errësirë mbulon gjithësinë! Pasha ditën, kur ajo shfaqet!"** (Lejl, 1-2)

2. **"Pasha natën, kur tërhiqet! Pasha agimin, kur agon!"** (Mudethir, 33-34)

3. **"Pasha paraditen! Pasha natën, kur shtrin errësirën!"** (Duha, 1-2)

4. **"Betohem në kuqërrimin e horizontit pas perëndimit! Dhe në natën dhe çka ajo tubon!"** (Inshikak, 16-17) E shumë ajete të tjera, që në tërësinë e tyre kanë një emërues të përbashkët; kohën në çdo moment dhe detaj të saj. Me fjalë të tjera, njeriu është ftuar nëpërmjet këtyre betimeve të shenjta, që ta shfrytëzojë kohën në dobinë e tij, jo tashësë atësinjë malli i pavlerë, i mbetur në magazinat e jetës së përkohshme.

Nga këtu, nuk na vjen habi kur lexojmë se, fjala bie, Amir ibn Abdikajs, kur dikush i tha: "Ndalu pak të flasin", ia ktheu: "Ndaloje diellin!". As kur lexojmë se dijetari i madh, Imam Nevevi (631 h. -676 h.), "gjënë më të shtrenjtë në jetë kishte kohën e tij". E shumë shembuj pafund nga jeta e të parëve tanë të ndershëm e të urtë.

Më lejoni, që në rreshtat vijues të sjell disa shembuj nga frytet e përfitimit nga koha në jetën e të parëve

tanë myslimanë, dijetarëve në mesin e tyre.

- Në biografinë e tij kushtuar Imamit të Imamëve fu-kaha, **Ebu Hanife Nu'manit**, hoxha ynë Shejkh Vehbi Sulejman Gavoçi, ndër të tjera shtron një pyetje: "Ky Imam, që natën ia kushtoi adhurimit dhe ditën dijes dhe mësimi të tjerëve, kur flinte?"

- Në këtë vijë logjike dhe përfitimi nga koha në shërbim të dijes edhe nxënësi i Imam Ebu Hanifes, **Muhammed ibnil-Hasen Esh-Shejbani** (132 h.-189 h.), ishte shquar për shfrytëzimin e natës. Dijetari Burhanudin Zernuxhi, në librin e tij "Ta'limul-muteal-lim", shkruan se: ["Muhammed ibnil-Hasen (Allahu e mëshiroftë) nuk flinte natën. Vendoste para duarve regjistrat e tij. Kur mërzitej nga njëri, hapte tjetrin. Aty pranë mbante edhe një gotë uji, me të cilin largonte gjumin dhe thoshte: "Gjumi është nga temperatura"].

Ndërkaq, për kënaqësinë e shfrytëzimit të kohës, teksa gdhinte netët pa gjumë dhe i zgjidhte problemet e shfaqura në çështje të ndryshme të dijes, thoshte: "Ku janë bijtë e mbretërve nga këto kënaqësi?"

- Tregohet se **Imam Tabariu** iu drejtua nxënësve të tij: "A jeni gati të shkruani tefsir?" Ata e pyetën: Për sa faqe bëhet fjalë? Ai tha: "Tridhjetë mijë fletë!" Ata ia kthyen: "Shkon jeta dhe nuk arrijmë dot!" Pastaj, ai e reduktoi në rreth tri mijë fletë, që ua diktoi në shtatë vite, nga viti 283 deri në vitin 290 h.

- **Ibn Xheriri** (224 h. – 310 h.), ka shkruar gjatë jetës së tij **358 mijë fletë**. Po të llogaritet jeta e tij 86 vjeçare dhe fletët e shkruara, do të kishim si më poshtë: Po të heqim nga jeta e tij 14 vitet e para të parapjekurisë, dhe të përpjestojmë pjesën e mbetur me numrin e fletëve, do të thoshim se ai ka shkruar çdo ditë 14 fletë! Vetëm "Historia" e tij ka 11 vëllime të mëdha, ndërsa tefsiri i tij, 30 vëllime të mëdha!

- Ibn Kajjimi, teksa flet për vlerën e dhikrit, përmend si më poshtë: "Gjashtëdhjetë e një": "Dhikri i jep forcë atij që e praktikon, saqë i jep praktikuesit çfarë nuk mund të arrihet pa të. Unë kam parë në forcën e Shejkhul-Islamit **Ibni Tejmije**, gjëra të çuditshme: Ai shkruante brenda një dite, aq sa nxënësit e tij nuk e zbardhnin dot për një xhuma (javë) a më shumë..."

- Në biografinë e muhadithit **Ibn Shahin** (297 h. – 385 h.), thuhet se ai u kishte thënë nxënësve të tij: "Kam shkruar deri më sot 330 vepra. Prej tyre: "Et-Tefsirul-Kebir", në 1000 xhyze, "Musned", në 1300 xhyze, "Et-Tarikh", në 150 xhyze dhe "Zuhd", në 100 xhyze". Dhe thoshte për veten e tij: "Kam blerë deri më sot 700 dirhem bojë".

- Ja dijetari i shquar **Ebu Rejhan Bejruni** (Muhammed ibn Ahmed Khavarezmi), astronomi, matematicieni, historiani, gjuhëtari e letrari i shquar, (362 h. – 440 h.), për të cilin thuhet: "Nuk ndahej lapsi nga dora e tij". Ai zotëronte pesë gjuhë: arabishten, sirianishten, sensek-

ritishten, persishten dhe gjuhën indiane. La vepra në shumë shkenca, si në astronomi, mjekësi, matematikë, letërsi, gjuhë, histori etj., sa veprat e tij arritën në 120 të tilla.

Orientalisti i shquar gjerman Karl Edward Sachau (1845 - 1930), ka thënë për Bejrunit: "Ai është mendja më e madhe që ka njohur historia".

- **Ibn Akil Bagdadiu**, hanbeliu (431 h. – 513 h.), thoshte: "Nuk më lejohet të humbas as edhe një orë nga jeta ime. Edhe nëse nuk më punon gjuha për të përsëritur a debatuar, edhe nëse nuk më punojnë sytë për të lexuar, fus mendjen në punë, gjatë pushimit, kur jam i shtrirë, saqë kur ngrihem, kam në mendje diçka për të shkruar". Ai la të shkruara rreth 20 vepra, më e madhja e të cilave është libri "**Funun**", një libër shumë i madh që përfshin këshilla, tefsir, fikh, usuli-fikh, gramatikë arabe, poezi, letërsi, histori etj. Imam Dhehebiu shkruan: "Nuk është shkruar në këtë botë një libër më i madh se ky libër. Më ka folur rreth tij, dikush që ka parë vëllimin e 400 e sa-të". Ndërsa Ibn Rexhebi thoshte: "Disa kanë thënë se ai kishte **800 vëllime**".

- Në librin të tij "Funun", Ibn Akili ka thënë: "Gjëja më e mirë, me të cilën kalohet koha, angazhohet nefsi dhe afrohet me të te Zoti i Madhëruar, është kërkimi i diturisë, që të nxjerr nga errësira e injorancës drejt dritës së DIJES...". Për këtë njeri të dijes, tregohet se kur iu afrua vdekja, gratë e shtëpisë nisën të qanin, ndërsa ai tha: "Për pesëdhjetë vite kam firmosur për Allahun, tash më lini të gëzohem me takimin e Tij". Ndërkohë, trashëgimia e tij e vetme ishin rrobat dhe librat!

Dhe siç kanë thënë arabët në urtësitë e tyre: "Prej shenjave të hidhërimit të Zotit, është humbja e kohës".



Zemërimi i Allahut

TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT!

Salih Zeki Meriç

Shumë prej nesh kur dëgjojmë ligjëratat fetare që bëhen të xhumave apo ditëve të tjera, ankohemi për mënyrën e ashpërsisë së komunikimit dhe të mospërdorimit të gjuhës së mëshirës së Islamit. Ndërkohë që gjenden dhjetëra ajete me sihariqe dhe me qindra ajete lidhur me xhenetin, nuk arrijmë ta shikojmë si normal komunikimin që bëjnë ata lidhur me xhehenimin dhe me vuajtjen e njerëzve aty. Aq sa kemi të drejtë mbi qasjen tonë, po aq është i diskutueshëm objektiviteti ynë.

Qëllimi i këtyre rreshtave nuk është të bëjmë lajmëtarin e kronikave të zeza. Por nuk kam asnjë pikë dyshimi lidhur me domosdoshmërinë e përdorimit të gjuhës së mëshirës së Islamit. Madje, një njeri që ka bërë gjynah dhe është penduar më pas, sikur të krahasohej, gëzimi i tij do të ishte më i madh se gëzimi i një njeriu që ka humbur devenë në shkretëtirë dhe pastaj e gjen atë.

Mirëpo, ndërkohë që mbështetemi në oqeanin e mëshirës së Zotit, me idenë se gabimet që bëjmë si pasojë e robërisë sonë "do të na i falë Allahu, i Cili është i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëplotë" edhe ky lloj

vetëqetësimi që bëjmë është i gabuar.

Besojmë se Allahu është i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëplotë. Islami është feja e mëshirës dhe Pejgamberi është profeti i mëshirës. Islami i jep përparësi një stili jetese me bosht mëshirën.

Islami kërkon nëpërmjet dritares së mëshirës që njeriu të shikojë veten në fillim, pastaj familjen, pastaj të afërmit dhe njerëzit që jetojnë bashkë me të, madje edhe krijesat e tjera të gjalla.

Sipas qasjes islame, krijesat duhet të mëshirohen për hir të Krijuesit të tyre. Islami nuk dëshiron nga asnjë gjallesë të sillet ndryshe nga natyrshmëria e tyre hyjnore.

Burimi i mëshirës është Allahu. Drita e mëshirës që rrezaton nga Ai, krijohet në filozofinë themelore që krijohet mbi botën e gjallesave. Në marrëdhëniet njerëzore që krijon Islami gjithnjë ekziston një ide e mirëkuptimit me qendër moslëndimin e bashkëbiseduesit, mëshirimin e tij. Falja e njeriut mysliman është më me rëndësi sesa mëshirimi i tij.

Krahas mëshirës së pafundme të Allahut që na mbështjell, cilësia e zemërimit të Allahut që shfaqet

është një gjendje që vlen për ruajtjen në mosrënie të gabimeve që të na forcojë vetëdijen tonë të robërisë ndaj Zotit. Është mjaft e dobishme të kujtojmë këtë hadith kudsî, të cilin që të gjithë e dimë. Zoti na drejtohet kështu: “Mëshira Ime e tejkalon zemërimin Tim!” (Buhariu, Tevhid, 15, 22, 28, 55; Muslimi, Tevbe, 14 – 16.)

Mëshira dhe zemërimi që përmendet këtu është për besimtarët në dynja. Nuk bëhet fjalë që meshira të tejkalojë zemërimin kundrejt femohuesve dhe atyre që këmbëngulin në mosbesim. (Ihja, vol. 1. f. 266.)

Zemërim do të thotë nxehje dhe shprehje e mërzisë. Zakonisht përdoret si e kundërta e termave pëlqim dhe butësi. Koncepti zemërim është përdorur në Kurani Famëlartë dhe në hadithe duke iu drejtuar Allahut, Pejgamberit dhe njerëzve të tjerë.

Kur renditen veçoritë e besimtarëve në Kuran, përmenden me lavdi ata besimtarë që atëherë kur janë të zemëruar falin. (Shura, 37) Në qëndrimet dhe sjelljet ndaj gabimeve që shihen në çështje fetare, etike dhe sociale, sado që nuk hap rrugë drejt teprimit, por është përcjellë që ka pasur raste që Pejgamberi ynë (a.s.), është nxehur, është zemëruar, madje aq sa i ka ndryshuar ngjyra e fytyrës. (Buhariu, Edeb, 75; Muslimi, Fedail, 127.) Në hadithe të ndryshme sikurse: “... Burrë është ai që mban nën kontroll veten kur zemërohet.” (Buhariu, Edeb, 76, 102; Muslimi, Birr, 107, 108.), tregohet qartë se ndjenja e zemërimit është një ndjenjë e natyrshme njerëzore, që nuk kërkohet të asgjësohet, por të shmanget nga vendimet apo sipërmarrjet nën efektin e kësaj ndjenjeje.

Zemërimi i Allahut manifestohet në dynja. Kurse dënimi i Tij do të shfaqet kundrejt femohuesve dhe kryengritësve të fesë në botën tjetër. Veprat që shkaktojnë zemërimin e Tij, i ka shprehur Kurani Famëlartë. Në Kurani Famëlartë kalojnë afërsisht njëzet e pesë ajete që bëjnë fjalë për zemërimin e Allahut.

Kur u hidhet një sy këtyre ajeteve kuranore, vërehet se Zoti zemërohet me ata që e mohojnë, me ata që pas besimit kalojnë në mohim dhe kundrejt atyre që nuk janë mirënjohës për të mirat që Allahu u ka dhënë.

Zoti thotë kështu:

Zemërimi i Allahut manifestohet në dynja. Kurse dënimi i Tij do të shfaqet kundrejt femohuesve dhe kryengritësve të fesë në botën tjetër. Veprat që shkaktojnë zemërimin e Tij, i ka shprehur Kurani Famëlartë.

“Sa për ata që polemizojnë rreth Allahut, pasi i janë përgjigjur Atij, arsyetimet e tyre do të jenë të pavlefshme te Zoti i tyre, mbi ata do të bjerë zemërimi i Tij e do të dënohen ashpër.” (Shura, 16)

“Hani nga ushqimet e shijshme e të lejuara, me të cilat ju kemi furnizuar dhe mos e kapërceni kufirin, përndryshe do t’ju zërë zemërimi Im. Ai, të cilin e zë zemërimi Im, është i humbur!” (Taha, 81)

“Ti e sheh se shumë prej tyre miqësohen me jobesimtarët. Me të vërtetë, e keqe është ajo që i përgatisin ata vetes: që Allahu të zemërohet me ta dhe të mbesin në dënim përjetësisht.” (Maide, 80)

“Vallë, a mund të krahasohet ai që kërkon kënaqësinë e Allahut me atë që ka merituar zemërimin e Allahut dhe strehimi i tij është Xhehenemi? Eh, sa strehim i keq është ai!” (Al’ Imran, 162)

Besimtari duhet t’u qëndrojë larg veprave që zemërojnë Zotin. Duhet të jetë i shmangur nga çdo lloj vepre dhe qëllimi që krijojnë largësi me Zotin, pasi mosmirënjohja përballë gjithë këtyre dhuntive që ka dhënë Allahu, ka si pasojë zemërimin e Tij. Shekullarizmi shkakton zemërimin e Zotit. Të bartësh ndjenja, si adresimin e sukseseve si pjesë e meritës personale apo të thuash “unë e bëra, sikur të mos isha unë nuk do të bëhej” etj., bën që të meritohet fatkeqësia. Dëshirat e pashmangshme porsî një gropë e xhehenemit, të heqin njerëzit brenda dhe të

qëndrosh i pavarur prej saj, si dhe të sistemosh jetën sipas mirëqenies personale, atëherë natyrshëm vjen zemërimi. Të shikosh veten si shpëtimtar, të shikosh veten si përvetësuesi i Islamit, të japësh këshilla vetëm për të tjerët dhe të mos marrësh asnjëfarë mësimi për vete, përsëri pas kësaj do të vijnë ndikimet e zemërimit të Tij.

Si përfundim, në ajetet kuranore është treguar mjaft qartë se si popujt e mëparshëm kanë merituar zemërimin e Zotit në këtë botë dhe dënimin e Tij në botën tjetër. Besimtari duhet të jetë i mençur dhe nuk duhet të bjerë në të njëjtat situata. Aq sa është e pranishme gjuha e mëshirës në fenë Islame, po aq është e panishme edhe gjuha e qortimit dhe frikësimit. Pasi grupi i dytë i verseteve të shpallura Pejgamberit (a.s.), janë ajetet kuranore: **“O ti, i mbështjellë (o Muhamed)! Çohu dhe paralajmëro!”** (Muddeththir, 1 - 2)

Një Ajet

Koha rrjedh si ujë. Ditët, netët, muajt dhe vitet ndjekin njëri-tjetrin pa ndaluar. Brenda hapësirës kohore të përcaktuar dikush është i lumtur, dikush i palumtur, dikush i suksesshëm dikush i dështuar, por kjo nuk e ndryshon aspak përfundimin, askush nuk mund t'i shpëtojë ndarjes përfundimtare nga kjo botë.

Historia ka njohur shumë njerëz legjendarë, të cilët kanë sunduar si të plotfuqishëm, por përsëri përfundimi i tyre ka qenë toka. Fatkeqësisht njerëzit vazhdojnë të jetojnë si sundues të vërtetë të tokës, pa nxjerrë aspak mësim nga historia e njerëzve të mëdhenj, të cilët, të gjithë janë përpirë nga koha pa lënë asnjë gjurmë.

Njeriu është i përfshirë nga rrjedha e kohës, e cila gjithnjë e më tepër e afron drejt kijametit. Ali (r.a.), këtë të vërtetë e shpreh në këtë mënyrë: "Dynjaja çdo çast largohet prej nesh, kurse Ahireti vjen drejt nesh." (Buhari, Rikak, 4)

Ndalimi apo rikthimi i kohës është i pamundur, prandaj Allahu i tërheq vëmendjen njeriut të kthehet tek Krijuesi i gjithësisë përpara se të vijë dita e pakthyeshme.

Ne jemi dërguar në këtë botë për një kohë të kufizuar. Ashtu si ardhja në këtë botë nuk ka qenë në dorën tonë, po ashtu edhe largimi nga kjo botë nuk është në dorën tonë. Neve thjesht na është dhënë një mundësi të cilën duhet ta vlerësojmë shumë mirë. Sepse vlerësimi si duhet i kësaj kohe të kufizuar në këtë botë siguron fitimin e bukurive pafund dhe të përhershme në botën tjetër. Nga kjo pikëpamje, çdo moment i jetës sonë është i një rëndësie të veçantë.

Në këtë botë sprovash, vlerësimi dhe shfrytëzimi i kohës si duhet është i një rëndësisë jetike. Pejgamberi (a.s.), jep një këshillë shumë të çmuar në lidhje me prioritetet e njeriut në këtë botë. "Vlerëso pesë gjëra përpara se të vijnë pesë të tjera: vlerëso rininë para pleqërisë, vlerëso shëndetin para sëmundjes, vlerëso pasurinë para varfërisë, vlerëso kohën e lirë para se të jesh i

nxënë dhe vlerëso jetën para vdekjes." (Hakim, Mustedrek, IV, 341)

Besimtari duhet të jetë i ndjeshëm përsa i përket vlerësimit të kohës. Allahu në Kuran e këshillon Pejgamberin (a.s.), shembullin tonë ideal kështu, në lidhje me vlerësimin e kohës: **"Sa po të përfundosh një punë, fillo punën tjetër."** (Inshirah, 7) Çdo moment i jetës është ose në favorin tonë, ose kundër nesh në ditën e gjykimit.

Është kjo ndjeshmëri e lartë e besimtarit për kohën, e cila e bën atë t'i bëjë vetes çdo ditë pyetjen: "Çfarë bërë sot për Zotin?" Besimtari ndjen shqetësim për çdo moment të shkuar kot dhe të pavlerësuar në dobi të tij apo shoqërisë.

Një nga veçoritë e besimtarit të shpëtuar, është qëndrimi dhe distancimi i tij nga fjalët bosh dhe të pavlera.

Adhurimet, si namazi, agjërimi dhe haxhi, të cilat janë të lidhura ngushtë me kohën, në të njëjtën kohë shërbejnë edhe si program disiplinimi dhe menaxhimi i kohës.

Dallimi i vetëm midis popujve të zhvilluar dhe të prapambetur është vlerësimi dhe mirëmenaxhimi i kohës. Shoqëritë, të cilat e kanë vlerësuar dhe shfrytëzuar si duhet kohën, gjithmonë kanë qenë pararojë e zhvillimit dhe përparimit. Ky është një ligj sociologjik. Prandaj vlerësimi i kohës është jetësor për suksesin e individit dhe shoqërisë. Pavarësisht fesë dhe besimit, suksesi në këtë botë është i lidhur me zbatimin e këtij ligji.

Të gjithë njerëzit e suksesshëm, suksesin e tyre nuk ia dedikojnë intelektit apo zgjuarsisë, por shfrytëzimit dhe disiplinimit të kohës.

Besimtari nuk duhet të harrojë që dynjaja është vendi i mbjelljes, kurse ahireti vendi i korrijës.

Nga Ebu Hurejra (r.a.), transmetohet se Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Çdo fëmijë lind mysliman; më vonë prindërit e bëjnë të krishterë, jahudi apo zjarrputist.”

(Buhari, Tefsir, 2)

Allahu e krijoi njeriun si krijesën më të nderuar midis gjithë krijesave të tjera dhe e caktoi atë si përfaqësuesin e Vet në botë. Për ta përfaqësuar denjësisht vullnetin hyjnor në tokë, Allahu e pajisi me të gjitha aftësitë e nevojshme.

Pjesë e qenësishme e natyrës së njeriut është edhe besimi. Të gjithë njerëzit vijnë në këtë botë me potencialin për të besuar Krijuesin e gjithësisë. Sipas botë-kuptimit islam, fëmija lind i pastër dhe pa mëkate. Nëse fëmija rritet pa u kushtëzuar nga ambienti rrethues, natyra e pastër e orienton atë drejt besimit të pastër dhe e bën të aftë për të dalluar të drejtën nga e shtrembëra. Kur u pyet Pejgamberi (a.s.), për të mirën dhe të keqen, u përgjigj: *“E mira është ajo që të gëzon dhe qetëson zemrën, kurse e keqja është ajo që të shqetëson zemrën edhe kur ta miratojnë njerëzit.”* (Darimi, Buju, 2.)

Njeriu në këtë botë dhe botën tjetër mund të gjejë qetësinë dhe lumturinë e duhur vetëm duke gjetur dhe përkujtuar Allahun. Çdo besim tjetër në kundërshtim me Tevhidin dhe natyrën e njeriut nuk i sjell atij asgjë tjetër përveç çorientimit dhe shturjes.

Feja islame i mëshon fort faktit të mbroj-

tjes së natyrës së pastër njerëzore, e cila është e hapur për të pranuar Tevhidin. Allahu urdhëron: ***“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”*** (Rum, 30)

Edhe Pejgamberi (a.s.), ka theksuar fort marrjen në mbrojtje të natyrës së pastër. Për këtë të gjitha urdhëresat dhe ndalesat fetare në Islam janë në harmoni të plotë me natyrën e pastër të njeriut.

Mirëpo, fatkeqësisht, njeriu lind në një mjedis të caktuar, i cili përcakton gjendjen, sjelljen, mënyrën e jetesës dhe besimin e tij. Hadithi profetik thekson pikërisht ndikimin e mjedisit shoqëror në përcaktimin e fesë. Pra, fëmija lind me natyrë të pastër islame, por ka nevojë për mbështetje nga jashtë, në mënyrë që të zhvillohet. Ky është shkaku që Allahu ka dërguar profetë dhe shpallje kohë pas kohe. Hadithi, në të njëjtën kohë thekson rëndësinë e prindërve në edukimin e fëmijëve. Prindërve u bie një detyrë e rëndësishme në miredukimin e fëmijëve. Pra, detyra kryesore e prindërve është ruajtja e natyrës së pastër islame tek fëmijët e tyre.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Të gjithë linden në natyrën e pastër islame.
2. Njeriu ndikohet nga mjedisi shoqëror dhe kulturor në të cilin jeton.
3. Roli i prindërve në edukimin e fëmijëve është shumë i madh.

Një Hadith



ZEKATI

Zekati është 2.5 % e pasurisë që duhet të japin për hir të Allahut, njëherë në një vit hënor, myslimanët të cilët kanë pasuri mbi një sasi të caktuar. Zekati u jepet të varfërve, të mjerëve, nëpunësve që mbledhin zekatin, atyre që duhet t'u ngrohet zemra me Islam, skllevërve që duan të blejnë lirinë e tyre, borxhlinjve, atyre që punojnë në rrugë të Allahut dhe të mbeturve në rrugë.

Përveç parave, zekatit i nënshtrohen edhe prodhimet e kafshëve dhe bimëve. Dhe llogaria e secilës prej tyre bëhet në mënyrë të veçantë. Zekati i prodhimeve bujqësore, quhet "Oshur". Përveç dhurimit të detyruar në një masë të caktuar si zekati, Islami e ka lënë në dorë të vetë bamirësve që t'i shtojnë dhurimet sipas gjendjeve që kanë.

DETYRAT E TË PASURIT DHE E TË VARFRIT

Ekzistenca e dallimeve në gjendjen e individëve dhe shoqërive, si në të fortë dhe të dobët, të shëndetshëm dhe jo të shëndetshëm, të ditur dhe të paditur, të pasur dhe të varfër, përmban shumë urtësi të thella dhe të imëta të vullnetit hyjnor. Para së gjithash, mirësitë që zotërojmë në këtë jetë, Allahu i Madhëruar na i ka bërë të mundura me qëllim që të na sprovtojë. Madje, ashtu siç janë sprovë mirësitë që zotërojmë, ashtu janë edhe gjendjet kur ne jemi të privuar nga diçka. Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi,

ai thotë: 'Zoti im më ka nderuar.' Por kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: 'Zoti im më ka poshtëruar.'" (Fexhr, 15-16)

Nisur nga kjo, as pasuria nuk është nder dhe as varfëria nuk është poshtërim. Këto janë vetëm si rezultat i caktimit hyjnor. Allahu i Madhëruar urdhëron:

"...Ne ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur disa në shkallë më të lartë se të tjerët, me qëllim që t'i shërbejnë njëri-tjetrit. Mëshira e Zotit tënd është më e mirë nga ajo që grumbullojnë ata." (Zuhruf, 32)

Megjithëse Allahu i Madhëruar i ka ndarë gjërat në mënyrë të ndryshme ndër njerëz, Ai edhe përgjegjësitë i ka dhënë sipas tyre, duke mos i bërë padrejtësi askujt. Përveç kësaj, nga ky ajet fisnik kuptojmë se dallimi ndërmjet njerëzve luan një rol të rëndësishëm në vendosjen e harmonisë dhe rregullit në shoqëri.

I pasuri do të japë llogari para Allahut në lidhje me çështjet se ku e ka fituar dhe ku e ka shpenzuar pasurinë, pra për fitimet hallall dhe haram, për zekatin, sadakanë, bamirësinë dhe mirësitë që ka bërë me të. Atij i është dhënë përgjegjësia e shpenzimit të një pjese të caktuar të pasurisë për të varfrit dhe për rrjedhojë, ai i nënshtrohet një sprove të madhe në aspektin e pasurisë. Nëse ai e fiton edhe këtë sprovë së bashku me të tjerat, do të arrijë kënaqësinë hyjnore dhe mirësitë e xhenetit.

Po ashtu edhe i varfri do të japë llogari në çështjet, si



durimi, ankimi, urrejtja, smira dhe ndershmëria. Nëse përfundimi i të gjitha këtyre përpunet me kënaqësinë e Allahut, vuajtja e tij në këtë botë do të kthehet në lumturinë e përjetshme të botës tjetër.

Ashtu si i varfri ka nevojë për mbështetjen e të pasurit në këtë botë, edhe i pasuri ka nevojë për lutjen e të varfrit, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

Të pasurit falënderues e bujarë dhe të varfrit durimtarë e të ndershëm, ndajnë së bashku edhe dinjitetin njerëzor, edhe kënaqësinë e Allahut. Ndërsa të pasurit mendjemëdhenj e koprracë dhe të varfrit e padurueshëm, të cilët e kanë zakon të kërkojnë gjithçka, janë të qortuar dhe të padëshiruar në Islam. I Dërguari i Allahut (a.s.), është lutur me këto fjalë:

"O Zot! Strehohem tek Ti nga e keqja e pasurisë dhe e varfërisë!"
(Muslim, Dhikr, 49)

Pasanik i vërtetë është ai që kënaqet me atë që ka, që mbështet e dorëzohet tek Allahu dhe është i bindur ndaj Tij...

Të punosh dhe të fitosh pasuri e mall në rrugë hallall (të ndershme), padyshim që është diçka që kërkon aftësi. Por më e drejtë është të dhurosh në rrugë të



Të punosh dhe të fitosh pasuri e mall në rrugë hallall (të ndershme), padyshim që është diçka që kërkon aftësi. Por më e drejtë është të dhurosh në rrugë të Allahut, pa e adhuruar dhe pa e futur në zemër pasurinë. Në të kundërtën, pasuria do të jetë vetëm shkak për lodhje në këtë botë dhe dënim i hidhur në botën tjetër.

Allahut, pa e adhuruar dhe pa e futur në zemër pasurinë. Në të kundërtën, pasuria do të jetë vetëm shkak për lodhje në këtë botë dhe dënim i hidhur në botën tjetër.

Kjo ndodhi e shkurtër e shpreh shumë bukur rëndësinë e dhurimit, bamirësisë dhe përpjekjes në rrugë të Allahut:

Beshir bin Hasasijje (r.a.), tregon:

Shkova tek Rasulullahu (a.s.), për t'i dhënë besën dhe ai më vuri këto kushte: Të dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij, të fal namazin, të jap zekatin, të bëj haxhin si mysliman, të agjëroj Ramazanin dhe të luftoj në rrugë të Allahut.

Unë i thashë:

-O i Dërguari i Allahut! Vallahi, për dy nga këto, nuk kam mundësi. Këto janë lufta dhe bamirësia. Myslimanët thonë se ai që ikën

nga lufta, kthehet duke marrë mbi vete zemërimin e Allahut. Dhe unë kam frikë se kur të dalim në sheshin e luftës, do të më kaplojë frika e vdekjes. Për sa i përket bamirësisë, unë nuk kam tjetër përveçse një tufë të vogël delesh dhe dhjetë deveve. Ato janë burimi i të ardhurave dhe kafshët e udhëtimit të familjes sime.

Rasulullahu (a.s.), tha:



Në aspektet njerëzore, jomyslimanët janë të barabartë me myslimanët. Për shkak se fryma e fundit është mister për të gjithë, jemi të detyruar të sillemi mirë me të gjithë njerëzit dhe jomyslimanëve duhet t'u afrohemi me shpresën se ata mund të besojnë para se të vdesin.

-Luftë nuk bën, bamirësi nuk bën! Po me çfarë do të hysh në xhenet?

Unë menjëherë i thashë:

-O Rasulullah, të jap besën!- dhe i dhashë besën për të gjitha kushtet që ai më vuri. (Ahmed, V, 224)

URTËSITË E ZEKATIT DHE BAMIRËSISË

Zekati, bamirësia dhe dhurimi, bëhen pengesë që njerëzit e kamur ta teprojnë duke u mashtruar pas pasurisë së tyre dhe njerëzit e varfër të kaplohen nga prirjet negative, si urrejtja dhe smira ndaj të pasurve. Në këtë mënyrë ruhet ekuilibri i jetës sociale, ndërsa individët lidhen me njëri-tjetrin me vëllazëri dhe dashuri. Po ashtu, kjo ul maksimalisht edhe distancën ndërmjet të pasurve dhe të varfërve. Si rezultat i kësaj, numri i të varfërve do të ulet në mënyrë të dukshme dhe për rrjedhojë, do të parandalohen shumë fenomene negative në shoqëri.

Sa mbresëlënëse është ky shembull, i cili tregon më së miri se si zekati bëhet shkak i bashkimit të njerëzve të ndryshëm në shoqëri:

Njëherë, kur Omeri (r.a.), po kalonte pranë një shtëpie, para derës së saj pa një të moshuar të verbër që po lypte. Omeri (r.a.), iu afrua nga pas dhe duke i prekur krahun, e pyeti:

-Prej cilit popull je ti?

I moshuari i tha se ishte prej hebrenjve. Kurse Omeri (r.a.), tha:

-E si ke rënë në këtë gjendje?

Hebreu i verbër tha:

-Shkak për këtë është taksa e xhizjes, mosha ime e thyer dhe pamundësia.

Omeri (r.a.), e kapi për krah hebreun e verbër dhe e çoi në shtëpinë e tij. Në shtëpi mori ato që mund të gjente dhe ia dha. Pastaj thirri nëpunësin e thesarit të shtetit dhe e urdhëroi me këto fjalë:

-Kujdesu ndaj këtij dhe të tjerëve si ky! Beto hem në Allahun se, nëse ne përfitojmë prej tij kur ai është në moshën më frytdhënëse të rinisë dhe e lëmë atë të mjerë kur plakët e dobësohet, nuk do të ishim aspak të drejtë...

Pas kësaj ndodhie, Omeri (r.a.), e hoqi xhizjen për atë dhe të tjerët si ai.

Në aspektet njerëzore, jomyslimanët janë të barabartë me myslimanët. Për shkak se fryma e fundit është mister për të gjithë, jemi të detyruar të sillemi mirë me të gjithë njerëzit dhe jomyslimanëve duhet t'u afrohemi me shpresën se ata mund të besojnë para se të vdesin. Për këtë arsye, nëse atyre nuk u jepet gjë prej zekatit, të paktën duhet t'u ndahet një pjesë prej lëmoshave. Në fund të fundit, këto dhurime dhe mirësi mund të bëhen shkak i udhëzimit të tyre. Shembullin më të bukur të kësaj e shohim përsëri në jetën e Rasulullahut (a.s.):

Në vitin e shtatë të emigrimit, pas çlirimit të Hajberit, Mekën e kaploi një thatësi dhe zi buke. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), i dërgoi popullit të Mekës ndihma të ndryshme. Ebu Sufjani i mori në dorëzim të gjitha këto ndihma dhe ua shpërndau të varfërve të kurejshëve. Edhe pse në atë kohë ai vetë ishte prej idhujtarëve, i mahnitur nga kjo zemërgjerësi bujare, duke shprehur kënaqësinë e madhe që ndjente tha:

-Allahu e shpërbleftë me të mira djalin e vëllai tim, sepse ai u kujdes ndaj të afërmve të vet!

Kjo dhe mirësi të ngjashme me këtë, i zbutën zemrat

e banorëve të Mekës, duke e bërë më të lehtë pranimin e Islamit nga ana e tyre. Edhe në historinë osmane gjejmë shumë shembuj të udhëzimit të njerëzve në këtë mënyrë.

Nga ana tjetër, pasuria që merret si zekat, u kalohet pjesë-pjesë dhe shkallë-shkallë nevojtarëve të shoqërisë. Në këtë mënyrë, në shoqëri ndërtohet ekuilibri, drejtësia dhe harmonia sociale. Ndërsa pasuria e të pasurve pastrohet dhe i ngelet të zotit si hallall.

Që në kohët e hershme, në botë, vazhdimisht janë zhvilluar përplasje midis të pasurve dhe të varfërve. Në përgjithësi, të varfrit i kanë parë të pasurit me urrejtje dhe smirë. Ndërsa të pasurit i kanë parë të varfrit si njerëz të ulët dhe të mjerë. Këtu mund të përjashtohen vetëm periudhat kur institucioni i zekatit ka funksionuar ashtu siç duhet. Në ato kohë, zekati dhe lëmosha jepeshin me një fshehtësi dhe modesti të madhe.

Allahu i Madhëruar shprehet se “Bamirësinë e merr vetë Ai!” dhe, nëse sot zekati do të jepej ashtu siç duhet, të varfrit dhe të vuajturit në shoqëri do të pakësoheshin aq sa nuk do të mbetej pothuajse asnjë. Në kohën e Khalifit Omer bin Abdulaziz, njerëzit e sillnin zekatin e mallit të tyre, por nuk gjenin askënd, të cilit mund t’ia jepnin. Njëherë, Omer bin Abdulazizi e dërgon nëpunësin e zekatit në vendet e Afrikës. Mirëpo, nëpunësi u kthye pa i shpërndarë dot mallrat e zekatit, sepse nuk gjeti askënd që kishte nevojë për to. Për këtë arsye, me ato para ai mori dhe liroi shumë skllevër. Ky pra është rezultati dhe shpërblimi i shpenzimit të pasurisë dhe jetës për hir të Allahut.

Ja pra, ndërkohë që Islami e mjekon dhe e shëron plagën “pasuri-varfëri” të njerëzimit në këtë mënyrë kaq të bukur, sistemet e tjera nuk kanë pasur sukses në këtë çështje dhe, ose e kanë tepruar, ose e kanë lëshuar fare me rregullat e tyre njerëzore. Dikush e ka ndaluar rreptësisht kërkimin e diçkaje nga një tjetër e dikush tjetër e ka bërë lypjen profesion. Ndërsa Islami, me anë të zekatit dhe dhurimit, e ka trajtuar këtë plagë me një drejtësi të jashtëzakonshme dhe ka ofruar zgjidhjen më të përshtatshme.

Me të vërtetë që zekati është një nga mirësitë më të mëdha që Islami ia ka falur njerëzimit. Po ashtu, zekati ka qenë edhe një nga mënyrat e heqjes së zinxhirëve të skllavërisë prej qafës së njerëzve, që ishin realiteti i hidhur i një periudhe të gjatë të historisë. Kjo, sepse një nga tetë kategoritë ku duhet të shpenzohen mallrat e zekatit, është edhe dhënia e lirisë së skllevërve.

Një nga urtësitë e zekatit, është edhe pengimi i rritjes anormale të kapitalit individual. Zekati dhe dhurimi janë rrugëzgjidhja më e bukur që e pengon kapitalin



Të gjithë duhet të mendojmë se po jetojmë mbi pronën e Allahut dhe po furnizohemi me mirësitë e Tij. A nuk mendojnë ata që i neglizhojnë adhurimet si zekati dhe lëmosha se mallin e kujt dhe prej kujt po e kursejnë?

të kthehet në kancer për individin.

Po ashtu, duke mbështetur shumë njerëz që punojnë dhe përpiqen për hir të Allahut, në sajë të zekatit mund t’u hapet rrugë punëve të mira. Ndiurma që u jepet nxënësve të dijes me anë të zekatit, bëhet shkak që kjo dije të përdoret për hir të Allahut.

Në shoqëritë ku funksionon institucioni i zekatit, krijohet një gjendje paqeje. Si në shoqëritë e ndryshme islame, ashtu edhe në shoqërinë osmane, shohim se jeta sociale ka qenë gjithmonë e qetë. Në sajë të kësaj qetësie, shoqëria osmane ka qëndruar në këmbë për 620 vjet. Kur solidariteti shoqëror prishet duke mos dhënë më zekat, në shoqëri fillojnë të shtohen vjedhjet dhe fenomene të tjera negative. Me largimin nga shpirtërorja, dëshirat e ulëta të egos fillojnë e kalojnë kufijtë dhe si përfundim prishet edhe qetësia në shoqëri. Në këtë rast, rregullat që na mëson shkenca e sociologjisë mbeten vetëm në letër.

PRONA I TAKON ALLAHUT

Të gjithë duhet të mendojmë se po jetojmë mbi pronën e Allahut dhe po furnizohemi me mirësitë e Tij. A nuk mendojnë ata që i neglizhojnë adhurimet, si zekati dhe lëmosha se mallin e kujt dhe prej kujt po e kursejnë?

Në të vërtetë, në mënyrë absolute, prona i takon vetëm Allahut. Ndërsa zotërimet e njeriut janë si pronat e përbashkëta. Pasuria e kësaj bote është një amanet që Allahu ia ka dhënë robit të Tij. Prandaj, është e papranueshme që një individ ta përdorë atë vetëm sipas dëshirës së tij. Pra, kjo pasuri duhet të përdoret në rrugën që ka urdhëruar pronari i vërtetë i saj.

Nisur nga kjo, kush dhuron diçka, nuk dhuron mallin e tij. Në të vërtetë, mallin që i ka dhuruar Allahu, ai ia kalon një robi tjetër të Allahut. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar e ka caktuar zekatin si një borxh apo e drejtë që duhet t'u jepet nevojtarëve, prej atyre që kanë mundësi. Në një ajet fisnik urdhërohet:

"(Ata) që nga pasuria e tyre japin të drejtën e caktuar për nevojtarin dhe mahrumin (ai që është i varfër, por ka turp të kërkojë)." (Mearixh, 24-25; Dharijat, 19)

Pra, çdo rob që dëshiron të arrijë moralin dhe mirësinë hyjnore, është i detyruar t'i lejojë edhe nevojtarët e të vuajturit të përfitojnë prej mirësive të kësaj bote, prej të cilave përfiton edhe vetë ai. Qëllimi i vërtetë i kësaj, është arritja e kënaqësisë së Allahut dhe formimi i besimtarëve të tillë, prej dorës dhe gjuhës së të cilëve përfitojnë të gjithë njerëzit.

BEGATIA E ZEKATIT DHE E BAMIRËSIVE

Zekati, i cili gëzon nevojtarët e shoqërisë, në fakt është më shumë i dobishëm për ata që japin sesa për ata që marrin. Në të vërtetë, fjala "zekat" që nënkupton "pastrim", "purifikim" dhe "begati", ka disa dobi shumë të rëndësishme, si pastrimi i njeriut prej disa sëmundjeve dhe të këqijave të zemrës dhe pastrimi i pasurisë së tij. Gjithashtu, pastrimi i zemrës, i shpirtit dhe i egos është edhe një nga urtësitë e dërgimit të pejgamberëve.

Zekati bën të mundur që njeriut, i cili për nga natyra është shumë i dhënë pas pasurisë, t'i pakësohet dashuria ndaj mallit. E kur arrihet kjo, zekati e orienton atë tek dashuria e vërtetë, që është Allahu i Madhëruar, i cili është i vetmi që e meriton të lidhesh pas Tij. Ai e ndihmon njeriun të pastrohet nga gjithçka që hedh hije mbi dashurinë për Allahun, të jetojë "teuhidin" dhe të shpëtojë prej koprracisë, duke e falënderuar Allahun për mirësitë që i ka falur. Allahu i Madhëruar, urdhëron:

"...Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t'jua shtoj edhe më shumë begatitë e Mia!.." (Ibrahim, 7)

"Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëllojnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kallë ka nga një-qind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm." (Bekare, 261)

Rasulullahu (a.s.), duke folur për begatinë e madhe shpirtërore që ka bamirësia dhe dhurimi, është shprehur:

"Për shkak të një kafshate buke, një grusht hurma apo diçka të ngjashme me këto, prej të cilave do të ketë dobi një i varfër, Allahu i Madhëruar vendos në xhenetin e Tij tre lloj njerëzish:

- 1) Të zotin e shtëpisë dhe atë që e urdhëron dhënien e tyre,
- 2) Zonjën e shtëpisë që përgatit atë që do të jepet.

- 3) Shërbyesin që do ta lërë atë mirësi në dorën e të varfrit."

Pasi i numëroi këto, Rasulullahu (a.s.), vazhdoi duke thënë:

"Falënderuar qoftë Allahu i Madhëruar që nuk harron askënd prej nesh!" (Hejthemi, III, 112.)

Nga ana tjetër, bamirësia largon shumë fatkeqësi të kësaj bote dhe të botës tjetër. Një pjesë prej këtyre, Rasulullahu (a.s.), na i ka bërë të ditura me këto fjalë:

"Ashtu siç e shuan uji zjarrin, ashtu e shuan edhe bamirësia gjynahun." (Tirmidhi, Iman, 8/2616)

"Bamirësia shuan zemërimin e Zotit dhe e largon njeriun nga vdekja e keqe." (Tirmidhi, Zekat, 28/664)



"Lëmosha që jep myslimani, ia zgjat (begaton) jetën atij, parandalon vdekjen e keqe dhe për shkak të saj, Allahu i Madhëruar largon prej tij mendjemadhësinë, varfërinë dhe mburrjen." (Hejthemi, III, 110.)

"Nxitoni në dhënien e lëmoshës! Sepse fatkeqësia nuk mund t'ia kalojë lëmoshës." (Hejthemi, III, 110.)

"Të gjithë do të jenë nën hijen e bamirësisë së vet, derisa të gjykohen të gjithë njerëzit."

Një nga transmetuesit që na ka sjellë hadithin e fundit, Ebu'l-Hajr (Allahu e mëshiroftë!), përpiquej që çdo ditë të jepte nga një lëmoshë. Madje edhe nëse ajo që jepte ishte një ëmbëlsirë, një qepë apo diçka e ngjashme me këto... (Ahmed, IV, 147-8)

Njëherë, Rasulullahu (a.s.), tregon se një grup njerëzish kishte shkuar tek Isai (a.s.). Pasi ata u ndanë prej tij, Isai (a.s.), u thotë të pranishmëve:

-Nëse dëshiron Allahun, njëri prej tyre do të vdesë sot!

Kur erdhi mbrëmja, ata njerëz erdhën përsëri tek Isai (a.s.), me turra drush të ngarkuara në kurriz. Isai (a.s.), u tha:

-Lëshojini drutë në tokë!

Pastaj, njeriut për të cilin më parë tha se atë ditë do të vdiste, i thotë:

-Zgjidhe turrën e druve!

Kur personi e zgjidhi turrën e druve, prej aty doli një gjarpër i zi.

-Çfarë pune të mirë ke bërë sot?- e pyet Isai (a.s.).

-Sot nuk kam bërë ndonjë punë të mirë!- tha njeriu. Por Isai (a.s.), këmbënguli duke thënë:

-Mendo mirë, çfarë ke bërë?

Kësaj here njeriu tha:

-Nuk kam bërë ndonjë punë, por kur kisha në dorë një copë bukë, erdhi një i varfër dhe më kërkoi diçka. Ndërsa unë i dhashë një pjesë prej asaj buke.

Pasi mori këtë përgjigje, Isai (a.s.), tha:

-Ja pra, në sajë të kësaj të mire, fatkeqësia është larguar prej teje! (Hejthemi, III, 109-110)

Sa bukur e shpreh Mevlana i nderuar begatinë e shpenzimit të pasurisë në rrugë të Allahut:

"Pasuria nuk pakësohet aspak, duke dhënë lëmoshë.

Përkundrazi, bamirësia e ruan pasurinë nga humbja dhe shpërdorimi! Zekati që jep, bëhet rojë i qeses tënde. Edhe namazi që fal, bëhet çobani yt e të ruan prej të këqijave dhe ujqërve.

Kush mbjell, atij i boshatiset hambari, por kur vjen koha e të vjelave, sa prodhim merr ai në këmbim të atyre farave që ka hedhur? Sa hambarë të mbushur plotë merr në këmbim të një hambari që boshatisi?... Mirëpo, nëse gruri nuk përdoret aty ku duhet, por ruhet në hambar, do të jetë ushqim vetëm për insektet, krimbat dhe minjtë. Këto e shkatërrojnë atë plotësisht."

EDUKATA E ZEKATIT DHE DHURIMIT

Kur jepet zekati apo lëmosha, është shumë e rëndësishme të respektohen rregullat e mirësjelljes dhe

edukatës. Në mënyrë të veçantë, ai që jep duhet ta bëjë këtë duke ndjerë mirënjohje ndaj atij që e pranon. Kjo, sepse ai e shpëtoi atë prej një borxhi të detyrueshëm dhe u bë shkak i arritjes së shumë begative.

Kur jepet zekat apo lëmoshë prej mallrave, duhet që malli të jetë të paktën i cilësisë mesatare. Ne nuk duhet t'u japim të tjerëve diçka që, po të na jepej neve, nuk do ta prananim. Po ashtu, nuk duhet t'i çojmë dëm bamirësitë që bëjmë, duke i lënduar ndjenjat e nevojtarëve dhe duke ua kujtuar atyre këto mirësi. Allahu i Madhëruar e ka ndaluar rreptësisht këtë sjellje të shëmtuar.

Nuk është e drejtë as të kërkosh përsëri atë që ia ke dhënë njëherë nevojtarit. Edhe kjo sjellje është konsideruar jashtëzakonisht e shëmtuar.

Një nga çështjet e rëndësishme që duhet pasur kujdes kur jepet zekat dhe lëmoshë apo kur bëhet një mirësi, është respektimi i fshehtësisë. Kjo, sepse lëmosha që jepet haptazi, dobëson ndjenjën e turpit tek ai që merr dhe me kalimin e kohës kjo do të kthehet në një zakon, duke e humbur dëshirën e tij për të punuar. Përveç kësaj, dhënia haptazi i hap rrugë zhvillimit të cilësive të këqija, si mburrja, mendjemadhësia, pëlqimi i vetvetes etj.

Lëmosha duhet dhënë me sinqeritet vetëm për hir të Allahut. Dhurimet që bëhen për t'u dukur dhe për



interesa të ulëta të kësaj bote, shkojnë kot dhe nuk i bëjnë dobi njeriut.

RREZIKU I BRAKTISJES SË ZEKATIT

Individët dhe shoqëritë që nuk e shlyejnë borxhin e zekatit, i presin rreziqe të mëdha materialo-shpirtërore. Allahu i Madhëruar, i Cili na tërheq vëmendjen në lidhje me këto rreziqe, urdhëron:

“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.” (Bekare, 195)

DORA QË JEP ËSHTË MË E MIRË SE AJO QË MERR

Islami nuk e ndalon nevojtarin të kërkojë diçka prej të tjerëve. Por nga ana morale, ai nuk e këshillon këtë gjë. E megjithatë, e lejon lypjen në raste të nevojave ekstreme. Kjo, sepse t'u shtrish dorën të tjerëve, e ul qenien njerëzore. Për këtë arsye, edhe Rasulullahu (a.s.), kur merrte besën prej shokëve të tij, shumicës prej tyre u vinte si kusht që “të mos kërkonin asgjë prej askujt”.

Pra, duhet të përpiqemi të japim zekat, e jo të marrim, sepse i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Dora që jep, është më e mirë se ajo që merr. Ndihe mën tënde filloje prej atyre që ke marrë përsipër t'u sigurosh jetesën! Lëmosha më e mirë, është ajo që jepet prej mallit që tepron pas plotësimi të nevojave. Kush nuk kërkon gjë prej njerëzve, Allahu nuk e bën atë nevojtar ndaj askujt. Dhe kush është syngopur, Allahu e pasuron atë.” (Buhari, Zekat, 18; Muslim, Zekat 94-97, 106, 124.)

Përveç këtyre, Allahu i Madhëruar na tërheq vëmendjen edhe në ndjesinë e zemrës së njerëzve të mirë që japin zekat, lëmoshë dhe bëjnë mirësi. Duke nënkuptuar se bota e tyre shpirtërore duhet të bëhet si një skaner, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se nuk lypin. Ata do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato.” (Bekare, 273)

DËMET E KAMATËS

Islami, në sajë të institucionit të zekatit dhe dhurimit, u ka zgjatur dorën e ndihmës njerëzve që ndodhen në vështirësi, pa pritur asgjë në këmbim dhe, në këtë mënyrë e ka shëruar që në rrënjë këtë plagë të shoqë-

risë. Përkundër kësaj, Islami e ka ndaluar rreptësisht fenomenin negativ të kamatës, që në dukje është ndihmë apo lehtësim për njerëzit, por që në të vërtetë nuk bën gjë tjetër përveçse abuzon me gjendjen fatkeqe të njerëzve të pashpresë.

Fajdexhinjtë dëshirojnë që të tjerët të kenë probleme dhe të përfitojnë prej kësaj gjendjeje. Ndërsa ai që jep zekat, bëhet ortak me vuajtjet e të varfërve dhe nevojtarëve. Dëshira e tij e vetme, është të kënaqë Allahun e Madhëruar. Për këtë arsye, ai vazhdimisht mundohet të jetë ndihmës i robërve të Tij të vuajtur.

Sa më shumë mall dhe pasuri të ketë njeriu ambicioz dhe syngopur, aq më e paktë duket në sytë e tij. Ndërsa njerëzit që mësohen të japin lëmoshë dhe zekat, bëhen edhe zemërgjerë. Ata mjaftohen me pak prej mirësive të kësaj bote. Mirëpo syri i fajdexhiut është kapluar nga një ambicie e tillë, saqë dëshiron të shtojë pasurinë e vet, qoftë edhe duke shkatërruar të tjerët. Megjithatë, përfundimi i tyre është gjithmonë falimentimi dhe humbja, sepse Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Allahu ia heq çdo përfitim kamatës dhe e rrit përfitimin e bamirësisë...” (Bekare, 276)

Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kush e shton pasurinë e tij me anë të kamatës, pa tjetër që fundi i tij do të jetë falimentimi me anë të pakësimi të pasurisë.” (Ibn-i Maxhe, Tixharat, 58)

Nga ana tjetër, për shkak se sistemi i kamatës bazohet në transferimin e parasë nga njëri tek tjetri, pra duke forcuar njërin dhe duke i pirë gjakun tjetrit, në këtë mënyrë dëmtohen pasuria dhe themelet e shoqërisë, rritet inflacioni, të pasurit bëhen më të pasur dhe të varfrit më të varfër. Gjithashtu, nga aspekti ekonomik, shoqëror, fetar dhe moral, ky sistem e zhyt popullin në batac.

Përkundër kësaj, lëmoshat dhe dhurimet në formë ndihme ndaj individëve të varfër dhe në vështirësi, garantojnë vazhdimësinë e harmonisë dhe rregullit shoqëror. Për këtë arsye, ato bëhen shkaqet e begatisë edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.

Shkurtimisht, në ditët tona, kur ndjenjat vëllazërore janë dobësuar, paqja dhe qetësia shoqërore kanë humbur dhe urrejtja e armiqësisë është shtuar jashtë mase, ndihet një nevojë serioze për më tepër fushata dhurimi. Në vendin e të varfërve dhe nevojtarëve mund të ishim edhe ne. Për këtë arsye, dhurimet tona ndaj tyre, duhen konsideruar si shlyerje e borxhit të falënderimit që kemi ndaj Zotit tonë.



URTËSITË DHE DOBITË E ADHURIMEVE NË ISLAM

...vijon nga numri i kaluar

AGJËRIMI I RAMAZANIT

Kur vjen muaji i Ramazanit, në qiell ndodh një ngjarje e madhe. Mirësia dhe begatia e këtij muaji ndihet shumë lehtë nga banorët e tokës. I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë: *"Kur vjen muaji i Ramazanit, hapen dyert e qiellit, mbyllen dyert e xhehenemit dhe prangosen djajtë - shejtanët."*

Këto fakte, që përmenden në këtë hadith, argumentojnë për madhështinë, vlerën dhe pozitën e lartë që ka ky muaj tek Allahu i Madhëruar. Për mirësitë që ndodhin që nga nata e parë e muajit të begatshëm të Ramazanit, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë: *"Kur hyn nata e parë e muajit Ramazan, lidhen shejtanët dhe xhindët rebelë, mbyllen dyert e zjarrit dhe nuk qëndron hapur asnjë prej tyre; dhe hapen dyert e Xhenetit e nuk qëndron mbyllur asnjë prej tyre. Një thirrës thërret: 'O kërkues i së mirës, afrohu!' (për të kryer vepra të mira) O kërkues i së keqes, ndalu! (nga kryerja e të këqijave) Allahu (në këtë muaj) liron nga zjarri prej robërve të Tij dhe kjo ndodh për çdo natë."*

Imam Neueui thotë: *"Është e mundshme që hapja e dyerve të Xhenetit nënkupton se Allahu në këtë muaj i bekon robërit e Tij me disa adhurime, të cilat nuk bëhen në muajt e tjerë, si: agjërimi, falja e namazit të teravive,*

sadakaja e fitrit etj. E këto, pa dyshim që konsiderohen si shkaqe për hyrjen në Xhenet."

Allahu i Lartësuar ka zbritur ajete të qarta, të cilat nxisin për agjërim dhe sqarojnë dobitë e agjërit. Myslimani, nëse vazhdon gjatë muajit të agjërit, të përpiket të bëjë vepra të mira, si: përmend Allahun, lexon Kuran, fal namaz, jep lëmoshë dhe zekat, u bën mirë krijesave, është zemërgjerë, u jep buzëqeshje njerëzve, ka moral të mirë dhe përpiket me çdo gjë që ka për të pastruar veten e vet, padyshim që do të ketë dobi e nuk do t'i kalojë muaji kot, përveçse duke e parë veten e tij të ndryshuar. Prej dobive shpirtërore mund të përmendim:

1. **Agjërimi është mburojë.**
2. **Agjërimi të fut në Xhenet.**
3. **Agjëruessve u jepet shpërblim pa llogari - hesap.**
4. **Agjëruesi ka dy shpërblime:** kur ha iftar dhe kur takohet me Zotin e tij.
5. **Era që del nga goja e agjëruessit, është më e mirë dhe më e këndshme tek Allahu sesa aroma e miskut - parfumit.**

Për të gjitha këto që thamë më lart, i Dërguari i Allahut, (a.s.), në hadithin që transmeton Ebu Hurejre, (r.a.), thotë:

"Allahu thotë: **"Çdo vepër e birit të Ademit (e njeriut) është për të, përveç agjërimit, i cili është për Mua dhe Unë do të shpërblej për të."** Agjërimi është mburojë. Nëse dikush nga ju është agjërueshëm, të mos flasë asnjë fjalë të keqe dhe të mos e ngre zërin (të mos ankohet). Nëse atë e ofendon ose e lufton dikush, ai le të thotë: 'Unë jam agjërueshëm!' Beto hem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit se era që del nga goja e agjëruesit, tek Allahu është më e këndshme sesa parfumi. Për agjëruesin ka dy gëzime: kur ai ha iftar gëzohet, dhe kur të takojë Zotin e tij gëzohet me agjërimin e tij."

6. Agjërimi dhe Kurani do të ndërmjetësojnë në Ditën e Gjykimit për shokun e tyre. Pra, për atë që i ka kryer shpesh ato. Për këtë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë: "Kurani dhe agjërimi do të ndërmjetësojnë për njeriun në Ditën e Gjykimit. Agjërimi do të thotë: 'O Zoti im! Unë e kam ndaluar atë nga ushqimi dhe epshet (gjatë ditës), ndaj më lejo të ndërmjetësoj për të.' Ndërsa Kurani do të thotë: 'Unë e ndalova atë nga gjumi i natës (për të më lexuar mua), ndaj më lejo të ndërmjetësoj për të.' Atëherë u jepet leje që të ndërmjetësojnë."

7. Agjërimi është shlyerje dhe kompensim. I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë: "Fitnen (spravat) e burrit në familjen, pasurinë dhe fqinjët e tij i shlyen agjërimi."

8. Agjëruesit do të hyjnë në Xhenet nga një derë e veçantë, nga dera er - Rejjan. I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë: "Në Xhenet është një derë, e cila quhet er-Rejjan. Në Ditën e Gjykimit nga ajo derë do të hyjnë vetëm agjëruesit..."

Ndërsa, për dobitë fizike, pra trupore, mund të përmendim faktin se prej shekujsh agjërimi është aplikuar si teknikë kurative për shumë sëmundje dhe se shkollat më të mira të terapisë sot në botë, e këshillojnë agjërimin si hapin e parë të çdo trajtimi mjekësor.

Është vërtetuar shkencërisht se agjërimi ka efekt të fuqishëm në shërimin e sëmundjeve psikike, forcon vullnetin e agjëruesit; stabilizon dhe zbut ndjenjat e tij, i forcon dashurinë ndaj të tjerëve, i kalit atij ndjenjën e shpirtmadhësisë etj. Në këtë mënyrë, agjërimi forcon dhe mbështet personalitetin e njeriut dhe e bën atë më të fortë për të përballuar problemet dhe vështirësitë e jetës.

Agjërimi luan rol domethënës në pastrimin e organeve të trupit të njeriut nga papastërtitë, mbeturinat dhe lëndët helmuese. Ai çon në zhdukjen e tërë qelizave të dobëta që kanë rrethuar organet e tretjes dhe ndihmon në sekretimin dhe shkatërrimin e papastërtive nga stomaku dhe zorrët. Gjithashtu, ai ndihmon në shkatërrimin e fibrave të sëmura dhe të panevojshme. Kjo ndodh gjatë fenomenit të agjërimit, por që rindërtohen përsëri pas marrjes së ushqimit. Ky është shkaku që i ka bërë disa shkencëtarë të thonë se agjërimi ndihmon në kthimin e rinisë.

Lidhur me disiplinën që ushtrohet në agjërime, një mjek shprehet: "Dobia që arrihet prej ushqimit të paktë, duke u konsumuar me rregull, është më e madhe se dobia që arrihet prej ushqimit të tepërt dhe që konsumohet pa rregull. E kjo disiplinë nuk vihet re, veçse në agjërimin islam."

HAXHI

Haxhi ka vlerë të madhe, sepse është një nga punët më të vlefshme. E pyetën Profetin, (a.s.): "Cilat punë janë më të vlefshme?" Ai tha: "Besimi në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij." "Po pastaj?" Ai tha: "Lufta në rrugë të Allahut." "Po më pas?" Ai tha: "Haxhi i pranuar." (Buhari)

Allahu i Lartmadhëruar në Kuran ka thënë: **"Thirri njerëzit për haxhillëk: ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta, që të dëshmojnë dobitë e tyre dhe të përmendin Emrin e Allahut në ditët e caktuara mbi kafshët (për kurban), të cilat ua ka dhuruar Ai. Hani nga ato (mishin) dhe ushqeni nevojtarin e varfër!"** (Haxhxh, 27-28)

Abdurrahman es-Sa`di, në komentin e ajeteve të mësipërme ka thënë: "Të jenë tek faltarja e Allahut, që të arrijnë përfitime fetare nëpërmjet kryerjes së adhurimeve madhështore, veçanërisht adhurimeve që nuk kryhen në asnjë vend tjetër, veçse aty. Gjithashtu, përfiton edhe dobi të shumta të kësaj bote."

Duke qenë se ky rit është një nga shtyllat bazë të Islamit, na del si detyrë të nxjerrim në pah disa nga dobitë dhe përfitimet e këtij riti.

Së pari: Forcimi i lidhjes së myslimanëve duke iu referuar **kibles**. Drejt saj mbliidhen të gjithë njerëzit në formën më të lartë të adhurimit, siç është namazi, duke qenë në vetvete distancim nga orientimi drejt perëndimit mohues apo lindjes komuniste ateiste. Sepse myslimanët kanë krenarinë, vlerat dhe parimet e tyre.

Së dyti: Haxhi është mundësi e volitshme për t'iu afëruar Allahut. Me lloje të ndryshme adhurimesh, të cilat nuk i gjen në asnjë vend apo kohë tjetër, njeriu i afrohet Krijuesit të Tij, duke qëndruar në Arafat, duke fjetur në Muzdelifeh, duke guajtur gurët nëpër xhemarate (vende për të guajtur gurët në ditët e teshrikut), duke prerë kurbanin në vende të caktuara, duke bërë tavafin (rrotullimin) rreth Qabes, etj. Për këtë arsye, haxhi është nga veprat më të mira.

Transmetohet nga **Ebu Hurejra**, (r.a.) se ka thënë: "U pyet **Profeti**, (a.s.): "Cila është vepra më e mirë?" Tha: "Besimi në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij." "Po më pas?" Tha: "Xhihadi në rrugën e Allahut." "Po më pas?" Tha: "Haxhi i pranuar." (Buhari dhe Muslimi)

Ebu esh-Sha`thau ka thënë: "Analizova veprat e mira në tërësi dhe nxora përfundimin se namazi angazhon trupin, po ashtu edhe agjërimi. Sadakaja angazhon pasurinë, ndërsa haxhi i angazhon të dyja: trupin dhe pasurinë."

Së treti: Haxhi është një nga mundësitë më të mira dhe të veçanta që i jepen njeriut për të shlyer mëkatet dhe për të ngritur gradat. Transmetohet nga Amr bin Asi, (r.a.), se ka thënë: "Kur Allahu ma bëri të dashur Islamin për zemrën time, vajta te Profeti, (a.s.) dhe i thashë: "Zgjate dorën tënde që të të jap besën." Profeti, (a.s.), e zgjati dorën e tij, mirëpo unë e tërhoqa dorën time. Ai më tha: "Çfarë ke, o Amr?" Thashë: "Dua të vë kushte." Tha: "Çfarë kushti doje të vije?" Tha: "Që të më falen mëkatet e mia." Tha: "A nuk e di se Islami i shlyen mëkatet e mëparshme, a nuk e di

se hixhreti i shlyen mëkatet e mëparshme, a nuk e di se haxhi i shlyen mëkatet e mëparshme?” (Muslimi)

Transmetohet nga Ebu Hurejre, (r.a.), se ai ka thënë: “E kam dëgjuar Profetin, (a.s.), duke thënë: “Kush e kryen haxhin duke mos folur fjalë të pahijshme dhe duke mos bërë mëkate, kthehet pa mëkate si në ditën kur e ka lindur nëna e tij.” (Buhariu)

Transmetohet nga Ebu Hurejra, (r.a.), se Profeti, (a.s.), ka thënë: “Umreja i shlyen mëkatet deri në umren tjetër, ndërsa haxhi i pranuar ka si shpërblim vetëm Xhenetin.” (Buhariu dhe Muslimi)

Së katërti: Haxhi është xhihadi i grave, i të moshuarve dhe i të pafuqishmëve. Transmetohet nga Aisheja, (r.a.), se ka thënë: “Thashë: O Rasulullah! A të marrim edhe ne pjesë në betejat e xhihadi të bashku me ju?” Tha: “Xhihadi më i mirë dhe më i bukur është haxhi i pranuar.” Aisheja, (r.a.), tha: “Nuk do ta lë kurrë haxhin, pasi e dëgjova këtë fjalë nga Profeti, (a.s.).” (Buhariu dhe Muslimi)

Transmetohet nga Ebu Hurejra, (r.a.), se Profeti, (a.s.), ka thënë: “Xhihadi i të moshuarit, të pafuqishmit dhe i gruas, është haxhi dhe umreja.” (Nesaiu. Albani e ka konsideruar hasen)

Së pesti: **Në haxh ka fragmente mbresëlënëse të rra-lla**, që njeriu përjeton gjatë haxhit dhe që lënë gjurmë të pashlyeshme në zemrën e myslimanit. Duke qenë kjo një nga tiparet dalluese të haxhit, haxhiu përkujton Ibrahimin, (a.s.), *teuhidin*, në të cilin ishte prijës e thirrës, *emigrimin* në rrugë të Allahut, *thirrjen* e tij për haxh pas rindërtimit të Qabes, *lutjet* e tij për Meken, *begatinë* e të cilave i shohim ende.

Gjithashtu, haxhiu përkujton çfarë i ngjau Haxheres, nënës së Ismailit me ecjen e saj ndërmjet Safasë dhe Meruas, ecje që u shndërrua në traditë të vazhdueshme dhe kusht prej kushteve të haxhit. Përkujton ndodhinë e shfaqjes së burimit Zem-zem, ujit të begatë, deri në Ditën e Gjykimit.

Ai përkujton Ismailin në pjesëmarrjen e tij me babanë në rindërtimin e Qabes, mirësjelljen e tij me babanë dhe bindjen ndaj tij, pavarësisht urdhrit paraparak për sakrifikimin e tij. Përkujton se Meka është atdheu dhe vendlindja e Profetit, (a.s.), nga ku filloi shpallja dhe shkrepëti drita e Islamit.

Përkujton njerëzit e nderuar që kanë shkelur aty dhe kanë adhuruar Allahun: *profetë*, të *dërguar*, *sahabë* dhe *besimtarë* të devotshëm, duke ndjerë në vete se është vazhduesi i këtij karvani fisnik të begatë, duke krijuar lidhje të fortë me të parët e kësaj feje. Në të njëjtën kohë, i shtohet dashuria dhe vullneti për t’i pasuar ata hap pas hapi.

Përjeton madhështinë e faktoreve të parë dhe më të dalluar në botë, e cila është plot begati dhe udhëzim për njerëzimin. Përkujton momentin e vdekjes, kur del nga kjo botë i veshur me copë të bardhë si *i hrami* i tij, i thjeshtë dhe modest. Përkujton *Ditën e Gjykimit*, kur të gjithë njerëzit mblidhen në një vend dhe në një kohë, me një qëllim dhe të robëruar para Allahut, ashtu siç mblidhen të gjithë njëkohësisht në Muzdelifeh në një shesh të vetëm.

Së gjashti: Haxhi është një nga shkaqet e shtimit të furnizimit. Transmetohet nga Ibn Mesudi, (r.a.), se Profeti, (a.s.), ka thënë: “Kryejini herë pas here haxhin dhe umren, sepse ato e largojnë varfërinë dhe mëkatet, ashtu siç e largon farka papastërtinë nga floriri dhe argjendi. Ndërsa haxhi i pranuar, nuk ka shpërblim tjetër përveç Xhenetit.” (Ahmedi dhe Tirmidhiu. E saktësoi Albani)

Së shtati: **Haxhi është shkak për pranimin e lutjes së haxhiut.** Transmetohet nga Ibn Umeri, (r.a.), se Profeti, (a.s.), ka thënë: “Luftëtari në rrugë të Allahut, haxhiu dhe ai që bën umre, janë delegacioni mysafir tek Allahu. Ai i ftoi dhe ata iu përgjigjën, ata iu lutën Atij dhe Ai ua plotësoi kërkesat (u dha çfarë deshën).” (Ibn Maxheh Ibn Hibani dhe e saktësoi Albani)

Së teti: Haxhiu është nën garancinë dhe mbrojtjen e Allahut. Transmetohet nga Ebu Hurejra, (r.a.), se Profeti, (a.s.), ka thënë: “Tri kategori njerëzish janë nën garancinë dhe mbrojtjen e Allahut: Një person, i cili del për të shkuar në një nga xhamitë e Allahut, një person që del luftëtar në rrugën e Allahut dhe një person që del për në haxh.” (Ebu Nuajmi dhe e ka saktësuar Albani)

Së nënti: **Haxhi është pastrim nga gjynahet.** Profeti, (a.s.), ka thënë: “Kush e kryen haxhin dhe (gjatë kryerjes se tij) nuk shan dhe nuk bën gjynahe, kthehet si në ditën kur e ka lindur nëna e tij.” (Muttefekun alejhi)

Së dhjeti: **Shpërblimi i haxhit është Xheneti.** Profeti, (a.s.), ka thënë: “Përqendrohuni në kryerjen e haxhit dhe të umres, sepse këta të dy largojnë varfërinë dhe gjynahet si zjarri që pastron hekurin, arin dhe argjendin. Dhe s’ka shpërblim tjetër përveç Xhenetit për haxhin e pranuar.” (Tirmidhi)

Haxhi ka edhe shumë dobi të tjera. Për çdo rit ka nga një shpërblim të caktuar. Për këtë, Taberaniu transmeton se Profeti, (a.s.), ka thënë: “Kur të dalësh nga shtëpia me qëllim që të vizitosh Qaben, për çdo hap që bën bartësi (mjete) yt, Allahu do të të shkruajë një shpërblim dhe do të të fshijë një gjynah. Kur të dalësh për në Arafat, Allahu zbrit në Qiellin e dynjasë dhe u krenohet melekëve, duke u thënë: “**Këta janë robët e Mi, më kanë ardhur të rraskapitur dhe të pluhurosur nga çdo vend i largët, duke shpresuar mëshirën Time dhe duke u frikësuar nga dënimi Im, edhe pse nuk më kanë parë. Vallë, çfarë do të bënin sikur të më kishin parë?**” Edhe po pate gjynahe sa kokrrizat e rërës ose sa flokët e borës apo sa piklat e shiut, Allahu do t’i falte ato. E kur të gjuash gurët, shpërblimin e kësaj do ta ruajë për në Ahiret. E kur ta rruash kokën, për çdo qime që të bie, fiton një shpërblim, e kur të bësh tauaf, del prej gjynaheve si ditën që të ka lindur nëna.”

Edhe për umren, pra vizitën e Qabes jashtë kohës së haxhit, Profeti, (a.s.), ka thënë: “Umreja pas umresë është shpagim për atë që ka ndodhur ndërmjet tyre (prej mëkateve të vogla); kurse për haxhin e pranuar, s’ka shpërblim përveç Xhenetit.” (Muslimi)

E thjeshta

Kur Italo Calvino-s i erdhi një ftesë për të dhënë një cikël leksionesh në disa universitete në Amerikë, besoj se është vënë jo pak në siklet e në mëdyshje se çfarë mund të trajtojë një autor evropian (që si “rregull” nuk i ndahen pikëpyetjet) në një vend pa asnjë pikëpyetje apo mëdyshje, që synonte dhe synon me bindje religjioze të jetësojë një utopi; domethënë, në një vend me një qytetërim të lartë dhe me një kulturë të ulët¹ (fenomeni i kulturës masive).

Duke qenë se e kishte pranuar ftesën, natyrisht që iu vu punës për të shkruar leksionet, dhe shkroi pesë syresh: “E lehta”, “Shpejtësia”, “Saktësia”, “Dukshmëria” dhe “Larmia”, të cilat, pas vdekjes së autorit, u botuan në një vëllim, nën titullin *Leksione amerikane*, titull që nuk ia kishte vënë vetë autori, jo sepse nuk e lejoi vdekja, por sepse tema të tilla vështirë të kenë një emërues të përbashkët.

Në fakt, tema të tilla, aq më tepër në kohën kur u ftua Calvino-ja në Amerikë (1984), nuk mund të mbahen askund tjetër më mirë sesa në atë vend:

“E lehta” – sepse në Amerikë duhet programuar edhe gjysma e sekondës, ose sepse fraza *take it easy* është lajtmotiv jete;

“Shpejtësia” – ngaqë utopia tek e cila beson paria atje duhet ndërtuar sa më parë dhe gati në çdo cep të Amerikës çdo gjë ecën më shpejt se jeta;

“Saktësia” – si *conditio sine qua non* e realizimit të planit (me përpikëri) të parajsës tokësore.;

“Dukshmëria” – sepse ajo që ka vlerë është vetëm ajo që duket e që preket;

“Larmia” – si një nga nevojat më të mëdha të shoqërisë amerikane.

Natyrisht që këto ishin vetëm disa arsye se përse Calvino-ja zgjodhi të trajtonte pikërisht këto tema; por, jam i bindur që, pak a shumë, këto kanë qenë një

shkak i fortë për të.

Faktikisht, Calvino-ja kish programuar të mbante gjashtë leksione, ku pesë i kishte përfunduar pa u nisur, dhe të gjashtin do ta shkruante gjatë kohës që do qëndronte atje. Këtij të fundit i është gjetur vetëm emri nga e shoqja dhe titullohej “Consistency”.

Duke e tejkaluar këtë, pesë leksioneve që sot kemi të botuara të Calvino-s do t’i shtoja edhe një tjetër, patjetër që për mijëvjeçarin që ka hyrë, që Calvino-ja nuk e mbërriti dhe siç e paralajmëroi edhe titulli, është fjala për “të thjeshtën”.

Duhet të vëmë në dukje që tani se nuk bëhet fjalë për “të thjeshtën” në kuptimin që e përdorim në përditshmëri², që përgjithësisht merret si “t’i biesh shkurt” ose si bezdi nga thellimi. Me të thjeshtën në këtë rast nënkuptoj një gjendje qenësore të njeriut, pra një nevojë përcaktuese për harmoninë e brendshme. Domethënë, e thjeshta nuk është vetëm një zgjedhje që ne bëjmë rutinë në raste të caktuara, por një shoqëruese e jona në rrugën drejt përmbushjes ontologjike.

Le ta nisim me Zanafillën, me rrëfimin e njohur për Adamin dhe Evën, që siç e dimë vendosën (zgjodhën, pra qenë të lirë) ta hanin frutin e ndaluar; domethënë, braktisën të thjeshtën (jetën në parajsë, ku nuk u mungonte asgjë dhe mbi të gjitha nuk ekzistonte vdekja), e kështu u përjashtuan nga parajsa dhe zbritën në tokë, ose poshtë, ose ranë (në vështirësi).

Nëse do flisnim për ateizmin, monoteizmin dhe politeizmin (idhujtarinë), ateizmi dhe politeizmi mbeten dy qëndrime *in extremis*, dhe për rrjedhojë e thjeshta identifikohet me monoteizmin, sigurisht jo në kuptimin matematikor apo gjeometrik të fjalës. Ateizmi është një gjendje në të cilën përjeton dhe mendon vazhdimisht vetëm mohimin/mospranimin, gjë që përbën një rëndesë të papërballueshme, si dhe mungesë të

1. Nga ana tjetër, India njihet si vendi i kulturës së lartë dhe i një qytetërimi të ulët.

2. Sido që edhe ky përdorim ngërthen të qenësishmen e vet, ndoshta si shenjë për mungesën e së thjeshtës si të tillë.

theksuar larmie. Nga ana tjetër, politeizmi është një huti ose një çakordim sa mendor e sa metafizik, për shkak të një numri gjithnjë në shumës zotash, idhujsh, hyjnish, idesh, njerëzish e kështu me radhë, që shkaktojnë një gjendje të vazhdueshme pasigurie e dyshimi, dhe për pasojë edhe ankthi. Në rastin e monoteizmit është e pamundur të mos e "provosh" qoftë ateizmin, qoftë politeizmin, të paktën nëpërmjet të menduarit. Në këtë kuptim, monoteizmi qëndron mbi dy të parat, sepse është gjithëpërfshirës dhe i mjaftueshëm.

Nëse do të flisnim për elitat udhërrëfyese e model për njerëzit, ato mund t'i reduktojmë (lexo: edhe thjeshtojmë) në tri: profetët, mendimtarët/filozofët dhe sofistët (sot si politikanë). Të vetmit që kanë jetuar sipas asaj që kanë kumtuar e thënë janë profetët, ndërsa të tjerët ndryshe flasin e ligjërojnë, ndryshe veprojnë e jetojnë. Nëntëdhjetë për qind e mbase më shumë e asaj çfarë kanë shkruar filozofët ka mbetur e kyçur nëpër biblioteka, pa qenë e mundur të jetësohet. E njëjta gjë vlen edhe për sofistët. Është e qartë besoj se e thjeshta dhe njëherësh e drejta është që të jetosh sipas asaj që beson/mendon dhe shpreh me gjuhë.

Meqë jemi në këtë kontekst, e thjeshta qëndron edhe te Sokrati, pikërisht te botëkuptimi i tij: ai nuk e shkruante këtë të fundit, por synonte ta jetonte, duke aluduar qartazi me këtë se çfarë kuptimi e dobie ka për njeriun ajo që shkruhet dhe mbetet vetëm në letër, pa qenë e mundur të jetohet sipas saj.

"Të gjithë njerëzit mendojnë të ndryshojnë botën, por asnjë veten", thoshte Tolstoi. Ky konstatim na kujton prirjen tonë për të harruar veten dhe për t'u marrë me të tjerët; ndërkohë që e vërteta është se, mbi të gjitha, ne kemi nevojë të ndryshojmë veten dhe natyrisht kjo është e thjeshta.

Një hapësirë ku është tradhtuar e thjeshta është edhe mënyra se si funksionon sot mjekësia, duke asgjësuar gati çdo mundësi për kurimin me barna natyrale/bimore (krijimi i stereotipit "mjekësi popullore") dhe duke ngulmuar me shumë mënyra që njerëzit të kurohen me ilaçe të fabrikuara, ku qoftë edhe paracetamoli ka tre deri në katër efekte anësore, do habitemi jo pak se si njerëzit, të fiksuar pas kultit të mjekut (magjepsje e plotë), shkojnë me arsyetimin se po të praktikojmë kurat natyrale na shkon shumë shtrenjtë!, ndërkohë që qeset me ilaçe pas ilaçesh (se pasardhëset neutralizojnë dëmin e paraardhëseve!) që blejnë në farmaci,

kur qëllon që i llogarisin në fund, nëse ka një fund kjo rrugë pa krye, kapin kokën me dorë.

Si për intermexo, le të citojmë diçka, ku besoj se nuk është e vështirë të pikaset e thjeshta:

"Teksa po udhëtonte në viset në veri të lumit Han, Tzu-Gung-u pa një plak që po punonte kopshtin. Ai kish-te hapur një kanal për vaditje. Plaku zbriste në pus, mbushte një enë me ujë që e mbante në krahë dhe e zbraste në kanal. Në këtë mënyrë, me gjithë stërmundimin, rezultatet e punës dukeshin të papërfillshme.

Tzu-Gung-u i tha: – Ka një mënyrë për të vaditur njëqind kanale në ditë pa u munduar shumë. A të ta tregoj?

Kopshtari drejtoi trupin, e pa dhe i tha: – Ç'është kjo mënyrë?

Tzu-Gung-u iu përgjigj: – Merr një levë druri të rëndë në bisht dhe të lehtë në majë.

Në këtë mënyrë mund të bësh që uji të ngjitet lart me po atë shpejtësi që del nga burimi.

Plaku u nxeh dhe ia ktheu: – Mësuesi im më ka thënë se kushdo që përdor makina e bën punën si një makinë. Atij që punon si makinë edhe vetë zemra i bëhet si një zemër makine, dhe kush ka zemrën e një makine humbet thjeshtësinë. Ai që humb thjeshtësinë s'është më i sigurt për sprovat e shpirtit të tij. Pasiguria për sprovat e shpirtit është diçka që nuk pajtohet me ndershmërinë. Nuk është se unë nuk i njoh këto lloj gjërash, por më vjen turp t'i përdor ato."³

Një tjetër drejtim ku ndihet fort mungesa e të thjeshtës është edhe komunikimi, ku kulti i angazhimit, profesionit, karrierës etj., ka bjerrë njeriun brenda nesh dhe është bërë vërtet e mundimshme të shkëmbesh dy fjalë "njerëzore".

Nëse do gjurmonim diçka edhe nga letërsia, kam bindjen se nuk ka personazh më të thjeshtë në botë sesa Don Kishoti, por njëkohësisht është edhe më i keqkuptuari⁴, pikërisht ngaqë është aq i thjeshtë në "misterin" e tij.

Po mjaftohemi vetëm me një skicë për të thjeshtën, se me sa duket i ndihet mungesa gjithandej. Domethënë, ka punë për një libër më vete.

3. Cituar nga Marshall MacLuhan në librin *Instrumentet e komunikimit - media si një zgjatim i njeriut*, f. 76. Tiranë: Instituti i Dialogut & Komunikimit.

4. Me "Don Kishot" e akuzojnë njëri-tjetrin shumë njerëz.



FINANCA ISLAME

ecuria e saj në kohën e krizës globale

Financa islame, si një nga segmentet me rritjen më të shpejtë në industrinë e sotme bankare, ka arritur një volum të konsiderueshëm transaksionesh gjatë dekadës së fundit. Në vitin 2007, sipas një raporti të revistës prestigjioze "The Banker", rritja e vlerës së aseteve të krijuara me anë të transaksioneve në përputhje me Sheriatin, arriti nivelin 29.7%. Kjo, në një kohë kur sipas të njëjtit raport, kjo rritje ishte vetëm 16.3% për 1000 bankat më të mëdha që përfshiheshin në studim.

Nëse shohim ecurinë e bursave për vitin 2008, kemi një rënie prej 38.5% të indeksit S&P 500 dhe 33.8% të atij Dow Jones Industrial. Në të njëjtën kohë, indeksi Dow Jones pati një rënie prej vetëm 7% për kompanitë që aplikojnë parimet financiare islame. Investimi islam në aksione ndjek të njëjtën logjikë si në llojet e tjera, por këtu, tipet e aksioneve ku mund të investohet janë të kufizuara. Për shembull, nuk mund të investohet në kompani të përfshira në aktivitete të tilla si baste, tregtia e mishit të derrit, pornografi apo tregtim ose prodhim duhani. Ndalohet gjithashtu investimi në kompani ku borxhi arrin nivelin 30% të kapitalit. Për më tepër, ky i fundit ishte kufizimi që luajti rolin kryesor në mbrojtjen e investitorëve që vepronin në përputhje me Sheriatin. Një analizë e thellë çon në konkluzionin që Financa Islame ka arritur të shpëtojë nga pasojat e rënda të krizës, si rezultat i mospërfshirjes së saj në shumë nga sektorët që patën ndikimin më negativ në të. Në epiqendër të krizës financiare ishin kreditë subprime që janë kredi të akorduara shtresave të tilla të shoqërisë, të cilat për shkak të të ardhurave të kufizuara e kanë të dyshimtë aftësinë për shlyerje të kredisë. Institucionet financiare

islame mund të financojnë blerjen e shtëpive dhe kjo mund t'i çojë edhe në kredi subprime, por praktika e kujdesshme e këtyre institucioneve lejon që banka të financojë një përqindje më të ulët të vlerës së banesës sesa institucionet e tjera. Për më tepër, Institucionet Financiare Islame japin kredi një përqindje më të vogël të kapitalit të vet sesa japin institucionet e tjera.

Risku kontraktual është gjithashtu i ndaluar në Islam. Në këtë kontekst, ndalohen kontratat që bazohen në ngjarje të ardhshme, probabiliteti i të cilave nuk mund të përcaktohet me saktësi. Një rast tipik i këtyre është "shitja shkurt" e cila funksionon si më poshtë:

Një person A merr borxh nga një person B një sasi të caktuar letrash me vlerë dhe pastaj i shet ato. Në momentin që skadon afati i borxhit, personi B i blen përsëri dhe ia rikthen atij A. Në rast se çmimi i këtyre letrave me vlerë ka pësuar rënie gjatë kësaj periudhe, personi A ka dalë me fitim ku ky i fundit llogaritet si diferenca mes çmimit të shitjes në momentin e marrjes borxh dhe çmimit të blerjes kur ky borxh skadon. Është pikërisht lëvizja e çmimit të letrës me vlerë që përbën ngjarjen e pasigurt që e bën këtë transaksion të ngjashëm me një bast. Dëmi i këtij instrumenti nuk kaloi pa u vënë re edhe nga Komisioni i Letrave me Vlerë në SHBA, i cili i ndaloi përkohësisht gjatë vitit 2008 këto lloj transaksionesh, në mënyrë që tregu të fitonte stabilitet. Janë pikërisht instrumente të tilla dhe të tjera të ngjashme që George Soros i quan "Bomba me Hidrogjen", kurse Warren Bufet "Armë financiare të shkatërrimit në masë".

Në situatën aktuale janë më shumë se 100 institucio-

ne financiare të cilat operojnë në mbi 70 vende të botës, që përdorin instrumente me bazë rregullat e Sheriatit. Kërkesa e vazhdueshme për produktet financiare islame, që filloi në vitet '80 dhe vazhdoi me ritme rritëse në vitet që pasuan, tregon që bankat tregtare kanë një interes në rritje për produkte të tilla.

Po sipas raportit të "The Banker", 7 vendet e para për sa i përket aplikimit të instrumenteve financiare në përputhje me Sheriatin, ziheshin nga vende me shumicë popullsie myslimane, vendi i 8 – të ishte Britania e Madhe. Është pikërisht ky vend, ai në të cilin në vitin 2004 u themelua banka e parë në botën perëndimore që operon vetëm mbi bazën e parimeve islame: Banka Islame e Britanisë. Kohët e fundit vlerësohet që niveli i aseteve të bankave islame në Britani ka arritur nivelin 12 bilionë paund, që tejkalon edhe atë të vendeve të tilla me shumicë myslimane, si Turqia, Pakistani, Bangladeshi dhe Egjipti. Përveç kësaj, janë mbi 55 kolegje dhe institucione të tjera arsimore që ofrojnë leksione mbi Financën Islame. Është fakt që një kontribut i rëndësishëm në rritjen e volumit të transaksioneve në përputhje me sheriatin, vjen nga tregje jotradicionale në këtë fushë. Kjo tregon që protagonistët e tregut global dhe hartuesit e politikave po i kushtojnë vëmendje gjithnjë e më tepër potencialit që ofron Financa Islame. Qeveria Britanike ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë drejtim me anë të ndryshimeve në legjislacion dhe akteve të tjera nënligjore. Hapat e mirëmbledhur të ndërmarra në këtë vend janë një shembull i qartë sesi tregjet e reja financiare islame kontribuojnë në zhvillimin e tregut dhe suksesi i arritur u ka dhënë spunto vendeve të tjera, si Franca dhe Gjermania të mendojnë seriozisht për mbështetjen që mund t'i japin këtij sektori.

ZHVILLIMI I FINANCËS ISLAME NË DISA VENDE TË BE

FRANCA

Viti 2008 njohu një rritje të tendencës së institucioneve financiare të këtij vendi në lidhje me aplikimin për marrjen e licensave që lejonin ushtrimin e aktiviteteve në përputhje me parimet e Financës Islame. Me një popullsi myslimane prej rreth 6 milionë, në këtë vend kanë filluar të dalin në dritë "dritaret islame", të cilat janë sektorë të veçantë të disa bankave me emër, si p.sh. BNP Paribas, të cilët ofrojnë shërbime në përputhje me parimet financiare islame. Për më tepër, aktualisht operojnë një numër i konsiderueshëm bankash me qendra në vendet e Lindjes së Mesme, të Gjirit Persik apo vende të tjera myslimane. Disa nga këto banka kanë mbi 30 vjet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Francë. Çështjet më kryesore që shtrohen aktualisht në lidhje me zhvillimin e Financës Islame në këtë vend janë:

- Nuk është e nevojshme që legjislacioni t'i japë trajtim të veçantë Financës Islame. E vetmja kërkesë është që transaksionet në këtë fushë të ekzaminohen me

vëmendje rast pas rasti për të evituar keqkuptimet e mundshme.

- Qëllimi kryesor i autoriteteve përgjegjëse është që përdoruesit e shërbimeve të Financës Islame të jenë të mbrojtur me të njëjtën korrektësi në zbatimin e ligjit si dhe ata të financës konvencionale.

- Specifikat e këtyre shërbimeve është e mundur të interpretohen në të njëjtin kuadër ligjor si të tjerat, mjafton që në licensën që rregullon këto lloj aktiviteteve të vendosen kushtet e nevojshme.

ITALIA

Islami është feja e dytë në këtë vend, me rreth 1.2 milionë besimtarë. Si rezultat, disa banka në këtë vend kanë filluar të ofrojnë produkte të cilat nuk ndryshojnë shumë nga ato të Financës Islame. Në pjesën më të madhe, myslimanët në Itali përfshihen në shtresat shoqërore me të ardhura të ulëta dhe mund të jenë në rastin më të mirë pronarë të bizneseve të vogla, të cilët përfitojnë nga karakteri pjesëmarrës i shërbimeve financiare islame. Aktualisht legjislacioni nuk ka asnjë pengesë për hyrjen në tregun italian të institucioneve financiare islame.

Vlen të përmendet se institucione prestigjioze ndërkombëtare po shprehin çdo ditë e më shumë interes në lidhje me Financën Islame. Malcolm Knight, Drejtori i Bankës për Rregullime Ndërkombëtare, i cili është institucioni që vendos parimet e Manaxhimit të Riskut në pjesën më të madhe të Bankave në botë, përfshi këtu mjaft vende të zhvilluara ose në zhvillim, po ashtu edhe vendin tonë, shprehet si më poshte:

"Vitet e fundit kanë njohur një rritje të konsiderueshme të shërbimeve financiare islame dhe ekzistojnë të gjitha arsyet që kjo rritje të vazhdojë me një ritëm të shpejtë. Duket qartë që ka një kërkesë në rritje për këto produkte, e cila shoqërohet me rritje të vullnetit nga ana e bankave, qofshin ato edhe joislame, për të ofruar këto lloje shërbimesh."

Po ashtu, Universiteti Prestigjioz Harvard në Massachusetts, për të 10-in vit radhazi më datat 24 dhe 25 mars 2012 ka organizuar Forumin mbi Financën Islame me temë: "Financa Islame dhe Zhvillimi", ku çështjet kryesore të trajtuara përfshijnë:

- Cili është kontributi historik i Financës Islame në zhvillimin e ekonomisë?

- Cilat janë parimet kryesore të Financës Islame, që e bëjnë atë të dobishme në promovimin e zhvillimit ekonomik?

- Cilat janë praktikat më të mira mes besimeve të ndryshme, që mund të aplikojnë me sukses parimet e besimit në praktikën e biznesit?

- Cilat praktika dhe politika i mundësojnë Financës Islame arritjen e objektivave të saj socio-ekonomike?



Jo çdo gjë që shkëlqen është *Flori*.

Nuredin Nazarko

Bota në të cilën jemi hedhur të jetojmë është botë e kontradiksionit. Ajo nuk mund të jetë botë e një dimensionit. Në qoftë se do të ishte e tillë, atëherë as njeriu nuk do të mund të ishte njeri. Në këtë botë, ku të kundërtat përplasen vazhdueshmërisht me njëra-tjetrën, në kohë dhe hapësirë, gjendet qenia njerëzore. Përgjatë përkohësisë njeriu gjendet në situata nga më të ndryshmet. Në të gjitha situatat që gjendet, prezenca e të tjerëve të sillojit të vet është e pashmangshme. Kjo për arsye se njeriu nuk mundet të jetojë tërësisht i vetmuar dhe i shkëputur nga pjesa tjetër e njerëzve. Përdërisa njeriu është njeri, jo të gjithë njerëzit zgjedhin si mënyrë jetese të njëjtën mënyrë jetese.

E megjithatë, përtej formave dhe larushive të

implikuara në zbulimin e një mënyre jetese të caktuar, dy dhe vetëm dy janë rrugët në të cilat mund të jetësosh mënyrën e të jetuarit. Ato janë të ndara dhe të pabashkueshme që nga hershmëria e tyre. Po kështu dhe mënyrat e të jetuarit, të modeluara sipas rrugëve të caktuara janë të ndara dhe të pabashkueshme që nga hershmëria e tyre dhe nuk ka sesi të jetë ndryshe. Në këtë ndryshueshmëri do të përplasesh, do të njohësh dhe do të ndjesh forma, ngjyra, melodi nga më të ndryshmet dhe nga më të llojllojshmet.

Shumë syresh do të të duken të bukur, të virtytshëm, të mençur, të urtë, vizionarë, të edukuar, të pasur, jetues për t'u pasur zili. Të tjerë syresh do të të duken të shëmtuar, të pavirtytshëm, budallenj,

të marrë, dritëshkurtër, të çedukuar, të varfër, jetues për të t'u neveritur. Pse na ndodh një gjë e tillë? Pse shumë syresh i vështrojmë si më të plotësuarit dhe të tjerë i vështrojmë si më të rrënuarit? Duhet të mbajmë parasysh se perceptimet që formojmë për të tjerët e sillojit tonë formohen nga pika jonë e këndvështrimit. Për shumë syresh kjo pikë mbetet e pandryshueshme në rrjedhën e kohës dhe për të tjerë syresh ndryshon në rrjedhën e kohës. Po vetë pika jonë e këndvështrimit, nga se është e varur?

Pika jonë e këndvështrimit nuk është një lindje spontane në një moment të caktuar. Ajo është pjesë e pandarë e rrugëtimit të njeriut në përkohësi. Sipas rrugës në të cilën ecën njeriu do të formohet dhe pika jonë e këndvështrimit. Ajo është tërësisht nën ndikueshmërinë e rregullave që përthithim përgjatë rrugëtimit tonë nga njëra apo tjetra rrugë. Edhe pse ne zgjedhim të shkelim njëren apo tjetren rrugë, gjendja jonë përsëmbrendshmi nuk është konstante.

Ajo njeh luhatjet e veta, të cilat pa diskutim ndikojnë mbi pikën tonë të këndvështrimit. Ka çaste kur ndihemi pesimistë, ka çaste kur ndihemi optimistë. Ka çaste kur ndihemi të ngushtuar, ka çaste kur ndihemi të çliruar, madje të gatshëm për të fluturuar. Ka çaste kur gjykimi ynë është i turbulluar, ka çaste kur gjykimi ynë është i kthjellët dhe i kristaltë. Ka çaste kur jemi të pështjelluar nga implikimi në gjendje të caktuara emocionale, ka çaste kur jemi mjaftueshëm të arsyeshëm. Ka çaste kur re të errëta na mbështjellin, ka çaste kur dielli shkëlqen përmbi zemrat tona. Mes kësaj luhatshmërie na duhet të ndërtojmë pikën tonë të këndvështrimit ndaj botës që na rrethon, ku janë të përfshirë edhe silloji ynë.

Ne jemi të prirur që të tjerët t'i vështrojmë, jo nisur nga ajo çfarë ata kryejnë dhe realizojnë, por nga ajo çfarë ne jemi. Ky lloj vështrimi është më i fuqishëm në një gjendje idealiste dhe në një gjendje ku ne ende nuk kemi zbritur në patalokun e jetës. Në gjendjen ideale jemi të prirur të besojmë pa kushte në pastërtinë e sillojit tonë. Nuk ndalemi të analizojmë gjatë, duke besuar se përderisa hapërojmë në të njëjtën rrugë, a mund të ketë diçka që të shprishë parimet dhe idealet që kemi përthithur?

A nuk u kemi besuar të njëjtave parime? A nuk u kemi besuar të njëjtave ideale? A nuk jemi duke

ecur në të njëjtën rrugë? A nuk jemi duke përdorur të njëjtin sistem referimi si pishtari që na ndriçon rrugën ku duhet ecur? Atëherë, përse duhet të dyshojmë tek silloji ynë? A mundet që të gjendemi në këtë gjendje dhe të veprojmë tjetërfarë nga ajo çfarë duhet vepruar në raport me sillojin tonë?

Të përfshirë nga gjendja idealiste, jo vetëm që jemi të prirur t'i vështrojmë të tjerët nga ajo çfarë ne jemi, por jemi të prirur edhe t'i pranojmë dhe të ndërtojmë raporte me ta, vetëm e vetëm se përjashtësia e tyre flet më shumë sesa brendësia. Natyrisht që kjo mënyrë e të vështruarit të sillojit tonë është rezultat i parimit se përjashtësia duhet të jetë pasqyrim i drejtpërdrejtë i brendësisë, e panjollësor me hile dhe mashtrim. Atëherë, çfarë duhet të bëjmë? Të heqim dorë nga parimi vetëm se disa të papërgjegjshëm e keqpërdorën për të treguar në patalok fytyrën e vërtetë? Natyrisht që nuk mund të sillemi në të njëjtën mënyrë si të papërgjegjshmit në raport


me parimet, në qoftë se këto parime na është bërë e mundur t'i pranojmë me pastërti.

Atëherë duhet të korrigjojmë idealizmin tonë në raport me të tjerët dhe të mos besojmë verbërisht ndaj çdokujt që shpërfaq të njëjtën përkatësi. Pataloku i jetës ëshë fytyra e vërtetë e çdokujt me të mirat dhe të ligat që ka. Është e natyrshme që ne të gabojmë, por të keqpërdorim parimet për të përfutur padrejtësisht në kurriz të sillojit tonë, duke qenë krejt

të vetëdijshëm, kjo është tepër e rrezikshme. Dhe këtu nuk ndërmendim vetëm përfitimin material. Duhet të korrigjojmë idealizmin tonë në raport me të tjerët dhe të mos na shkojë uji nën rrogoz nga të papërgjegjshmit, edhe pse shpërfaqin të njëjtën përkatësi. Të qëndruarit nën hijen e parimeve pastërtisht, pa u vramendur mbi pëlqyeshmërinë e të tjerëve, është gjëja më e çmuar që mund t'i jepet njeriut në kohën kur larushitë e formave, ngjyrave, melodive ndërhyjnë kaq shumë në jetët tona, sa që duket sikur nuk kanë të sosur në batisjen pompoze të autenticitetit të qenies njerëzore. Shkëlqimi përjashtësor nuk na verbon, nuk na topitë mendjen për pastërtinë dhe sinqeritetin e sillojit tonë.

Të dalim nga kështjella e besueshmërisë pa kushte vetëm për hir të së njëjtës përkatësi dhe të zbrisim në patalokun e jetës, ku verifikohet shkëlqimi i vërtetë i çdokujt.

Ne jemi të prirur që të tjerët t'i vështrojmë, jo nisur nga ajo çfarë ata kryejnë dhe realizojnë, por nga ajo çfarë ne jemi.



Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

QËLLIMI I FESË ËSHTË SHPËTIMI I NJERIUT

Allahu, Sunduesi dhe Krijuesi i gjithësisë, ndër të tjera krijoi edhe njeriun, i cili midis shumë krijesave të tjera ka një vend dhe pozitë krejt të veçantë. Lehtësisht mund të themi se qëllimi i krijimit të gjithësisë është njeriu, kurse qëllimi i krijimit të njeriut është ibadeti. Prandaj, në epiqendër të shpalljes hyjnore qëndron njeriu. Qëllimi më i madh i fesë është mbrojtja, zhvillimi dhe ngritja shpirtërore e njeriut. Në univers çdo gjë i shërben një qëllimi të caktuar, asgjë nuk është e paqëllimtë.

Nga ky këndvështrim, tekstet fetare që marrin në mbrojtje njeriun janë të orientuara në realizimin e

lumturisë së tij në këtë botë dhe botën tjetër. Arritja e lumturisë është e lidhur ngushtë me parimin: "Realizo të dobishmen dhe qëndro larg të dëmshmes." Gjëja më e dobishme për njeriun është të qenët afër Allahut, kurse më e dëmshmja është qëndrimi larg Tij. Për realizimin e kësaj dobie të madhe, në tekstet fetare gjenden një sërë parimesh. Në qendër të urdhëresave fetare, të cilat synojnë përmasën shpirtërore dhe materiale dhe ruajtjen e ekuilibrit të këtyre veçorive, qëndron mbrojtja dhe zhvillimi i njeriut.

Largësia dhe afërsia janë relative. Ahireti, i cili sot na duket shumë larg, në të vërtetë është shumë afër.

Një njeri, zemrën e të cilit e ka mbuluar perdjë e mëkateve, nuk mundet ta shikojë realitetin, atij afërsia i duket larg dhe largësia afër, në këtë mënyrë ai përfshihet nga bataku i gjërave të dëmshme, duke u larguar gjithnjë e më shumë nga gjërat dobishjellëse.

Siç dihet, përmasa materiale e njeriut ka nevojë për ushqim material, kurse përmasa shpirtërore ka nevojë për ushqim shpirtëror. Nëse njëri nga këto i jepet përparësi në kurriz të tjetrës, atëherë prishet ekuilibri. Prandaj, për ruajtjen e ekuilibrit, për të siguruar vazhdimin e jetës dhe për të realizuar ibadetin ndaj Allahut, feja jonë ka parashikuar një sërë rregullash të dobishme për njeriun.

Në përgjithësi, këto rregulla ndahen në tre grupe: të domosdoshme, të nevojshme dhe të dobishme.

Të domosdoshmet përbëhen nga nevoja thelbësore dhe jetike për njeriun. Mbrojtja e fesë, mendjes, jetës, pasurisë dhe pasardhësve përfshihen në këtë grup.

Tek të nevojshmet përfshihen nevojat të cilat sigurojnë një jetë më të mirë, por që nuk janë jetike për njeriun, mungesa e të cilave nuk bëhet pengesë për vazhdimësinë e jetës.

Kurse tek të dobishmet përfshihen gjërat që i sigurojnë njeriut komoditet dhe rehati.

Ne këtu do të përqijemi të trajtojmë shkurtimisht pesë domosdoshmëritë që merr feja nën mbrojtje.

1. MBROJTJA E FESË

Nevoja për besim ekziston natyrshëm në qenien e njeriut. Krijuesi ka vendosur në qenien e njeriut ndjenjën e Tëvhidit, besimit të pastër në një Zot. Ajeti kuranor: **“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut.”** (Rum, 30); thekson pikërisht këtë fakt dhe kjo është arsyeja që njerëzimi gjatë gjithë historisë ka qenë i lidhur pas një feje të caktuar.

Liria e besimit dhe respektimi i besimeve zë një vend të rëndësishëm në botëkuptimin islam. Prandaj karta e Medines u njohu anëtarëve të besimeve të tjera status dhe të drejta të veçanta. Përmes kësaj karte, hebrenjtë fituan të drejtën që problemet e veta t’i zgjidhnin sipas dispozitave fetare të tyre. Në epokën e lumturisë popullit kristian të Jemenit iu krijuan mundësitë për të kryer ritet fetare pranë xhamisë. Islami gjatë gjithë historisë ka inkurajuar respektimin

e besimit dhe krijimin e marrëdhënieve normale me besimtarët e feve të tjera.

Feja ka marrë përsipër ruajtjen e njeriut si krijesën më të vyer në univers. Sepse vazhdimësia e fesë është e lidhur drejtpërdrejt me shëndetin dhe vazhdimësinë e njeriut, kurse vazhdimësia e njeriut është e mundur përmes krijimit të familjes. Prandaj Pejgamberi (a.s.), e ka konsideruar martesën si gjysmën e fesë.

2. MBROJTJA E JETËS

Një nga gjërat më të rëndësishme që Allahu kërkon, është edhe mbrojtja e jetës. Jeta e njeriut është e shenjtë, kurse vrasja konsiderohet prej mëkateve të mëdha. Po ashtu, çdo dhunë, torturë dhe padrejtësi mbi njeriun është haram. Në të njëjtën kategori përfshihet edhe vetëvrasja. Madje në Islam, vrasja e një njeriu konsiderohet si vrasja e gjithë njerëzimit, kurse shpëtimi i një jetë si shpëtimi i gjithë njerëzimit.

Në lidhje me këtë, Kurani thotë:

“Kush vret ndokënd, që s’ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve.” (Maide, 32)

Edhe mbrojtja nga haramet përfshihet në mbrojtjen e jetës. Prandaj Allahu i ka konsideruar bashkëshortët mbulesë dhe mburojë për njëri-tjetrin. Mbrojtja e jetës nuk është e kufizuar vetëm me mbrojtjen nga fatkeqësitë dhe dëmet e mundshme në këtë botë, por edhe ruajtjen nga dënimi dhe vuajtjet e botës tjetër. Allahu thotë në ajetin kuranor: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”** (Tahrim, 6)

Ruajtja nga haramet i siguron njeriut lumturinë në botën tjetër. Mjeti për ruajtjen e zemrës dhe syrit është martesë dhe bashkimi familjar. Në lidhje me këtë fakt, Allahu në Kurani thotë: **“Dhe një prej she-njave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”** (Rum, 21)

Në ajet, fjala “sekinet” shpreh jetën e qetë, të rehatshme dhe pa telashe, fjala “meudde” shpreh dashurinë miqësinë dhe dashamirësinë, kurse fjala “rahmet”

Feja ka marrë përsipër ruajtjen e njeriut si krijesën më të vyer në univers. Sepse vazhdimësia e fesë është e lidhur drejtpërdrejt me shëndetin dhe vazhdimësinë e njeriut, kurse vazhdimësia e njeriut është e mundur përmes krijimit të familjes.

mëshirën, dhembshurinë dhe zemërbutësinë. Të trija këto ndjenja janë manifestime të periudhës së hershme, të mesme dhe të vonë të martesës.

Në ajetin: **“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër.”** (Bekare, 201), në të mirat e kësaj botë është përfshirë edhe bashkëshortja shembullore, e cila bëhet burim lumturie. Po ashtu, në ajetin: **“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur.”** (Nahl, 97), shprehjen “jetë të bukur” dijetarët e kanë interpretuar si bashkëshort dhe bashkëshorte të mirë.

Omeri (r.a.), nuk e konsideronte gruan e devotshme qenie të kësaj bote, por si qenie e botës së amëshuar, sepse ajo e dërgon njeriun në xhenet.

Allahu kërkon për atyre që nuk munden të martohen, të mbrojnë sytë nga haramet. **“Ata që nuk kanë mundësi për martesë, le të përmbajnë veten, derisa Allahu t’i begatojë me dhuntinë e Tij.”** (Nur, 33)

3. MBROJTJA E RIPRODHIMIT

Për vazhdimësinë e jetës së kësaj bote, është e nevojshme ruajtja e riprodhimit njerëzor. Prandaj njeriu është përgjegjës për ruajtjen e kësaj vazhdimësie. Pejgamberët, si Ibrahim, Ismaili dhe Zekerijaja (a.s.), në lutjet e tyre i kanë kërkuar Zotit pasardhës të mirë dhe besimtarë. Për të siguruar vazhdimësinë e pasardhësve të Ademit, Allahu krijoi Havanë. Ajeti kuranor: **“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra.”** (Nisa, 1), aludon pikërisht për këtë fakt. Martesa është institucioni bazë për ruajtjen e vazhdimësisë së njerëzimit. Allahu kërkon prej nesh të lutemi për pasardhës besimtarë, të mirë dhe të devotshëm. **“O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!”** (Furkan, 74)

Ata që nuk shqetësohen dhe përpiqen për brezat e ardhshëm, nuk mund të gjejnë qetësi as në këtë botë, as në botën tjetër. Pejgamberi (a.s.), na ka treguar se pa përpjekje, pa punë dhe pa u shqetësuar për zgjidhjen e problemeve të njerëzve të tjerë, nuk mund të arrihet lumturia. Pejgamberi (a.s.), në të njëjtën kohë e ka inkurajuar ymetin të shumohet jo vetëm në numër,

por edhe cilësisht.

4. MBROJTJA E PASURISË

Në Islam pasuria private konsiderohet e shenjtë dhe për këtë, pasuria, nderi dhe dinjiteti i njeriut janë marrë në mbrojtje. Pejgabmeri (a.s.), në hutben e lumturisë, ndër të tjera tha: **“Gjaku, pasuria dhe nderi juaj është i mbrojtur.”** (Ibn Maxhe, Menâsik, 76. 16) Sipas Islamit, në qendër të ekonomisë është Allahu. Sepse ai që ndërpret marrëdhënien me Allahun bie në çoroditje dhe zvetënim, në këtë mënyrë humbet veten dhe dynjanë. Allahu në Kuran e ka shpallur pasurinë si mjet dhe jo qëllim. **“Mos e lini në dorë të të paaftëve mendërisht pasurinë tuaj, që Allahu jua ka dhënë si mjet jetese.”** (Nisa, 5)

Sigurimi i vazhdimësisë së jetës në këtë botë është i mundur përmes martesës dhe punës. Nga frika e sigurimit të jetesës, njerëzit po e vonojnë martesën deri në gjetjen e një punë të mirë, mirëpo Allahu në ajetin kuranor: **“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju, si dhe skllavërit dhe skllavet tuaja që janë besimtarë të ndershëm! Nëse janë të varfër, Allahu do t’i begatojë ata me dhuntinë e Tij; Allahu është i Gjerë në mirësi dhe i Gjithëdijshtëm.”** (Nur, 32.), martesën e radhit të parën.

5. MBROJTJA E MENDJES

Sipas fesë, mendja është kusht themelor për përgjegjësinë dhe obligimin e subjektit. Subjekti e fiton përgjegjësinë për veprimet, kur arrin moshën e pjekurisë dhe është i aftë mendërisht. **“Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, Tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi.”** (Ahzab, 72) Përgjegjësia është e mundur vetëm kur njeriu është i lirë dhe i aftë mendërisht. Mirësia më e madhe që i ka dhënë Allahu njeriut, është mendja. Detyra për ta pajisur mendjen me dituri, në mënyrë që të njohë Krijuesin dhe t’i shërbejë njerëzimit, i takon njeriut.

Për mendimin tim, mënyra më e mirë për të ruajtur këto pesë domosdoshmëri është familja. Sepse rolin dhe rëndësinë që ka qeliza për organizmin ka familja për shoqërinë. Prandaj, mbrojtja e këtyre pesë domosdoshmërive është e lidhur ngushtë me jetën familjare. Qëllimi dhe objektivi i këtyre është mbrojtja e njeriut.



PRAKTIKUM NË LEXIMIN E ATYPËRATYSHËM

Altin Torba

Dikush troket në derë dhe Selma i drejtohet ta hapë. Kur ja, postieri qëndron në derë dhe kërkon Selma Ash-rauin. Selma i thotë se gjendet pikërisht para personit të kërkuar. Postieri i kërkon asaj të firmosë për marrjen e letrës. Selma e hap dhe e lexon tërë letrën në vetëm 10 sekonda... Ky është një shembull në dukje imagjinar...

Shumë më ka çoroditur në vegjëlinë time historia e leximit dhe nxënies së një flete të tërë në vetëm 10 sekonda. Mendja ime e mendonte të tillë gjë thjesht si një trillim.

A është i mundur leximi dhe nxënia e një flete të tërë në vetëm 10 sekonda?

Le të udhëtojmë së bashku në këtë analizë të detajuar mbi leximin e atypëratyshëm dhe të mësojmë mbi metodën që e bëri Selmën që vërtet ta lexojë letrën e saj në vetëm 10 sekonda.

E lus Allahun të më japë sukses në këtë trajtim, i cili synon paraqitjen e një materiali thelbësor mbi leximin e atypëratyshëm, duke shpresuar të gjejmë edhe mirëkuptimin dhe përkushtimin tuaj lexues të nderuar.

Fillojmë me Bismilahi Rahmani Rahim-Me emrin e Allahut Mëshiruesit, Mëshirëbërësit:

Më qëllim që fillimisht të arrijmë të mësojmë shpejtësinë e leximit tënd të zakonshëm, të duhet të përpiqesh që tekstin në vijim ta lexosh ashtu siç lexon normalisht, as më shpejt dhe as më avash. Vendose orën në kronometër, me qëllim që të matësh minutazhin që të merr leximi i tekstit në fjalë. Preferohet që tekstin të mos e lexosh nga kompjuteri, por nëse mundesh ta printosh dhe ta lexosh nga fletët e printuara.

Tani ulu qetësisht dhe pasi të kesh kërkuar ndihmën e Allahut, lexo pa ndërprerje tekstin e dhënë deri në

fund, duke mos harruar që sapo të mbarosh, ta ndalosh kronometrën dhe të shënosh minutat.

Sa për përfitim, të gjitha të dhënat e gjendura në tekst janë të sakta, mund të mbështetesh në to dhe të përfitosh prej tyre.

[Fillimi i tekstit]

QUMËSHTI I NËNËS

Hulumtimet dhe studimet kanë treguar se qumështi natyral me të cilin mëkohet foshnja nga gjiri i nënës, është më i miri në përmbajtje nga të gjitha alternativat e tregut dhe farmacive. Fëmijët që janë ushqyer me mëkim natyral gëzojnë një shëndet dhe imunitet të admirueshëm kundrejt sëmundjeve. Ata qëndrojnë shumë më lart në këtë aspekt, sesa foshnjat që janë trajtuar me mëkim jonatyral (artificial).

Studimi i bërë nga Universiteti Amerikan i Harfordit, thekson se qumështi i nënës përmban 900 kilokalori, prej të cilave 230 kilokalori kanë ardhur dhuratë nga trupi i nënës dhe 760 kilokalori kanë ardhur si vlerë ushqimore.

Qumështi i nënës gëzon attribute të shkëlqyera, të cilat nuk gjenden në të gjithë burimet e tjera ushqimore të foshnjës, kështu që Allahu i Lartësuar, këtë porcion mëkimi me të cilin ushqehet fëmija, e ka përshtatur në një formë tepër të mahnitshme me gjithë mbarëvajtjen e gjymtyrëve dhe organeve të trupit të fëmijës, formimi i të cilave është i pakompletuar në këtë periudhë të moshës së fëmijës.

Kështu, qumështi i nënës, në tre javët e para përmban një përqindje të madhe të IgA (Imunoglobulinë A-një klasë e antikorpeve(trupave) që sekretohet në lëngjet e trupit si pështyma dhe që mbron sipërfaqet mukoze

të organizmit nga infeksionet), që është një lëndë e cila i jep imunitet trupit të njeriut dhe vjen ekskluzivisht nga nëna, jo nga diku tjetër.

Përqindja e vitaminave në qumështin e nënës është shumë e paktë në raport me qumështin e lopës, që përdoret për përftimin alternativ të qumështit të foshnjave, prej ku disa e mendojnë qumështin alternativ të lopës si më të mirë, por në realitet përqindja e vogël e vitaminave është më mirë për foshnjën, pasi veshka dhe mëlçia e foshnjës ende nuk janë zhvilluar dhe çdo shtesë proteinore mund të shpjerë në akumulimin e proteinave të tepërta në veshkë dhe të shkaktojë komplikacione në veshka.

Po kështu, përqindja e lartë e yndyrnave në qumështin e nënës, shpie në balancimin e prodhimit të kolesterolit (yndyrës së gjakut) në trupin e fëmijës dhe bën një si praktikum (ushtrim) të sistemit të prodhimit të kolesterolit në trup, si dhe e ndihmon kolesterolin në ndërtimin e qelizave nervore dhe fshikëzën e tëmthit, gjë e cila ndihmon në procesin e tretjes së yndyrnave.

Qumështi i nënës përmban një përqindje të lartë hekuri që absorbohet lehtësisht, në një masë prej 50 %, përqindje kjo që qëndron shumë lart në krahasim me qumështin e lopës, që absorbohet në masën prej vetëm 10 %. Gjithashtu, qumështi i nënës përmban vitaminën C dhe lëndë të tjera që ndihmojnë për luftimin e bakte-riëve dhe pengojnë sëmurjen e foshnjës.

Për shkaqet e përmendura dhe shumë të tjera, që për arsye të natyrës përmbledhëse të artikullit nuk mund t'i përmendim, qumështin e nënës e gjejmë të jetë ushqimi ideal për foshnjën, sipas citimit të Ibrahim Khatibit.

Por të pranishme janë edhe rastet kur nëna nuk mund ta ushqejë foshnjën e vet me qumështin e gjirit të saj, si për shembull, kur nëna merr ilaçe të cilat përmes qumështit mund të kalojnë tek fëmija dhe ta dëmtojnë atë. Në këto raste nëna mëkuese duhet të konsultohet me mjekun, lidhur me të gjitha ilaçet që konsumon. Prej lëndëve të tjera që e dëmtojnë fëmijën, përmendim edhe kutërbimet e solucionëve të ndryshme që përdoren për eliminimin e insekteve të dëmshme, prandaj edhe ato duhet të evitohen nga ambientet e jetesës..

Prej problemeve që kanë të bëjnë me fëmijën, janë edhe disa raste problematike gjenetike (të trashëguara), si rasti i sëmundjes PKU (Fenikketonuria-çrregullim gjenetik i një enzime të mëlçisë, që ndërpret funksionet normale të organizmit), rast në të cilin foshnja humbet një enzimë të caktuar që i nevojitet për tretjen e proteinave dhe si pasojë e mungesës në fjalë, proteina akumulohet në trupin e foshnjës, gjë e cila mund të shpjerë në çrregullimin mendor të tij. Kjo sëmundje është e trashëguar dhe në rastin e konstatimit të saj, Allahu na ruajttë prej saj, menjëherë duhet të ndalohet mëkimi i foshnjës me qumështin e nënës dhe të ush-

qehet me lëndë ushqimore alternative të pranishme në farmaci, të cilat përmbajnë përqindje fare të vogël proteinash.

Një tjetër sëmundje që mund t'i prek foshnjat është Galaktozhemi (çrregullim i trashëguar ku foshnja nuk është në gjendje të metabolizojë galaktozën-sheqerin e qumështit), që vjen po kështu si pasojë e humbjes së enzimës përgjegjëse për tretjen e galaktozës, e cila është një lëndë e pranishme tek qumështi i nënës. Në këtë rast, sërish në alternim të qumështit të nënës duhen sjellë komponentë ushqimorë tërësisht të zhveshur nga kjo lëndë, përndryshe komplikacioni mund të shkaktojë frenimin e zhvillimit të fëmijës dhe çrregullimin mendor të tij.

USHQIMI I GRUAS SHTATZËNË

Shtatzania sa i përket aspektit të funksionalitetit të gruas, është një proces jo i natyrshëm dhe si e tillë ajo i nënshtrohet një sërë çështjesh që duhet të kihen parasysh. Kësisoj, shëndeti i gruas shtatzënë është ngushtësisht i lidhur me shëndetin e foshnjës në bark dhe çdo gjë që e dëmton nënën mund ta dëmtoj edhe foshnjën e saj.

Zakonet e këqija të nënës, sikurse pirja e duhanit apo alkoolit, lëvizja e pakët, etj., ndikojnë negativisht tek foshnja në bark. Sa i përket pirjes së duhanit, ajo ndikon në inteligjencën dhe peshën e foshnjës dhe njëjtë është çështja edhe për alkoolin; teksa lëvizja e pakët mund të shkaktojë akumulimin e lëngjeve tek shtatzëna dhe për pasojë, rritjen e tensionit të gjakut.

Ushqimi është një tjetër faktor ndikues tek shtatzëna, kështu që pesha e saj që duhet shtuar gjatë shtatzanisë duhet të jetë jo më shumë se 14 kilogramë dhe jo më pak se 11 kilogramë. Nuk duhet të tepruhet me shtimin në peshë, i cili kryesisht ndodh si pasojë e faktit se guraja shtatzënë e lëshon frerin dhe fillon që gjatë shtatzanisë të hajë sipas qejfit, gjë që përbën pikërisht sekretin e mbipeshës së madhe të disa nënave gjatë shtatzanisë, për t'u shndërruar kjo nënë në një fuçi, sipas këndvështrimit të doktor Ismail Ebu Bekrit.

Sa i përket elementëve të tjerë thelbësorë për rritjen dhe zhvillimin e shëndetshëm të foshnjës, sikurse hekuri, zinku dhe vitaminat, duhet që ato të gjenden të depozituara tek nëna shtatzënë në sasi të mjaftueshme, sepse mangësitë në to mund të shkaktojnë pasoja negative edhe tek nëna e edhe tek foshnja që ajo mban në barkun e saj, pasi fëmija është sikurse një ndërtesë e cila konstruktohet përmes lëndëve bazë të pranishme tek nëna e tij.

Allahu i shpërbleftë nënat tona që kanë kontribuar për ne që në zanafillën e jetës sonë!"

[Mbarimi i tekstit]

KËTU NDALOJE KRONOMETRIN E ORËS TËNDE!

Koha që arrite është _____ minuta.

Shpejtësia jote në lexim është = numrin e fjalëve të tekstit / (pjesëtuar) me kohën e arritur _____ = _____ fjalë / minutë.

Vërejtje: Nuk ke nevojë t'i numërosh fjalët e tekstit, pasi unë po ta jap shifrën e tyre, ato janë thujse 1100 fjalë.

Nxënia:

Qarkoje përgjigjen e saktë por duke mos e shkelur kushtin e domosdoshëm që të "mos shikosh kurrsesi në tekst"!

Pyetja 1 – Qumështi i nënës përmban:

- a. 230 kilokalori.
- b. 760 kilokalori.
- c. 900 kilokalori.
- d. 400 kilokalori.

Pyetja 2 – Në tri javët e para, qumështi i nënës përmban një përqindje të madhe të lëndës:

- a. Imunoglobulinë C
- b. Imunoglobulinë D
- c. Imunoglobulinë F
- d. Imunoglobulinë A

Pyetja 3 – Pesha e disa grave pas shtatzanisë shtohet si pasojë e zakoneve të tyre të këqija dhe gratë bëhen si fuçi, sipas këndvështrimit të doktor:

- a. Ismail Ebu Bekrit
- b. Ibrahim Khatibit
- c. Muhamed Ismailit
- d. Hadi Mustafa

Pyetja 4 – Qumështi i nënës përmban sasi të mëdha yndyrnash.

- a. Po.
- b. Jo.

Pyetja 5 – Përqindja e absorbimit të hekurit të gjendur tek qumështi i lopës është:

- a. 50 %.
- b. 10 %.
- c. 40 %.
- d. 30 %.

Pyetja 6 – Pesha e shtatzënës, kundrejt peshës normale të saj, duhet:

- a. Të mos jetë mbi 12 kilogramë dhe nën 11 kilogramë.
- b. Të mos jetë mbi 13 kilogramë dhe nën 11 kilogramë.
- c. Të mos jetë mbi 14 kilogramë dhe nën 11 kilogramë.
- d. Asnjëra.

Pyetja 7 – Lëvizja e pakët shkakton:

- a. Shtim në peshë.
- b. Shtimin e tensionit të gjakut.
- c. Shtimin e peshës së fëmijës në bark.
- d. Rënien e shtatzënës nga pesha.

Pyetja 8 – Sëmundja PKU (Fenikketonuria) shkakton:

- a. Mangësi në zhvillimin e fëmijës dhe çrregullim mendor të tij.
- b. Vetëm çrregullim mendor të fëmijës.
- c. Vetëm mangësi në zhvillimin e fëmijës.
- d. Asnjërin.

Pyetja 9 – Në rastin e prekjes nga sëmundja e galaktozhemit:

- a. Duhet të përdorim një përbërës që nuk përmban fare galaktozë.
- b. Duhet të përdorim një përbërës që përmban përqindje të vogël galaktoze.
- c. Duhet të përdorim qumështin natyral të nënës.
- d. Duhet të largohemi tërësisht nga të gjitha llojet e qumështit.

Pyetja 10 – Akumulimi i proteinave në trupin e fëmijës çon në:

- a. Shtimin e zhvillimit muskulator të fëmijës.
- b. Probleme shëndetësore në veshkën e fëmijës.
- c. Probleme shëndetësore në mëlçinë e fëmijës.
- d. Probleme shëndetësore në mëlçinë dhe veshkën e fëmijës.

- Pasi të kesh llogaritur pikët e nxënies tënde, referoju tekstit dhe nxirr prej tij përgjigjet e sakta nga ku duhet të llogarisësh nxënien tënde faktike. Mesatarja e nxënies tënde në përqindje, përftohet duke i shumëzuar përgjigjet e tua të sakta me njëqind dhe pjesëtuar me dhjetë.

Kësisoj nxënia jote është: _____ .

Pra, pikë së pari të duhet që pa humbur kohë të përcaktosh gjendjen tënde, e paskëtaj mund të nisemi së bashku në rrugët të cilat do të ndihmojnë që ta rrisësh shpejtësinë e leximit tënd.

Regjistroje shpejtësinë tënde fillestare të leximit dhe mos e harro atë, me qëllim që të vëresh përparimin tënd dhe ta referosh atë tek koeficientët e mëposhtëm:

Lexuesi: Fjalë/Minutë: Nxënia:

I dobët	10-100	30-50 %
Mesatar	200-240	50-70 %
Intelektual	400	70-80 %

Më i miri në 100 persona 800-1000+ 80 %

Më i miri në 1000 persona+ 1000+ 80 %

Deri në subjektin e ardhshëm po të lë në garancinë e Allahut të Lartësuar.

KUPTIMET DHE LLOJET E NEFSIT

Pesë kuptimet më të dalluara të nefsit që Allahu (xh. sh.) përmend, në Kuran janë:

1. SHPIRTI

“...Ah sikur t’i shihje keqbërësit gjatë agonisë së vdekjes, kur engjëjt zgjasin duart (duke thënë): ‘Dorëzoni shpirtrat tuaj! Sot ju do të ndëshkoheni me dënim poshtërues për shkak të të pavërtetave që keni thënë për Allahun dhe që keni shpërfillur shpalljet e Tij’.” (En’am, 93)

2. I TËRË NJERIU ME TRUP DHE SHPIRT

“Krijimi dhe ringjallja e ju të gjithëve është njësoj si krijimi i një njeriu të vetëm. Vërtet, Allahu i dëgjon dhe i sheh të gjitha.” (Lukman, 28)

3. FUQIA MË TË CILËN MENDON NJERIU

“Kështu, ata i mohuan ato padrejtësisht dhe me mendjemadhësi, edhe pse shpirti i tyre i besonte për të vërteta. Pa shiko, cili ka qenë fundi i shkatërrimtarëve!” (Neml, 14)

4. MË ANË TË ZEMRËS

“Përmende Zotin tënd me vete, i përulur dhe me frikë - jo me zë të lartë, në mëngjes dhe mbrëmje, dhe mos u bëj nga ata që nuk i kushtojnë vëmendje!” (Araf, 205)

“(Bijtë e Jakubit) thanë: ‘Nëse ka vjedhur, më parë ka vjedhur edhe vëllai i tij!’ Jusufi heshti për këtë dhe nuk shpalli gjë, por mendoi në vetvete: ‘Ju jeni

Nexhat Spahlu

Fjala nefs në gjuhën arabe, herë vjen në kuptimin e vetes, herë në kuptim të epshit dhe herë në kuptim të shpirtit.

Njeriu është i krijuar nga shpirti dhe trupi, në të është e vendosur e mira dhe e keqja. Trupi ynë nuk mund të jetojë pa ushqim dhe pije. E njëjta gjë ndodh edhe me shpirtrat tanë. Edhe ata kanë nevojë për ushqim. Kjo arrihet përmes adhurimeve të ndyshme, siç janë: namazi, kurani etj. Komplet jeta jonë është një sprovë deri në vdekje, lidhur me këtë Allahu (xh.sh.), thotë:

Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh. (Mulk, 2)

në pozitë më të keqe. Allahu është më i dijsëm për ato që thoni ju". (Jusuf, 77)

5. FUQIA PËR TË MIRË DHE TË KEQE QË ËSHTË TEK NJERIU

"Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin." (Naziat, 40-41)

Llojet e nefsit (shpirtit) janë tre:

1. Nefsul-Mutmeinne (nefsi i qetë) - është ai lloji i vendstrehimit të besimit, dritës hyjnore. Ky lloj shpirti është më i dashur tek Zoti (xh.sh.), pasi nga ai shpirt rrjedh drita e imanit. Ky është shpirti i përkushtuar, i mbrojtur dhe i mbështetur te Krijuesi i gjithësisë. Lidhur me këtë lloj të shpirtit, flet Allahu (xh.sh.), në Kuran:

"O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!" (Fexhr, 27-30)

Ibn Kajjimi ka thënë: "Nefsi (shpirti) i qetë qetësohet vetëm me adhurimin ndaj Allahut dhe ndalimin prej haramëve dhe ai nefsi asnjëherë nuk i bindet apo s'i përulet tjetërkujt përveç Allahut të Madhëruar, sepse ai e përmend çdo herë dhe përmalohet për takimin me Allahun e Lartësuar."

2. Nefsul-Ammaretun Bi su (nefsi që urdhëron për të këqija) - është ai lloji i shpirtit, që është i mbushur më të këqija. Dijetarët islam e përkrahjnë këtë lloj të shpirtit si vendstrehim i çdo të keqeje. Sa herë që një e keqe paraqitet, ajo zë vend në këtë lloj shpirti dhe zemër. Njerëzit që kanë këtë lloj shpirti, gjithmonë vrapojnë pas gjërava të këqija. Allahu (xh.sh.), thotë:

"Unë nuk e shfajësoj veten, sepse shpirti (i njeriut) është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im. Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirëplotë." (Jusuf, 53)

3. Nefsul-Levrame (nefsi i cili qorton, i cili ndjen keqardhje) - sa herë që bën ndonjë mëkat, ky lloj shpirti ndjen keqardhje dhe e kritikon vetveten, e qorton atë. Kur flet Allahu (xh. sh.), mbi këtë lloj shpirti për Ditën e kijametit, thotë:

"Betohem në Ditën e Kiametit! Betohem në shpirtin qortues! A mendon njeriu se nuk do të mund t'i mbledhim eshtrat e tij? Po, si jo! Ne jemi të Zotë t'ia ribëjmë bashkë me përsosmëri edhe majat e gishtave të tij. Por njeriu dëshiron të gabojë sa të jetë gjallë dhe pyet: Kur do të jetë Dita e Kiametit? Por, kur sytë t'i verbohen dhe të zihet Hëna dhe Dielli e Hëna të bashkohen, atë ditë njeriu do të thotë: Ku të iki?" (Kijame, 1-10)

Këto janë llojet e nefsit (shpirtit), andaj gjithësecili prej nesh duhet ta pyesë veten se në cilin grup bën pjesë, ta kuptojmë qëllimin e krijimit tonë, të jemi ata që ia

kemi frikë-respektin vetëm Allahut (xh.sh.), si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Ka njerëz që për fat të keq lindin dhe vdesin pa asnjë qëllim të kësaj jete, thjesht lindin dhe vdesin, hanë dhe pinë si kafshet. Për këtë lloj të njerëzve Allahu (xh.sh.) thotë:

"Ne kemi paracaktuar për Xhehenemin shumë xhinde dhe njerëz, sepse ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit." (Araf, 179)

Ajo që e dallon vesvesin e shejtanit nga nefsi, është se shejtani ta zbukuron të keqen të shtyn të veprosht fillimisht. Nëse e refuzon, ai largohet prej atij gjynahu dhe kalon tek një gjynah tjetër, pasi nuk ka si qëllim vetëm një lloj gjynahu, por çfarëdo që të mundet. Andaj besimtari duhet të jetë gjithmonë i vetëdijshëm, të jetë i lidhur me fjalët e Zotit (xh.sh.) dhe hadithet e Muhamedit (a.s.).

Një ditë Pejgamberi (a.s.), i tha Muadhrit: "O Muadh, a të tregoj se cila është gjëja më e rëndësishme në këtë botë?" "Po i tha Muadhi: "Gjëja më e rëndësishme në këtë botë është Islami, shtylla e saj është namazi dhe kulmi i saj është xhihadi."

Rebia bin Kab El-Eslemi, thotë që çdo natë i shërbeja Muhamedit (a.s.) dhe flija në shtëpinë e tij. Një natë Pejgamberi (a.s.), më tha: "O Rebia, kërko nga unë ç'të duash." Unë i thashë: "O i Dërguari i Allahut, më lër pak kohë sa të mendoj." U ula duke menduar rreth kësaj bote dhe se ajo një ditë do të zhduket dhe thashë me vete: 'nuk do të kërkoj veçse diçka që lidhet me jetën tjetër.' Shkova dhe i thashë Muhamedit (a.s.): "O i Dërguari i Zotit, dua të jem me ty në Xhenet!" Pejgamberi (a.s.), tha: "A nuk ke ndonjë kërkesë tjetër, o Rebia?" I thashë: "Kjo është e mjaftueshme." Pejgamberi (a.s.), më tha: "Më ndihmo me namaze të shumta."

Nëse dëshiron ti o vëlla dhe motër të jesh pranë Muhamedit (a.s.), lufto me nefsin tend dhe fal sa më shumë namaze.

Ibn Kajjimi thoshte: "O ti me vullnet të dobët. Kjo është një rrugë në të cilën u thinj Nuhu (a.s.), për 950 vjet. U ther Jahja (a.s.), për këtë rrugë, u sharrua më sharrë Zekerijai (a.s.), u hodh në zjarr Ibrahim (a.s.) dhe u torturua Muhamedi (a.s.), kurse ti kërkon Islam të lehtë?"

Të gjitha këto që përmendëm të ndihmojnë të luftosh nefsin dhe të gjesh kënaqësinë e kësaj dhe botës tjetër. Të jesh i sigurt se Allahu i Madhëruar ka mundësi të ndryshojë çdo lloj realiteti. Mirëpo, Ai nuk e bën këtë gjë deri atëherë kur përtacia dhe dembelizmi të jenë zhdukur nga zemrat e njerëzve.

Lus Allahun të na mundësojë realizimin e çdo vepre të dashur për Të, të na përmirësojë jetën e kësaj bote dhe të botës tjetër.



Sadakaja

NUK E PAKËSON PASURINË

Allahu (xh.sh.), thotë: ***"Ata që shpenzojnë pasurinë e tyre për hir të Allahut, pa e shoqëruar atë me përgojime apo fyerje, do të shpërblehen nga Zoti dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo të pikëllohen."*** (Bekare, 262)

Ibn Abasi (r.a.), ka thënë: "Dy gjëra janë prej shejtanit dhe dy gjëra janë prej Allahut të madhëruar, pastaj lexoi ajetin e Kuranit:

"Shejtani ju frikëson me skamje e varfëri, si dhe ju mëson të bëni vepra të pamoralshme, kurse Allahu ju premton faljen dhe mirësinë e Tij." (Bekare, 268)

Në një hadith të transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi, Pejgamberi (a.s.), na tregon se Allahu (xh.sh.), ka thënë: "Dhuro o rob i Im, sepse Unë do të jap ty edhe më shumë begati."

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Sadakaja nuk e pakëson pasurinë..." (Muslimi)

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Shtatë persona do të hyjnë nën hijen e arshit të Allahut, atë ditë kur nuk ka hije tjetër përveç hijes së Tij. Njëri prej tyre është personi i cili jep sadaka me dorën e djathtë, pa e ditur e majta."

Lëmosha bëhet shkak që Zoti të falë shërimin nga sëmundjet e ndryshme:

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Mjekojini të sëmurit tuaj me lëmoshë, mbrojeni pasurinë tuaj duke dhënë zekatin dhe përgatituni për sprovat e jetës duke bërë dua." (Bejhakiu)

Lëmosha të shpie në mirësi dhe devotshmëri:

Kur Omerit (r.a.), i pëlqente diçka që e kishte, ai e jepte atë sadaka për hir të Zotit të Lartësuar, duke zbatuar kështu fjalën e Tij:

"Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, për sa kohë që nuk ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni..." (Ali Imran, 92)

Aishja (r.a.), para se të jepte sadaka, e merrte monedhën dhe e parfumoste. Kur e pyetën përse e bënte këtë gjë, ajo tha: "E bëj, pasi ajo do të bjerë në dorë të Allahut, para se të bjerë në dorën e të varfrit."

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Çdo vepër e mirë dhe e hairit konsiderohet sadaka." (Buhari, Muslim).

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "T'i buzëqeshësh vëllait tënd është sadaka. Të urdhërosh një person të bëjë një punë të mirë dhe ta pengosh atë që të bëjë një punë të keqe, është sadaka."

Të udhëzosh njeriun që ka humbur rrugën e drejtë është sadaka. Të largosh gurë dhe ferra nga rruga, edhe kjo është sadaka..." (Tirmidhiu)

Ebu Lejth Semerkandi ka thënë: "Jep sadaka, pa marrë parasysh nëse dhuron pak apo shumë para, sepse sadakaja ka dhjetë të mira, pesë prej të cilave i takojnë kësaj bote, ndërsa pesë të tjerat i takojnë Ahiretit. Sa i përket të mirave që i takojnë kësaj bote, ato janë:

1- Pastron pasurinë. Pejgamberi a.s. ka thënë: 'Njeriu gjatë shitblerjes flet fjalë të kota, betohet dhe gënjen. Këto pastrohen me sadaka.'

2- Sadakaja e pastron trupin prej gjynaheve, ashtu siç na mëson Allahu kur urdhëron e thotë: ***"Merr nga***

pasuria e tyre lëmoshë, me të cilën do t'i pastrosh ata dhe do t'ua risësh veprat e mira..!' (Tevbe, 103)

3- Largon belatë dhe sëmundjet. I Dërguari i Allahut ka thënë: 'Shërojini të sëmuret tuaj edhe duke dhënë sadaka.'

4- Sadakaja i lumturon të varfrit. T'i bësh besimtarët të lumtur është një prej veprave të mira.

5- Shton bereqetin në pasuri. Allahu (xh.sh.), thotë: **'... Ai ua zëvendëson atë që ju e ndani ndër të varfër...'** (Sebe, 39)

Sa u përket pesë të mirave në Ahiret, ato janë:

1- Sadakaja do t'i bëhet hije dhuruesit të saj në Ditën e Gjykimit, kur nuk ka hije për t'u fshehur nga nxehësia e madhe e asaj dite.

2- Dhuruesi i sadakasë ka për të dhënë llogari më të shkurtër sesa njerëzit e tjerë.

3- Peshon rëndë në peshoren e punëve të mira.

4- Sadakaja do të bëjë që besimtari ta kalojë urën e siratit sa më shpejt.

5- Rrit gradën e besimtarit në xhenet. (Tenbihul-Gafilin)

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Një njeri i cili po ecte rrugës, dëgjoj një zë që vinte nga retë: 'Vaditeni (ujiteni) kopshtin e filanit!' Një re u nda dhe u shkarkua duke formuar një pellg, uji i të cilit rridhte drejt një kopshti. Njeriu e ndoqi rrjedhën e ujit dhe ajo përfundoi tek një arë ku punonte një person me shat në dorë, i cili e shpërndante ujin nëpër arë me anë të kanaleve. Personi i parë e pyeti të dytin: 'Si e ke emrin?' Ai i tha po atë emër që kishte dëgjuar nga retë. Personi që punonte në arë e pyeti: 'Përse më pyete si e kisha emrin?' Ai i tha: 'Unë e dëgjova emrin tënd të bubullonte nga retë, të cilave u thuhej se uji i tyre do të derdhej tek ara jote!' Më pas, personi i parë e pyeti: 'Çfarë bën me këtë kopsht?'

Unë e ndaj prodhimin që jep ky kopsht dhe e dhuroj sadaka një të tretën, ha me familjen time një pjesë të saj dhe pjesën tjetër e shes që të investoj përsëri në kopsht." (Muslimi)

Ibn Mesudi (r.a.), ka thënë: "Nëse dëshiron ta ruash thesarin tënd aty ku nuk ta vjedh asnjë hajdut dhe nuk do të prishet kurrë, atëherë ndaje sadaka."

Pejgamberi (a.s.), u ka thënë shokëve të tij: "Cili prej jush e do pasurinë e trashëgimtarit më shumë se pasurinë e vet?" Sahabët i thanë: "O i Dërguari i Allahut, nuk ka asnjë prej nesh që të dojë më shumë pasurinë e trashëgimtarit sesa pasurinë e vet." Pastaj Pejgamberi (a.s.), u tha sahabëve: "Pasuria juaj e vërtetë dhe e çdo besimtarit është ajo që keni ndarë (që e keni dhënë në rrugë të Allahut), ndërsa pasuria e trashëgimtarit është ajo që keni lënë për vetë." (Buhariu)



REZISTENCA NDAJ ANTIBIOTIKËVE

Organizata Botërore e Shëndetësisë publikoi një paralajmërim, kur njoftoi se tani kemi hyrë në një periudhë post-antibiotike. Kjo do të thotë se disa infeksione të zakonshme bakteriale kanë fituar rezistencë ndaj ilaçeve.

Bakteriet janë organizma mikroskopike... as bimë as kafshë. Disa bakterie, si ato që gjenden në kos, janë të mira për ne, por të tjera janë vdekjeprurëse.

Ashtu si Organizata Botërore e Shëndetësisë,

Qendra amerikane për Kontrollin e Sëmundjeve ka zbuluar se disa bakterie nuk iu përgjigjen më antibiotikëve si më parë.

"Kemi parë më shumë se 2 milionë raste të infeksioneve rezistente ndaj antibiotikëve çdo vit vetëm në Shtetet e Bashkuara. 23 mijë nga këto episode kanë rezultuar në vdekje", thotë Dr. Laurie Hicks e Qendrës amerikane për Kontrollin e Sëmundjeve.

Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve ka një mesazh:

Ne duam që mjekët të dinë se rezistenca ndaj antibiotikëve është një problem i madh. Ne duam që pacientët ta dinë se antibiotikët nuk funksionojnë për infeksionet virale.

Rezistenca ndaj antibiotikëve ka ndryshuar tashmë praktikatat në spitale si Johns Hopkins në Baltimor.

Mjekët atje janë tani në të kujdesshëm në përdorimin e antibiotikëve, dhe vazhdimisht rishikojnë planet e trajtimit për të parë nëse pacientët po marrin antibiotikët e duhur në dozën e duhur. Dr. Trish Perl është epidemiologe në spitalin Johns Hopkins.

"Papritur e kupton se si do të ketë qenë mjekësia ndoshta 50, 70, 80 vjet më parë kur nuk kishte antibiotikë."



Aty pranë, në Qendrën Mjekësore të Universitetit të Merilendit, mjekët kanë ndryshuar mënyrën sesi kujdesen për pacientët e tyre në repartet e reanimacionit.

MRSA (MER-sah) është një infektion rezistent ndaj antibiotikëve që përhapet me lehtësi në spital, veçanërisht në repartet e reanimacionit, dhe mund të jetë vdekjeprurës. Dr. Anthony Harris studion nëse përdorimi i dorezave dhe përparësive kirurgjike nga infermejeret në reanimacion mund të pakësojë numrin e infeksioneve.

"Veshja e dorezave dhe përparësive çoi në një pakësim të ndjeshëm të rasteve, gati 40 përqind."

Mjeku Perl thotë se ka nevojë për më shumë fonde në hulumti-


met nga zyrtarët e shëndetësisë për të kuptuar sesi përhapen këto organizma. Duhet gjithashtu të zbulohen ilaçe të reja për të zëvendësuar ato që nuk funksionojnë më. Pacientët duhet të edukohen.

"Rezistenca zakonisht zhvillohet kur njerëzit nuk marrin ilaçet ose i marrin një ditë dhe jo tjetrën. Ose nuk mendojnë se duhet ta marrin të gjithë dozën. Kjo është veçanërisht problematike me sëmundje si tuberkulozi."

Duhet të gjenden zgjidhje të shpejta pasi Organizata Botërore e Shëndetësisë paralajmëroi se rezistenca ndaj antibiotikëve është një problem aq serioz sa që kërcënon arritjet e mjekësisë moderne.

RAPORTI I OKB-SË PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Global mean temperature change



Shkencëtarë dhe përfaqësues të qeverive nga më shumë se 100 vende të botës përfunduan një takim pesë-ditor në qytetin japonez port të Yokohamas (më 31 mars) me publikimin e raportit të dytë të Komisionit Ndërqeveritar për Ndryshimin e Klimës. Raporti zbulon se bota nuk është e përgatitur për të përballuar rreziqet e ndryshimit të klimës.

Autorët vijnë në një konsensus. Asnjë rajon nuk është lënë i paprekur, thotë analistja për klimën Kelly Levin, me Institutin e Buri-meve Botërore, që foli me ne përmes Skype-it.

"Mesazhi kryesor është se ndryshimet klimatike janë të përhapura dhe me pasojë".

Rritja e temperaturave do të sjellë mot edhe më ekstrem, mungesa ushqimi dhe uji, dhe ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve që rezultojnë në vdekjen e koraleve, humbjen e pyjeve dhe zhdukjen e specieve të ndryshme.

"Ne shohim deklaratat që lidhen me ndikimin e përmbytjeve në zonat detare me rritjen e nivelit të deteve dhe - pa ndryshime, deri në fund të shekullit mund të kemi qindra miliona njerëz të ekspozuar dhe të shpërngulur për shkak të përmbytjeve."

Këto përmbytje do të jenë më të zakonshme në Afrikë dhe Australi. Vala e të nxehtit pritet në Amerikën Veriore, Evropë, Afrikë dhe Azi. Më të varfrit, që kanë pak burime për të adaptuar me botën më të nxehtë, janë më të prekshmit. Siguria ushqimore dhe ekonomike janë gjithashtu në pikëpyetje.

Megjithë këto parashikime të errëta, raporti nuk është i gjithi negativ, thotë bashkë-kryetari i komisionit Christopher Fields.

"Megjithëse përqendrohet në një pamje të ftohtë, analitike dhe nganjëherë të dëshpëruar të sfidave me të cilat përballemi, raporti gjithashtu harton mundësitë dhe hapësirën për zgjidhjen e tyre. Raporti shqyrton mënyrat

që ne mund të kombinojmë për përshtatjen, zbutjen dhe transformimin e një shoqërie për të ndërtuar një botë që është jo vetëm më mirë e përgatitur për t'u përballuar me ndryshimin e klimës, por është krejtësisht një botë më e mirë."

Pranë konferencës në Yokohama, aktivisti Christian Teriete me organizatën Thirrje Globale për Veprim iu bashkua thirrjeve për të ulur emetimin e gazrave nga fabrikat, makinat dhe ndërtesat.

"Ata kanë mundësi të mjaftueshme këtë vit dhe vitin e ardhshëm në takime të rëndësishme klimatike. Udhëheqësit duhet të ndjekin politikat më të mira për të shpëtuar nga ndryshimet klimatike popullin e tyre dhe mjedisit tek i cili varemi kaq shumë."

Raporti mund të ndihmojë negociatorët ndërsa punojnë drejt një marrëveshje të re globale klimatike deri në vitin 2015 që do të zëvendësojë Protokollin e Kiotos që skadoi në vitin 2012.

GJAKOVËS I SHTOHET NJË HAFIZ I RI I KURANIT

Medreseja e Madhe e Gjakovës, e themeluar në vitin 1707-të, është e njohur për nxjerrjen e plejadave të dijetarëve dhe hafizëve. Ajo ka nxjerrë nga gjiri i saj jo vetëm personalitete fetare, por edhe personalitete të njohura shoqërore. Për shkak të rolit të saj si vatër e diturisë, menjëherë u vu në shënjestër të shovinizmit serb. Disa herë e mbyllën, por me lejen dhe ndihmën e Allahut përsëri u rihap.

Gjatë luftës u rrënua krejtësisht, por menjëherë pas luftës u rihap për të marrë edhe më fuqishëm rolin e saj si vatër e diturisë dhe kulturës. Brenda një periudhe 10- vjeçare u certifikuan 25 hafizë, nga të gjitha trojet shqiptare. Por ajo që i mungonte medresesë ishte një hafiz nga Gjakova. Për shtatëdhjetë vite nuk pati asnjë gjakovar të certifikuar nga kjo shkollë si hafiz. U deshën plot shtatëdhjetë vjet për të ardhur një hafiz nga qyteti i Gjakovës, i cili numëron një popullsi prej 130 000 ba-

norësh. Hafiz i ri quhet Tevfik Muhamed Mula.

I lindur në Gjakovë, më 27.04.1998. Shkollën fillore e kreu në Gjakovë, krahas mësimave obligative të cilat i kaloi përherë me sukses të shkëlqyeshëm iu rrek edhe mësimet kuranore. Gjegjësisht zemra e tij ia plotësoi dëshirën e kahmotshme, që një ditë të jetë edhe hafiz i Kuranit. Në një formë e theu atë tabu 70- vjeçare. Sot e quajnë Hafiz Tevfiku. Është i regjistruar në medresenë e mesme "Alaudin" të Prishtinës me korrespondencë, ku as aty nuk i mungon suksesi.

Neve nuk na mbetet gjë tjetër veçse t'i urojmë një sukses të mëtejshëm, duke e lutur Allahun ta udhëzojë dhe ta motivojë për suksese të reja. Kurse Tevfiku falënderon **"Shoqatën Stamboll"**, gjithë stafin e saj dhe gjithë ata që kontribuan për ta ngritur këtë vatër të dijes.

